

KAPITULLI I PARË

I. NJOHURITË E PËRGJITHSHME MBI ARBITRAZHIN

1. ARBITRAZHI GJITHNJË E MË I PREFERUESHËM NË ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE NË HAPËSIRËN E TREGTISË NDËRKOMBËTARE

Është konstatim i përgjithshëm se marrëdhëniet tregtare ndërkombëtare janë duke u zhvilluar me një hov dhe ritëm të pareshtur. Operacionet afariste tregtare po kryhen për çdo ditë në mes të subjekteve juridike shteteve dhe kontinenteve të ndryshme, falë edhe mjeteve bashkëkohëse, si atyre të komunikimit dhe lidhjeve moderne të komunikacionit të ditëve tona që zvogëluan distancat e arritjes prej një pike më të largët të rruzullit tokësor në pikën tjetër për një kohë shumë të shkurtër.

Praktikisht sot e tërë bota është bërë fqinjë, falë këtyre komunikimeve moderne. Operacionet afariste po inicohen, zhvillohen dhe po materializohen po ashtu me një shpejtësi të madhe dhe, ajo që është karakteristike, shpesh ndërmjet palëve kontraktuese, të cilat gjenden në distanca të largëta, që në një kohë pak më të largët shumë vështirë ka mundur të merret me mend. Po ashtu, në anën tjetër, komplikueshmëria e punëve dhe e afarizmit modern, prodhimtarisë së modernizuar, tregtisë shumë intensive dhe me një shpejtësi tejet të madhe të lidhjes dhe realizimit të transaksioneve afariste, si dhe jo rrallë të mungesës së përvojës dhe aftësive profesionale të personave që lidhin, përcjelljen si dhe përmbarimit të kontratave me objekt dhe problematikë të tyre mjaft të komplikuar. Po ndikojnë që edhe numri i kontesteve ndërmjet palëve kontraktuese të rritet. Këto janë edhe pasojë e mosnjohjes së strukturës dhe teknologjisë së funksionimit të së drejtës ndërkombëtare e cila kërkon njohje dhe aftësi të larta profesionale të kuadrit që bën lidhjen dhe kryerjen e këtyre punëve. Andaj njohja dhe studimi i së drejtës ndërkombëtare të shitblerjes (të gjitha llojeve) është me rëndësi të madhe për të drejtën

tregtare ndërkombëtare, sepse, në radhë të parë, është duke u rritur numri i transaksioneve moderne ndërkombëtare të shitblerjes e pastaj edhe i shërbimeve si shoqëruese të domosdoshme të punëve themelore, e që po ndikojnë në rritjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve, të cilat janë imanente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve dhe kontesteve, të cilat zakonisht janë me element të huaj. Edhe pse qëllimi dhe dëshira e njerëzve afarist është të lidhin punë e jo të krijojnë konteste me to, megjithatë duhet llogaritur edhe kontestet dhe zgjidhjen e tyre me anë të arbitrazhit, sepse kontestet lindin dhe ato nganjëherë, edhe përkundër dëshirës së mirë, janë të paevitueshme.

Arbitrazhi konsiderohet mjet i shpejtë i zgjidhjes së kontesteve, ai është ekonomik dhe mjaft i ndërgjegjshëm. Arbitrazhi me të drejtë thuhet se është shndërruar në institucion të njerëzve afaristë dhe lulëzimi i tij i plotë mund të themi se u arrit sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Ndryshe, arbitrazhi është institucion i vjetër. Lindja dhe zhvillimi i saj u paraqit qysh në shekullin e mesëm, kur i pati të gjitha karakteristikat e arbitrazhit tregtar,¹ të cilat ai në esencë i mbajti dhe i ruajti deri sot. Kjo ka të bëjë me përbërjen e arbitrazhit, siç ishin qendrat tregtare në mesjetë, ku kryhej tregtia ndërkombëtare, në azhuritetin dhe shpejtësinë e procedurës dhe, para së gjithash, me profesionalitetin e arbitrazhit, si dhe në aplikimin e së drejtës materiale (lex mercatoria) e cila është manifestuar në doket tregtare – uzancat.² Mirëpo, shekulli i 18-të dhe i 19-të ishte periudhë e cila nuk u shkoi në dobi rregullave me karakter internacional, por u tregua e kundërta. Ishte periudhë e inkorporimit të së drejtës tregtare në kodifikimet nacionale, kështu që e drejta tregtare në vend të (lex mercatoria) e cila gjeti shprehje në doket e mira tregtare, ajo u formësua në kodifikimet nacionale, kështu që zhvillimi i mëtejshëm u përcaktua dhe u orinetua në të drejtat nacionale,³ që trajtohet edhe si fund i së drejtës tregtare ndërkombëtare të asaj kohe, e cila në disa shtete edhe sot po ruhet me xhelozë. Këtu lindën edhe pasojat për shkak të këtij dezintegrimi dhe u paraqitën komplikimet sidomos me rastin e përcaktimit se cila e drejtë duhet të aplikohet në kontratën që përmban elementin e huaj. Këto komplikime dhe konflikte ndërmjet të drejtave të ndryshme kanë mundur të mënjanohen duke u orientuar në doket e pranuar të së drejtës tregtare, ndërkombëtare, kodifikimet nacionale mbetën trull i përshtatshëm që ndikuan në zhvillimin e së drejtës

1 Goldštajn, *Konvencije i pravilnici o spoljnotrgovinskim arbitražama*, "Informator", Zgb, 1964, f. 7-16.

2 Ibid.

3 Goldštajn, *Medjunarodna trgovačka arbitraža*, "Informator", Zgb, 1974 f. 3-34.

ndërkombëtare private të kuptuar si e drejtë e normave të kolizionit.⁴ Zgjerimi i tregtisë botërore ndikoi që të shtrohen pyetjet, të cilat ishin të hapura me rastin e kodifikimeve nacionale, tani me ashpërsinë e mprehtë, sepse gjendja e tanishme është gjithnjë e më pak e durueshme dhe e arsyeshme, edhe pse pengesa juridike të ortodoksisë së disa sistemeve nacionale nuk patën sukses që ta ndalin zhvillimin e këmbimit ndërkombëtar, por patën mundësi që atë ta vështirësojnë dhe të krijojnë shpenzime të panevojshme, humbje të paparashikuara dhe viktima të papritura.⁵

Këto dhe shkaqet tjera kanë ndikuar që të shqyrtohet situata dhe të analizohen rrethanat se a ka mundësi për tregtinë ndërkombëtare kjo gjendje e pavolitshme bile të përmirësohet. Në kohë të fundit hulumtimet shkencore kanë dhënë rezultate inkurajuese, sepse pohuan mundësitë pozitive të krahasimit, afirmimit dhe të harmonizimit të të drejtave tregtare nacionale, kështu që praktika me ndihmën e arbitrazhit ka dhënë shembuj inkurajues të aplikimit të Lex mercatoria të ditëve tona. Këtyre çështjeve të tregtisë ndërkombëtare, siç janë problemi i zhvillimit, zgjidhjes së kontesteve me anë të arbitrazhit me iniciativën e forcave progresive, ishte edhe objekt i shqyrtimit pranë Kuvendit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Kështu, me vendimin 2102 në informatën që u paraqit si e drejtë ndërkombëtare tregtare u definua “si turmë principesh me të cilat rregullohen marrëdhëniet tregtare të natyrës private, në të cilat përfshihen shtetet e ndryshme”. Kjo sipas Prof. Schmittoff, ishte në harmoni me arsyetimin e përgatitur në memorandumun e përfaqësuesit të përhershëm të Hungarisë, në notën e paraqitur Sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme, nr.XX, në të cilin u cekën këto konstatime (apo raste) të së drejtës ndërkombëtare tregtare (A/C.6/L, Pika 3)⁶

a) shitblerja ndërkombëtare e të mirave materiale:

I) lidhja e kontratave,

II) kontratat e përfaqësimit,

III) kontratat mbi shitjen ekskluzive,

b) letrat me vlerë dhe akreditivi dokumentar,

c) dispozitat mbi afarizmin në tregtinë ndërkombëtare,

d) sigurimi,

e) transporti:

I) transporti detar,

4 Goldštajn, Konvencije, f. 7. 1974, f. 3-34.

5 Po aty, fq. 7.

6 C. Schmittoff, Postupan razvoj medjunarodnog trgovačkog prava, “Informator”, Zgb, 1972, f. 12-80.

- II) transporti ajror,
 - III) transporti rrugor dhe hekurudhor i mallrave,
 - IV) pronësia industriale dhe të drejtat e autorit.
- g) arbitrazhi tregtar.

Këtë punë konkrete të organit të lartë ndërkombëtar përfaqësuesi i Holandës e shprehu kështu: “Kombet e Bashkuara tashmë patën hyrë në dekadën e mesme të zhvillimit, kur Konferenca e Kombeve të bashkuara për Tregti dhe zhvillim inicoi një program ambicioz për bashkëpunim në fushën e zhvillimit ekonomik dhe rritjes së tregtisë ndërkombëtare. Kjo ka qenë me rëndësi që të pengohet që zhvillimi i së drejtës të mos ngecë në raport me përparimin teknik⁷ dhe arritjet materiale”.

Tregtia ndërkombëtare po i krijon vetes rregulla juridike autonome, të cilat në një masë të madhe janë të pavarura nga sistemet nacionale. Të drejtën autonome tregtare mund ta gjejmë në kushtet e përgjithshme të shitjes, në kontratat e aderimit apo tipe, në uzancat dhe në doket tregtare.⁸ Në këtë përmbajtje e drejta ndërkombëtare tregtare është në zhvillim të pareshtur, kështu që të drejtës së tillë i konvenon arbitrazhi. Bashkësisë ndërkombëtare afariste arbitrazhi i shërben që t’i evitojë mosmarrëveshjet afariste që gjatë zgjidhjes së kontesteve sipas mundësisë mos ta rrënojnë bashkëpunimin afarist. Për atë arsye arbitrazhi konsiderohet edhe si institucion i paqes. Hulumtimet shkencore dhe praktika kanë dëshmuar se ekzistojnë lëmenj të gjerë për të cilët është i mundur rregullimi i ngjashëm, sepse dallimet e sistemeve të ndryshme nacionale janë burim i pasigurisë në aspektin e komunikimit juridik ndërkombëtar. P.sh., E drejta e shitblerjes ndërkombëtare, E drejta ndërkombëtare e komunikacionit, E drejta e pronësisë industriale, E drejta e çekut dhe e kambialit dhe shumë të tjera janë lëmenj ku afrimi ka qenë i domosdoshëm e ku kjo edhe më parë është realizuar.⁹

E drejta ndërkombëtare tregtare po tregon metoda të ngjashme të punës, ka shikim të njëjtë të jashtëm dhe “ka të bëjë me aso teknike juridike që është trashëgim kulturor i njerëzimit, i cili u shërben njëjtë të gjithëve, pa marrë parasysh sistemin apo rregullimin shtetëror të shteteve të ndryshme dhe se institucionet themelore të saj nuk janë krijimtari e sistemeve shoqërore bashkëkohëse, por tradita e tyre është më e vjetër”.¹⁰ Krahas zhvillimit të së drejtës tregtare ndërkombëtare, është zhvilluar edhe arbitrazhi si institucion i rëndësishëm, i cili me shekuj e ka verifi-

7 Shih materialin 13.12. 1965 (A/C.6/sr-896, f. 4.

8 Goldštajn, *Konvencije*, f. 8-10.

9 Ibid.

10 Schmittoff, v. c. f. 7-36.

kuar vendin e vet në ndarjen e së drejtës aty edhe atyre qarqeve afariste që kanë pasur nevojë. Ai nuk ka qenë e as që mund të jetë “ilaç” për të gjitha sëmundjet në jetën afariste në ekonomi, por është bërë mjete më i dashur dhe më i preferuar i qarqeve ekonomike që e kanë në dispozicion atë për eliminimin e konflikteve ndërmjet njerëzve dhe qarqeve afariste.¹¹ Mirëpo, Prof. Goldštajn e cek: “Pasi po përkufizohemi në arbitrazhin tregtar ndërkombëtar, nuk do të kërkojmë përparësi të arbitrazhit, para gjyqeve kur kemi të bëjmë me transaksionin e brendshëm afarist, do të thotë lidhur me kontestin që ngjan ndërmjet dy ndërmarrjeve tona”.¹²

Edhe arbitri në lëmin e tregtisë ndërkombëtare ka për detyrë, si dhe gjykatësi, që ta zgjidhë kontestin dhe ta ndajë të drejtën, për dallim nga gjykatësi, i cili atë nuk e bën në emër të shtetit e as në suazë të sistemit nacional juridik. Këtu bëhet dallimi dhe ndërmjet arbitrazhit të jashtëm nacional i cili më së shpeshti është i lidhur me ndonjë sistem juridik – nacional (të shtetit të vet apo për të drejtën që palën merren vesh siç mund të caktohet ndonjë e drejtë e sistemit neutral juridik). Kurse arbitrazhi ndërkombëtar ose arbitri i saj “nuk është mbrojtës i asnjë rendi juridik nacional”, por ka liri më të madhe që t’u largohet dispozitave shtetërore, të cilat nuk ka mundësi të përjashtohen dhe kështu bën kombinimin e të drejtave të ndryshme dhe parimeve të së drejtës tregtare, të cilat do të ishin të pranueshme nga palët e nacionaliteteve të ndryshme.¹³

Në literaturë arbitrazhi definohet në mënyrë të ndryshme. Për shembull, Prof. Triva e definojnë arbitrazhin “Si trup të karakterit joshtetëror, i përbërë nga (një ose më tepër) persona për zgjedhjen e të cilëve palët janë marrë vesh, të cilat me marrëveshje dhe vullnetarisht ia besojnë zgjidhjen përfundimtare të kontestit pronëso- juridik”.¹⁴ Kurse Domke arbitrazhin e definojnë “Si proces me të cilin palët vullnetarisht ia dorëzojnë kontestin për zgjidhje palës së tretë të paanshme-arbitrit, të cilin ato vetë e zgjedhin, respektivisht së cilës i drejtohen me qëllim të marrjes së vendimit përfundimtar”.¹⁵ Do të thotë se karakteristikat kryesore të arbitrazhit tregtar ndërkombëtar do të ishin kryesisht këto:

- a) se arbitrin apo arbitrit i zgjedhin vetë palët,
- b) se arbitrit në aspektin profesional janë të aftësuar në tregtinë ndërkombëtare,
- c) se aplikohet e drejta e caktuar materiale,

11 Goldštajn, *Medjunarodna trgovačka arbitraža*, Zgb., 1975, f. 3.

12 Ibid.

13 Goldštajn, v. c. f. 5.

14 S. Triva, *Arbitražna klauzula* (u Općim Uvjetima poslovanja), “Informator”, Zgb, 1970, f. 185-200.

15 A. Goldštajn, v. c. f. 3-8.

d) se procedurën për gjykim parimisht e përcaktojnë palët,
e) sipas parimit, dominon njëshkallësia,
f) gjykimi nuk është publik,
g) mungesa e notës politike,
h) se gjykimi zhvillohet jashtë aparatit shtetëror, kështu që arbitrazhi ndërkombëtar i zëvendëson, si alternativë, gjyqet shtetërore të shteteve të ndryshme.

i) dhe se dukshëm është më ndryshme ndërmjet palëve dhe marrëdhënia e tyre ndaj arbitrave.¹⁶ Nga kjo që u cek mund të konstatojmë së nga arbitri pritet më tepër se nga gjyqi, sepse ai nuk e aplikon vetëm të drejtën, por duhet t'i shqyrtojë rrethanat që i kanë sjellë palët deri te kontesti, të konstatojë se a kanë qenë sjelljet e tilla të pakuptimta në kuptim të relacioneve apo asaj që është e rëndomtë dhe çka mund të pritet në përgjithësi në atë situatë. Arbitri, domethënë, konstaton se çka konsiderohet si aksion i pranueshëm, kontrollon se sa është bërë përjashtim nga kjo dhe kështu kontribuon në riparimin e padrejtësisë.¹⁷

Sa i përket arbitrazhit tregtar ndërkombëtar, mund të merren kritere të ndryshme. Kështu do të merret parësisht në konsiderim fakti se kemi të bëjmë me transaksionin afarist, i cili është i lidhur me botën e jashtme, pastaj shtetësia e arbitrave, selia e arbitrazhit në territorin e shtetit të tretë etj.

Konventa evropiane mbi arbitrazhin ndërkombëtar tregtar parashih aplikimin e dispozitave të saj në kontestet që shkaktohen në relacionet e tregtisë ndërkombëtare, nëse selia e palëve është në shtete të ndryshme (neni I/1.a) Po ashtu rregullorja e gjyqit të arbitrazhit të Odës Tregtare Ndërkombëtare në Paris e përcakton funksionin e atij gjyqi me qëllim që t'i zgjidhë kontestet afariste të karakterit ndërkombëtar.

Ligji Uniform mbi shitjen e sendeve të luajtshme parashih se do të aplikohet mundësia e arbitrazhit në kontratat e lidhura ndërmjet palëve të cilat i kanë selitë e tyre në territorin e shteteve të ndryshme (neni 1-a).

Po ashtu Konventa mbi parashkrimin në lëmin e shitjes ndërkombëtare trajton se kontrata ka karakter ndërkombëtar, nëse në kohën e lidhjes blerësi dhe shitësi i kanë selitë e tyre në shtete të ndryshme. Mirëpo, edhe pse zgjidhja e kontesteve ndërmjet palëve të ndryshme paraqitet pranë arbitrazhit nacional, megjithatë këto janë konteste ndërkombëtare tregtare.

Në arbitrazhin tregtar ndërkombëtar palët e ruajnë anonimitetin e tyre, sepse kërkesën për shqyrtim nuk e merr askush tjetër përveç palëve.

16 Goldštajn, v.c. f. 11.

17 S. Triva, v.c. f. 184-187.

Në kohë të fundit për njerëzit afaristë dhe udhëheqësit përgjegjës i kanë mirë të njohura përparësitë e arbitrazhit tregtar ndërkombëtar. Shumica e nënshkruesve të kontratave ndërkombëtare, për t'u mbrojtur (aspekti preventiv) nga kontestet eventuale, tani e implementojnë klauzolën kontraktuese, në të cilën parashihet mundësia për t'iu drejtuar qendrës ndërkombëtare të arbitrazhit për shërbime të caktuara. Mund të themi se njëra ndër qendrat më të respektuara për shërbime të tilla sot është ajo e Odës Tregtare Ndërkombëtare në Paris.¹⁸ Është me rëndësi të ceket çështja e caktimit të së drejtës adekuate materiale, e cila në përgjithësi mund të caktohet në dy mënyra:

1. ose vetë palët e cekin në kontratë,
2. ose caktohet sipas normës së kolizionit, nëse palët nuk e kanë caktuar.

Disa prej arbitrazheve, siç është ANT-re e Parisit i japin edhe udhëzimet konkrete për shkak se gjatë përvojës së tyre kanë vërejtur palët që nuk e bëjnë dallimin e së drejtës, e cila aplikohet në procedurë që dallohet nga e drejta e që aplikohet në zgjidhjen e kontestit. Te palët të cilat nuk janë mjaft të udhëzuara mund të krijohet pasqyrimi i shtrembër, se në këtë rast ndonjë e drejtë materiale është kontraktuar vetëm për rastin e kontestit, që assesi nuk është e pranueshme. Si në njërin ashtu edhe në të dytin plan ANT i ka përcaktuar duke i përshtatur dispozitat përkatëse (ligjet ndërkombëtare) të drejtës private në kuptim të plotë.

Për këtë arsye u preferohet palëve se marrëveshja duhet të jetë e vlefshme, në radhë të parë, si masa më e rëndësishme e sigurisë. Andaj preferohet që të aplikohet forma me shkrim. Efikasiteti i klauzolës së arbitrazhit, para së gjithash, varet nga ekzistimi i vetë asaj, prandaj rekomandohet forma me shkrim. Përpilimi jo si duhet i klauzolës së arbitrazhit gjithnjë nuk ndikon në përdorshmërinë e saj. Për shembull, kur nuk ekziston dyshimi në institucionin të cilin palët kishin për qëllim ta caktojnë, mirëpo me këtë do të zvarritet studimi i kontestit. Po ashtu preferohet që nuk duhet të kufizohet kompetenca e arbitrit (siç janë disa kufizime, p.sh., pengon kur arbitri autorizohet vetëm të bëjë interpretimin e kontratës, e që mos të ketë mundësi të marrë edhe vendimin përfundimtar lidhur me rastin konkret).

Nuk duhet të multiplikohet kompetenca gjyqësore, do të thotë nuk bën të kombinohen ndërmjetësimi i më shumë qendrave të arbitrazhit ose i një qendre të arbitrazhit dhe ndonjë gjyqi.

18 Në ATN: Më shumë se 92% të vendimeve të gjyqit vullnetarisht janë kryer edhe mbi 250 raste shqyrtohen për çdo vit, mbi 50% të rasteve kanë të bëjnë me shumën mbi 2.00.000 \$ dhe është e hapur për të gjitha vendet e botës.

Klauzolat që përmbajnë elemente që krijojnë kundërthënie janë shumë të vështira për aplikim edhe atëherë kur nuk janë tërësisht nule. Që të mos ceken klauzolat për të cilat palës tjetër nuk i janë të njohura dhe nuk u është tërhequr sa duhet vërejtja. Pasi kompetenca gjyqësore varet nga marrëveshja që është lidhur ndërmjet palëve, duhet mënjanuar situatën që njëra palë të pohojë ose të mund të pohojë se nuk ka ditur për to. Ky qëllim në disa sisteme ligjore është i lejuar kur klauzola e arbitrazhit është përfshirë në kushtet e përgjithshme të shtypura (siç janë kontratat formulare). Andaj, është e preferueshme që të shmanget (mënjanohet) çdo mundësi e kontestimit, do të thotë klauzola të paraqitet asisoji mos t'i shmanget kujdesit të palës tjetër. Këtë e mundëson dhe e parasheh edhe neni II i Konventës së Nju-Jorkut mbi pranimin dhe përbarimin (ekzekutimin) e vendimeve të arbitrazheve të huaja¹⁹ kur thotë: “Me kontratë me shkrim nënkuptohet klauzola e arbitrazhit e paraparë në kontratë ose “kompromisi” i nënshkruar nga palët, ose i paraparë në letrat këmbysesë ose në telegramet e tyre”. Edhe Konventa e Evropës²⁰ mbi arbitrazhin tregtar ndërkombëtar, në nenin VII, parasheh: “Palët janë të autorizuar të caktojnë të drejtën të cilën arbitrit duhet ta aplikojnë në zgjidhjen e konfliktit. Në mungesë të marrëveshjes së palëve për të drejtën meritorë, arbitrit do ta aplikojnë ligjin të cilin e përcaktojnë rregullat e tij për këtë kontest, ligjin aplikimin e të cilit arbitrit e konsiderojnë të përshtatshëm për atë kontest. Në të dy rastet arbitrit do t'i kenë parasysh dispozitat e kontratës dhe doket tregtare. Neni VII, al. 2, më tutje, parasheh se: “Arbitrit do të vendosin, duke iu përmbajtur ekskluzivisht parimeve të drejtshmërisë, nëse kjo i përgjigjet dëshirës së palëve dhe nëse kjo është e lejuar me ligjin që aplikohet në arbitrazh”.

Të analizojmë edhe aspektin krahasues të kësaj çështjeje si e parashohin disa shtete në dispozitat e tyre nacional rregullimin e kësaj problematike. Në Itali arbitrit duhet t'u përmbahen dispozitave të së drejtës materiale, po qe se palët, sipas nenit 822 mbi Procedurën civile, nuk i kanë autorizuar që ato të gjykojnë sipas drejtshmërisë. Mospërmbajtja e këtij parimi, sipas nenit 820 KPC, është shkak I anulimit të aktgjykimit.²¹

19 Shih Konventën e Nju Jorkut të 10 korrikut të vitit 1958.

20 Shih, *Konventën e Evropës mbi arbitrazhin tregtar ndërkombëtar të vitit 1961* (të 21 prillit).

21 Dr. M. Horvat, *Odredjivanje materijalnog (nadležnog) prava u odsustvu autonomije volje* (U SPOLNJOTRGOVINSKA ARBITRAŽA, II, UP, Bgd, 1965, f. 53-63.

Në Gjermani arbitrit me ligj nuk janë të kufizuar as për dispozita të procedurës e as të së drejtës materiale për zgjidhjen e kontestit.²² Në përgjithësi konsiderohet se kjo varet se çka kanë dëshiruar palët, por po ashtu në përgjithësi prezumohet se palët kanë dëshiruar që t'u japin arbitrave autorizime të gjera. Te ekzekutimi sipas nenit 1044, te shqyrtimi i mungesave të rëndësishme shqyrtohet vetëm çështja se a mos aktgjykimi i arbitrazhit ka cenuar “order public”.

Sipas të drejtës së Austrisë, në parim arbitrat duhet të vendosin sipas dispozitave juridike, por edhe nëse nuk u përmbahen atyre nuk ka pasoja vendimi i marrë, po qe se nuk ka cenuar “order public”. Sipas të drejtës zvicerane (të shumicës së kantoneve: Ibernit, Lucernit, Hidwalden, Obwalden, Schwyz, Schaffizse, Zoud, Uri, Thurgovie, Zürich) zakonisht arbitrat janë të autorizuar të vendosin sipas dispozitave ligjore, po qe se palët nuk i kanë autorizuar që të vendosin sipas drejtshmërisë. Në tri kantone siç janë Hragau, Ticino, Wallis është e kundërta. Arbitri duhet të gjykojë sipas drejtshmërisë,²³ nëse palët nuk e kanë autorizuar shprehimisht që të gjykojë sipas dispozitave ligjore.

Në Angli arbitrat duhet të veprojnë gjithmonë sipas normave juridike. Gjyqi e bën kontrollimin e aktgjykimeve të arbitrazhit aty ku paraqiten gabime juridike.

Në SHBA, sipas ligjit mbi arbitrazhin të vitit 1925 dhe të Ligjit mbi arbitrazhin të shtetit të Nju-Jorkut të vitit 1920, sipas këtij të funti arbitrat nuk janë të obliguar t'u përmbahen normave juridike, nëse kjo nuk u është kushtëzuar me kontratën mbi arbitrazhin. Nuk ekzistojnë dispozita ligjore që aktvendimet e arbitrazhit të arsyetohen, kështu që zakonisht në rastet e kontesteve tregtare ato janë të paarsyetuara. Dallimet ndërmjet shteteve të ndryshme po mënjanohej me ndihmën e institucionit “American Arbitration Association”, rregullat e së cilës janë shembull për shumicën e organizatave tregtare, bursave dhe formave të tjera të organizuara që kanë interes për këto udhëzime.

Në Danimarkë arbitrazhat gjykojnë sipas parimit “ex aequo et bono”, kështu që nuk janë të lidhur në aplikimin e normave ligjore, megjithatë duhet t'i respektojnë disa norma të natyrës imperative të order public; po ashtu edhe aktvendimet e tyre nuk është e obligueshme të arsyetohen.

22 Gaupp-Stein-Schanke, Komentar der Z.O.P.8 1034, Në librin: Balladore-Pallieri, *Le arbitrage prive*, Paris, 1935, f. 355.

23 F. E Klein, *Considerations sur l'arbitrage rivote en droit international prive*, Bale, 1955, f. 307-8.

Kësaj çështje i kushtojnë rëndësi të konsiderueshme edhe “Rregullat mbi arbitrazhin” të Komisionit të Kombeve të bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL) të vitit 1976,²⁴ ku në nenin 3 të këtyre rregullave parashihet lajmërimi mbi arbitrazhin:

1. pala e cila kërkon arbitrazhin (më tutje paditësi) e lajmëron mbi arbitrazhin palën tjetër (më tutje të paditurin):

2. konsiderohet se procedura e arbitrazhit ka filluar në ditën kur i padituri ka marrë lajmërimin mbi arbitrazhin:

3. lajmërimi mbi arbitrazhin duhet të përmbajë:

a) kërkesën që kontesti t’i drejtohet arbitrazhit,

b) emrat dhe adresat e palëve,

c) klauzolën e arbitrazhit ose marrëveshjen e posaçme mbi arbitrazhin në të cilin pala thirret,

d) shenjë apo numrin e kontratës nga e cila ose për të cilën kontesti është shkaktuar,

e) natyrën e padisë dhe cekjen e shumës të kontestuar nëse ajo ekziston,

f) ndihmën apo mjetin juridik që kërkohet,

g) propozimin mbi numrin e arbitrave (do të thotë një apo tre), nëse palët lidhur me këtë nuk janë marrë vesh më parë,

m) kërkesëpadinë nëse padia nuk është dërguar me lajmërim të arbitrazhit, paditësi është i detyruar që në afatin të cilin e cakton gjyqi arbitrues t’ia parashtojë padinë me shkrim çdo arbitri veçmas.

Padisë duhet t’i bashkëngjitet përkrimi i kontratës dhe marrëveshja e arbitrazhit, po qe se ajo nuk është e cekur në kontratë. Paditësi mundet padisë t’ia bashkangjesë të gjitha dokumentet të cilat konsideron se janë relevante ose mund t’i cekë dokumentet ose provat e tjera dëshmuese të cilat dëshiron t’i ofrojë ai.

Të gjitha këto rrethana janë me rëndësi të kryhen me ekspedividet të kërkuar, sepse ekzistojnë konventat si ajo e Nju Jorkut, e cila i ka përcaktuar kushtet në të cilat mundet të lejohet pranimi dhe përmbarimi ose sipas Konventës në fjalë, kur nuk ekzistojnë kushtet për pranim dhe përmbarimin²⁵ e vendimit të arbitrazhit, do të refuzohet me kërkesën e palës kundër së cilës kërkohet përmbarimi. Mirëpo, Konventa i vë për detyrë përmbaruesit që të dëshmojë ekzistimin e shkaqeve për refuzim. Kryesisht shkaqet për refuzimin e pranimit dhe të përmbarimit të vendimit të trupit arbitrues janë këto:

24 A. Goldštajn, *Medjunarodna trgovačka arbitraža*, Zgb, 1977, f. 85, Po ashtu, J. Vilues, *Savremeni problemi spoljnotrgovinske arbitraže*, f. 3-13.

25 Shih Nenin V të Konventës së Nju Jorkut të vitit 1958.

a) Që palët të cilat e kanë lidhur marrëveshjen e arbitrazhit të jenë të paafta, ose vetë marrëveshja e arbitrazhit të mos jetë e vlefshme – aftësia e padive vlerësohet me statut personal të palës në fjalë (sipas ligjit të shtetit apo domocilit të palës), kurse vlera e marrëveshjes së arbitrazhit sipas ligjit në bazë të të cilit është nxjerrë vendimi i arbitrazhit.

b) Që pala kundër të cilës kërkohet pranimi ose përmbarimi nuk ka qenë në rregull e informuar për caktimin e arbitrazhit,²⁶ ose procedurës së arbitrazhit ose ka qenë e pamundur që t'i përdorë mjetet e tij të mbrojtjes për shkaqet që janë evidente në lidhje me rendin publik, e të cilat i parashih edhe Konventa e Gjenevës (neni 2, pika b.)²⁷

c) Që vendimi ka të bëjë me kontest i cili nuk ka qenë i paraparë me marrëveshje të arbitrazhit, që përmban dispozita të cilat i kalojnë kufijtë e marrëveshjes së arbitrazhit. Mirëpo, për dallim nga Konventa e Gjenevës (neni 2, pika c), këtu parashihet mundës e pranimi të pjesërishtëm ose të përmbarimit në pikëpamje të pjesës së vendimit, i cili është i mbuluar me marrëveshjen e arbitrazhit.

d) Që formimi i gjyqit të arbitrazhit ose i procedurës së arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me të drejtën e shtetit ku është kryer arbitrazhi.

e) Që vendimi të jetë bërë i obligueshëm për palët ose atë ta ketë anuluar ose ndaluar organi kompetent i shtetit në të cilin ose në bazë të cilit ligj është nxjerrë vendimi. Kurse sipas Konventës së Gjenevës (neni 1, al. 2 pika d.) kërkohet që vendimi të jetë definitiv në vendin ku ai është marrë e që në praktikë ka krijuar nevojën që vendimi të shpallet përmbarues në vendin ku ai është nxjerrë, e më pastaj të fillojë procedura e përmbarimit në vendin e përmbarimit (që do të thotë ekzekutimi i dyfishtë). Sipas Konventës së Nju-Jorkut, kërkohet që vendimi i arbitrazhit të jetë i obligueshëm për palët (do të thotë debitori tani duhet të dëshmojë se nuk është i obligueshëm) që do të thotë se tani nuk mund të sulmohet me mjete të rregullta juridike (goditëse) dhe sa i plotëson prezumimet për lejen e përmbarimit (ekzekutimit).

Krahas këtyre shkaqeve, Konventa e Nju Jorkut (neni V, al. 2.) i parashih edhe dy shkaqe për shkak të të cilave vendimi i përmbarimit (ekzekutimit), kur të konstatohet ekzistimi i tyre, mund ta refuzojë pranimin dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit.

a) nëse objekti i kontestit, sipas të drejtës së atij shteti, nuk mund të vendoset me anë të arbitrazhit dhe

26 Shih Konventën e Gjenevës mbi përmbarimin e vendimeve të arbitrazhit (arbitrazheve të huaja) të 26.09.1927.

27 Ibid.

b) Po qe se pranimi dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit do të ishte në kundërshti me rendin publik të atij vendi.²⁸

Në fund të cekim se arbitrazhi sot është pranuar në përgjithësi në tregtinë ndërkombëtare. Shumica e kontesteve, edhe sipas shënimeve statistikore, tregojnë se kontestet nga lëmi i tregtisë ndërkombëtare të zgjidhura pranë gjykatave të rregullta janë përjashtim, sidomos në vendet me ekonomi të zhvilluar. Tregtia ndërkombëtare ka ndikim të madh në ngritjen e rejtingut (renomes) të arbitrazhit, por jo vetëm këtë. Ajo gjithnjë e më tepër po ka ndikim dhe rëndësi reciproke në besimin dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve me sisteme të ndryshme ekonomike dhe shoqërore. Arbitrazhi në praktikën e tij ka dëshmuar tendencën e tij internacionaliste në aspektin e qasjes problemeve dhe aplikimit më liberal të normave juridike, sepse, siç e cek prof. Goldshtajn²⁹ kontesti me element të huaj ka nevojë për një qasje më liberale në aplikimin e së drejtës.

Për këtë shkak do të duhet sa më tepër të stimulohen përpjekjet e agjencive ndërkombëtare që edhe më guximshëm të bëjnë formimin e së drejtës autonome të tregtisë ndërkombëtare, të ndarë nga veçoritë historike dhe doktrinare të sistemeve nacionale juridike, të cilat në esencë gjithkund janë të ngjashme dhe në përgjithësi është pranuar në kufijtë të cilët i imponojnë nevojat e rendit publik nacional (legis fori) dhe eventualisht rendi publik ndërkombëtar, e që me këtë të gjitha pajtohen.³⁰ Me krijimin e së drejtës së re ndërkombëtare tregtare, siç e cek prof. Goldshtajn, “njëherësh do ta lerë anash problematikën e normave kolizive të së drejtës dhe do t’i japë të drejtës ndërkombëtare private përmbajtje të re”. Në vend të së drejtës kolizive, ajo do të shndërrohet në të drejtë mbi transaksionet me element të huaj në kuadër të së cilës e drejta ndërkombëtare tregtare do të zënë vend të posaçëm. Kjo është rruga për eliminimin e njërit nga problemet më të rënda të tregtisë ndërkombëtare se si të gjendet e drejta adekuate, e cila do të duhej të aplikohet në kontratë. E nëse edhe është paraparë në kontratë, interpretimi i të drejtës nacionale nga ana e gjykatësve ose arbitrave të huaj krijon vështirësi të konsiderueshme.³¹

Për rëndësinë e këtyre pikëpamjeve flet edhe Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në mbledhjen e saj XXXI, të vitit

28 Këto shqye ekzistojnë edhe në Konventën e Gjenevës (neni 1, al. 2 pika b. dhe pika e.).

29 Goldshtajn, Konvencije, v.c. f. 12.

30 Schmittoff, v.c. f. 97.

31 Goldshtajn, v.c. f. 12.

1976, e cila miratoi rezolutën nr. 31/98, me të cilën Rregullat e arbitrazhit (UNCITRAL-it) u rekomandohen që t'i shfrytëzojnë me rastin e zgjedhjes së konflikteve në fushën e tregtisë ndërkombëtare, kurse nga sekretari i përgjithshëm kërkohet që sa është e mundur të bëjë distributimin e këtyre rregullave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara. Kjo alternativë e rregullave të arbitrazhit do të kenë pëlqim dhe do t'i tërheqin sidomos vendet në zhvillim. Përveç përparësive të përgjithshme që kanë, arbitrazhi paraqet edhe një zgjidhje psikologjike, sepse vendeve siç janë këto (dikur të varura)³² do t'u mundësohet zgjedhja ndërmjet gjyqeve shtetërore të ish metropoleve dhe arbitrazhit, autoritetit i së cilës është aq më i madh, sepse vetë ndikimi i palëve në përbërjen e tij dhe qasja e tij zgjidhjes së problemeve në aspektin internacional dhe zbatimit të së drejtës janë në veçanti të potencuar. Kështu, arbitrazhi është zhvilluar si institucion i përshtatshëm jo vetëm për qarqet afariste, por edhe për shtete, respektivisht për persona publikë, të cilët lidhin kontrata mbi kryerjen e punëve publike apo punëve të ndryshme investuese,³³ imuniteti i mënjanuar në punët – transaksione pronësore-juridike tregtare shtetet më me dëshirë po e pranojnë arbitrazhin sesa gjyqin shtetëror.

Pra, të gjitha këto janë motivim dhe arsye pse sot më së tepërmi edhe kërkohen shërbimet e arbitrazhit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të konflikteve sidomos në relacionet e tregtisë së jashtme, e që është me rëndësi edhe për ndërmarrjet tona, si dhe kuadrin e tyre profesional që merret me punë të tregtisë së jashtme. Ky kuadër duhet t'i njohë këto rregulla dhe parime të funksionimit të arbitrazheve ndërkombëtare, për arsye se në kohën e fundit këtyre problemeve është duke iu kushtuar rëndësi jo vetëm praktika afariste dhe shkenca, por edhe organet më të larta dhe më kompetente botërore.

32 Ibid.

33 Ibid.

KAPITULLI I DYTË

I. HISTORIK I SHKURTËR RRETH ZHVILLIMIT TË ARBITRAZHIT

Arbitrazhi si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet palëve në biznes mendohet se është i vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Ekzistojnë mendime të bazuara se arbitrazhi i paraprin gjyqësisë. Prania e arbitrazhit nëpër shtete me kultura të ndryshme dëshmon se ai është një fenomen interkulturore dhe se me rëniet dhe ngritjet e tij u rezistoi të gjitha fazave të historisë që nga antika e vjetër e deri në ditët e sotme.

1.1. ARBITRAZHI NË KOHËN E VJETËR

Në kohën e vjetër arbitrazhi si fenomen interkulturore, por edhe si institucion alternativ për zgjidhjen e kontesteve në transaksionet biznesore, ishte i pranishëm dhe u kultivua në Greqinë Antike, Romën e Lashtë, Egjiptin e Vjetër etj.

a) Arbitrazhi në Greqinë Antike. Në Greqinë e Vjetër arbitrazhi shërbente si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve të shfaqura ndërmjet poliseve greke qytetet-shtete të asaj kohe. Vendimet e arbitrazhit në Greqinë Antike gëzonin një reputacion të madh ku shpeshherë ndodhte që ato të gdhendeshin në pllaka mermeri dhe të vendoseshin nëpër shtylla të faltoreve të njohura të asaj kohe. Për reputacionin e arbitrazhit asokohe dëshmon edhe fakti se ai u përfshi edhe në reformat e Sollonit. Aristoteli për arbitrazhin thoshte se “*arbitrat angazhohen për drejtshmëri ndërsa gjyqtarët për ligjshmëri dhe se arbitrazhi është krijuar që drejtshmëria të mund të aplikohet*”³⁴. Sipas Aristotelit, dallimi ndërmjet arbitrazhit dhe gjykatës ishte i pranishëm që në kohën antike.

b) Arbitrazhi në Romën e Lashtë. Edhe te romakët instituti i arbitrazhit si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve ishte i pranishëm dhe aplikohet. Ciceroni për arbitrazhin thoshte se “*arbitrazhi është një*

34 Aristoteli – Retorika, 1.13.1374.6.42. Perović J., Ugovor o Međunarodnoj trgovinskoj arbitraži, Beograd, 2002, fq. 9.

proces ku krejtësisht nuk mund të fitohet as krejtësisht nuk mund të humbet”³⁵. Rregulla të shumta për arbitrazhin ekzistonin edhe në “*digesta*” ku sipas këtyre rregullave, arbitrazhi nuk mund të vepronte jashtë kontratës të lidhur për të. Në ato rregulla parashihej se, nëse arbitri gjatë procedurës ka bërë ndonjë gabim, ai atë nuk mund ta korrigjonte më vonë. Nga kjo nënkuptohet se nuk lejohej ndërhyrja në vendimin e arbitrazhit qoftë edhe për ta korrigjuar atë. Pra vendimi konsiderohej i formës së prerë dhe nuk lejohej ushtrimi i ankesës kundër tij. Përkundër këtyre rregullave rigoroze, kontrata për arbitrazhin në Romën e Lashtë, juridikisht nuk ishte e sanksionuar dhe se me lidhjen e saj nuk derogohej apo bartej kompetenca e gjykatës së rregullt tek arbitrazhi. Nëse ndonjëra prej palëve kontraktuese i shmangej përmbushjes së vendimit të arbitrazhit, atëherë ajo detyrohej që palës tjetër t’ia paguajë edhe një sasi shtesë të parave, që quhej poena.

1.2. POZITA E ARBITRAZHIT NË KOHËN E MESME

Sipas të dhënave ekzistuese mund të konkludohet se arbitrazhi fillimisht shërbeu si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve në nivel nacional por me kalimin e kohës dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet shteteve ai gradualisht filloi të marrë edhe karakter ndërkombëtar. Sipas të dhënave ndikim të veçantë në zhvillimin e arbitrazhit të kohës së mesme pati shfaqja e panaireve tregtare si në nivel nacional, po ashtu edhe në nivel ndërkombëtarë. Në këtë fazë të historisë, arbitrazhi vështrohej me admirim edhe nga ana e sundimtarëve të ndryshëm të asaj kohe dhe zinte vend të merituar në ordonansat dhe ediktet e tyre. Arbitrazhi lulëzimin e vërtetë e përjetoi me rastin e shfaqjes së idesë për lirinë dhe barazinë ndërmjet njerëzve, pronës private dhe individualizmit të cilin e proklamonte revolucionin borgjez-francez. Fryma e kësaj ideje krijoi kushte të volitshme për zhvillimin e diturive mbi lirinë e kontraktimit dhe autonominë e shprehjes së lirë të qytetarëve. Në Francën e pasrevolucionit borgjez, arbitrazhi konsiderohej si institut i së drejtës natyrore dhe si “mënyra më e mirë e përfundimit të konflikteve ndërmjet qytetarëve”³⁶. Kushtetuta franceze e vitit 1791, parashihte se “është e drejtë e çdo qytetari që kontestet ndërmjet tyre t’i zgjidhen me arbitrazh dhe se arbitrazhi në Francë nuk mund të rrezikohej me asnjë lloj

35 Cicero-oratio pro q roscio i commoedo 4,5,6 sipas Aromak Minerva Florilegij, Latinske Izreke, Zagreb, 1988, fq 52. Perović J., Ugovor o Međunarodnoj trgovinskoj arbitraži, Beograd, 2002, fq. 10.

36 R. David, L’arbitrage dans commerce international, Paris, 1982, fq. 126. Perović J., Ugovor o Međunarodnoj trgovinskoj arbitraži, Beograd, 2002, fq. 11.

akti të pushtetit ligjvënës francez”. Qëndrimi i këtillë i Kushtetutës franceze më së miri pasqyron pozitën e arbitrazhit gjatë asaj periode si dhe rëndësinë e respektin që ai kishte asokohe në Francë.

1.3. ZHVILLIMI I ARBITRAZHIT NË KOHËN E RE

Zhvillimi i arbitrazhit në kuadër të marrëdhënieve tregtare e posaçërisht në marrëdhëniet e tregtisë ndërkombëtare konsiderohet si fenomen i kohës së re. Në fillim të shek. XIX disa shoqata të njohura tregtarësh dallohen për themelimin e arbitrazheve institucionale me të cilat do të zgjidhen kontestet e shfaqura nga marrëdhënia e tregtisë ndërkombëtare. Ndër më të dalluarat në këtë çështje ishin shoqëria e sigurimeve Lloyd dhe shoqata e tregtarëve me drithëra London Corn Trade Association, që të dyja me seli në Londër. Rregullat e këtyre arbitrazheve gradualisht tejkaluan ligjet nacionale dhe u ngritën në një sistem autonom ndërkombëtar, të cilin e imponuan korporatat e fuqishme.

Arbitrazhi gjatë historisë është përballur me rëniet dhe ngritjet e tij, por megjithatë arriti të mbijetojë deri në ditët tona dhe tani e tutje si duket do të mbetet si një institucion mjaft i rëndësishëm dhe mirë i organizuar për zgjidhjen e kontesteve si në tregtinë e brendshme, po ashtu edhe në atë ndërkombëtare.

2. NATYRA JURIDIKE DHE TEORITË MBI ARBITRAZHIN

2.1. NATYRA JURIDIKE E ARBITRAZHIT

Rreth natyrës juridike të arbitrazhit ekzistojnë qëndrime mjaft kontradiktore ndërmjet autorëve të ndryshëm të kësaj lëmie. Disa autorë mbajnë qëndrimin se përcaktimi i natyrës juridike të arbitrazhit nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë, por e rëndësishme është që ai të kryejë funksionin e tij për të cilin edhe është ngritur. Në favor të këtij mendimi ishte edhe konstatimi i udhëheqësit të dikurshëm kinez Deng Siao Ping i cili thoshte se *“nuk është e rëndësishme se maca është e bardhë apo e zezë, e rëndësishme është se ajo gjuan minj”*. Sipas konstatimit të Pingut e rëndësishme është që arbitrazhi të kryejë funksionin e tij për çka edhe është themeluar e jo problemi i përcaktimit të natyrës së tij juridike. Në anën tjetër, disa autorë mendojnë se përcaktimi i natyrës juridike të

arbitrazhit në mënyrë vendimtare ndikon në përcaktimin e elementeve qenësore të këtij institucioni si dhe në rrjedhat e procedurës pranë tij. Këta autorë thonë se përcaktimi i natyrës juridike të arbitrazhit ndihmon që sa më mirë dhe më qartë të kuptohet prejardhja dhe të përcaktohet pozita e tij si në sistemin juridik-nacional, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Të kuptuarit drejt dhe mirë i natyrës juridike të arbitrazhit ndihmon edhe në qartësimin e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet arbitrazhit në raport me institucionet tjera të kësaj natyre. Kontradiktat dhe dallimet rreth rëndësisë së përcaktimit të natyrës juridike të arbitrazhit janë të pranishme edhe në ditët tona.

2.2. TEORITË MBI ARBITRAZHIN

Natyrja juridike e arbitrazhit më së miri do të qartësohej përmes teorive mbi arbitrazhin. Teoritë për arbitrazhin janë: 1) teoria juridikonale apo publicistike, 2) teoria kontraktuale apo civilistike, 3) teoria e përzier apo hibride dhe teoria autonome sui iuris.

a) **Teoria juridikonale apo publicistike.** Sipas kësaj teorie, qëllimi i arbitrazhit është gjykimi, por dihet se monopolin për gjykim në duart e tij e mban shteti përmes gjykatave të tij kurse arbitrazhi mundet dhe guxon të gjykojë jo pse dikush ka dëshirë, por se atë e lejon shteti me ligjet e tij. Pra, sipas kësaj teorie kuptohet se bazë për funksionimin e arbitrazhit nuk është kontrata e palëve për arbitrazhin, por leja e shtetit që mundëson kontraktimin dhe organizimin e tij në cilësinë alternative apo paralele³⁷. Sipas kësaj teorie shteti jo vetëm se lejon, por e ndihmon dhe kontrollon atë dhe se vendimet e tij i barazon me aktgjykimet e gjykatës shtetërore. Po ashtu sipas kësaj teorie arbitrat konsiderohen persona publikë dhe duhet të gëzojnë imunitet sikurse edhe gjyqtarët dhe dihet mirëfilli se funksionet publike në një shtet nuk mund t'i ushtrojnë shtetasit e huaj. Sipas teorisë juridikonale arbitrazhi duhet të jetë i ndikuar nga ligjet e shtetit. Jurisdikcionalistët mendojnë se cenimi i fshehtësisë së procedurës së arbitrazhit mund të këmbëhet me ruajtjen e interesave vitale të shtetit si fjala vjen tentimi i shpëlarjes së parave apo ndonjë veprim tjetër i kësaj natyre i kryer nga ndonjëra prej palëve.

b) **Teoria kontraktuale apo civilistike.** Sipas teorisë kontraktuale thelbi i organizimit të arbitrazhit është kontrata e palëve për arbitrazhin. Përkrahësit e kësaj teorie thonë se kontrata për arbitrazhin jo vetëm se themelon tribunalin e arbitrazhit, por përmes saj mund të

37 Kneievi } Ga{o. Me|unarodna trgovinska arbitra`a, Beograd, 1999, fq. 26.

formësohet procedura, të zgjidhen arbitrat si dhe të përcaktohet e drejta materiale dhe procedurale kompetente në bazë të së cilës arbitrazhi do të rregullojë kontestin e shtruar për zgjidhje etj. Kontraktualistët mendojnë se vendimi i arbitrazhit nuk mund të barazohet me aktgjykimin e gjykatës sepse përbushja e vendimit përfundimtar të arbitrazhit realizohet në mënyrë vullnetare, ndërsa ai i gjykatës me dhunë. Gjithnjë sipas kontraktualistëve, arbitrat nuk kryejnë funksion publik por konsiderohen si përfaqësues të palëve, andaj shteti nuk bën të ndërhyjë në punët e tyre sepse ata autorizimin e nxjerrin nga autonomia e palëve e cila është e pakufizuar. Pra, palët lidhin kontratën për arbitrazhin ndërsa arbitrazhi atyre ua dhuron një kontratë tjetër, vendimin përfundimtar për kontestin e zgjidhur³⁸.

c) Teoria hibride apo e përzier. Praktika dëshmon se nëse kundërshtohen dy teori mes vete, atëherë është e pashmangshme për t'u shfaqur teoria e tretë e cila angazhohet për t'i zbutur kundërshtimet ndërmjet tyre duke u ofruar një qasje tjetër dhe më të arsyeshme. Sipas teorisë hibride arbitrazhi në vete përmban si elemente publiko-juridike, po ashtu edhe elemente privato-juridike sepse puna e tij fillon me kontratën si element privatojuridik dhe përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar si akt publiko-juridik. Pra, në fazën fillestare të arbitrazhit rolin kryesor e kanë palët e në fazën përfundimtare rolin kryesor e kanë arbitrat. Teorisë hibride në vitet e 50-ta të shek. XX i kontribuoi Soser Hall me konstatimin e tij se ndërmjet teorisë juridikcionale dhe asaj kontraktuale ekziston një lidhshmëri e përhershme dhe thotë *“arbitrat janë organ kuazi gjyqësor, por edhe jo dorë e zgjatur e shtetit dhe se vendimi i tyre i barazuar me atë të gjykatës, realizohet vetëm atëherë kur vihet në ekzekutim”*. Kohëve të fundit dominon mendimi se teoria e përzier më së miri prezanton pozitën e sotme të arbitrazhit në burimet e së drejtës së tij, si dhe në praktikën e tij³⁹.

ç) Teoria autonome (sui iuris). Teoria e katërt dhe e fundit rreth natyrës juridike për arbitrazhin u shfaq nga autorja Rubelin Devishi, në veprën e saj *L'arbitrage nature juridique en droit interne et en droit international prive*, Lion viti 1965. Devishi pranon se arbitrazhi posedon si elemente juridikcionale, po ashtu edhe elemente kontraktuale, por sipas saj prania e këtyre elementeve fare nuk ka rëndësi, por e rëndësishme është se arbitrazhi është instrument për plotësimin e nevojave të

38 Kështu funksionon arbitrazhi i lirë italian, sipas nenit 1322, të ligjit civil italian. Knežević G., Pavić. V., Arbitraža i ADR, Beograd, 2009, fq. 36.

39 J. Lea dhe I. Mistelis, S. KROL. Cit. i përgjithshëm 80. Knežević G., Pavić. V., Arbitraža i ADR, Beograd, 2009, fq. 37.

komunitetit biznesor në të drejtën private. Teoria autonome arbitrazhin e analizon më shumë nga aspekti social sesa nga ai juridik dhe konsideron se ligjet pozitive duhet t'i krijojnë kushte zhvillimit të tij të mëtejme. Në fund do theksuar se secila prej këtyre teorive i ka përparësitë dhe mangësitë e saj.

3. E DREJTA E ARBITRAZHIT DHE BURIMET JURIDIKE TË SAJ

Meqenëse e drejta e arbitrazhit gjithnjë po vjen duke u formësuar si një e drejtë specifike, ajo patjetër duhet që qenien e saj ta mbështesë në burimet, të cilat i shërbejnë si bazë për zhvillimin dhe aktivitetin e saj si degë në vete. Burimet kryesore juridike në të cilat mbështetet e drejta e arbitrazhit janë: kontrata për arbitrazhin, ligjet nacionale dhe konventat ndërkombëtare.

a) Kontrata për arbitrazhin. Kontrata për arbitrazhin është njëra prej burimeve kryesore juridike të së drejtës së arbitrazhit. Pa kontratë nuk do të ketë as arbitrazh, sepse përmes saj prezantohet sistemi privat i arbitrazhit, shprehet vullneti i lirë i palëve, bëhet përzgjedhja e arbitrave, përzgjidhet e drejta kompetente (materiale dhe procedurale), përcaktohet selia e arbitrazhit si dhe gjuha në të cilën do të zhvillohet procedura pranë tij. Sipas kësaj që u tha del se kontrata për arbitrazhin me të drejtë konsiderohet si burim kryesor për të drejtën e arbitrazhit, meqë palët vullnetarisht marrin mbi vete të drejtat dhe obligimet e dala nga ajo. Rreth kontratës për arbitrazhin do të bëhet fjalë më gjerësisht në kapitullin e tretë të këtij punimi.

b) Ligjet nacionale. Të dhënat rreth pranisë së arbitrazhit nëpër fazat e ndryshme të historisë dëshmojnë se ligjet nacionale janë burimi juridik më i vjetër që gjithherë gëzon përparësi në raport me burimet tjera juridike për të drejtën e arbitrazhit sepse edhe arbitrazhi ndërkombëtar aktivitetin e tij patjetër do ta zhvillojë në territorin e ndonjërit prej shteteve si dhe do të ndikohet nga ligjet e tij në fuqi. Siç dihet, fillimisht arbitrazhi ka filluar të funksionojë në nivel nacional e me kalimin e kohës shtrihet edhe në planin ndërkombëtar. Vlen të theksohet se ligjet e para për arbitrazhin në nivel nacional janë nxjerrë në Angli në vitin 1698, pastaj në Francë në vitin 1808 etj. Kohëve të fundit materia e arbitrazhit rregullohet qoftë me ligje të veçanta (si në SHBA, Angli, Rusi dhe Spanjë, Kosovë etj.) ose me rregullat e procedurës kontestimore (në Gjermani) apo edhe në kuadër të së drejtës private ndërkombëtare (në

Zvicër) etj. Mund të konkludohet se sa më shumë do të rritet nevoja për arbitrazhin si institucion për zgjidhjen e kontesteve, aq më shumë do të ketë kodifikime të reja të cilat do të hartohen si ligje të veçanta për arbitrazhin.

c) Konventat ndërkombëtare. Zhvillimi i hovshëm i tregtisë ndërkombëtare ndikoi drejtpërsëdrejti në rritjen e rolit dhe rëndësisë së arbitrazhit ndërkombëtar. Për t' i zgjidhur sa më drejtë dhe më mirë problemet e shfaqura në lëmin e tregtisë ndërkombëtare ishte e nevojshme që të krijohen rregulla uniforme me karakter ndërkombëtar. Si probleme në marrëdhëniet e tregtisë ndërkombëtare identifikoheshin plotvlershmëria e kontratës për arbitrazhin si dhe çështja e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj. Si pasojë e këtyre dy problemeve, lindi nevoja për hartimin dhe aprovimin e konventave ndërkombëtare për arbitrazhin. Konventat ndërkombëtare për arbitrazhin janë të karakterit global dhe të karakterit regional. Konventat multilaterale për arbitrazhin janë: Protokollin i Gjenevës për klauzolën e arbitrazhit i vitit 1923, Konventa e Gjenevës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj e vitit 1927, Konventa e Nju Jorkut për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj e vitit 1958, Konventa Evropiane për arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare e vitit 1961 (*sepse në këtë konventë kanë të drejtë të aderojnë edhe shtetet jashtë Evropës*) dhe Konventa e Uashingtonit për zgjidhjen e kontesteve investimore ndërmjet shteteve anëtare të kësaj Konvente dhe shtetasve të shteteve tjera po ashtu anëtare të kësaj Konvente të vitit 1965. Ndër konventat më të avancuara konsiderohen Konventa e Nju Jorkut e ratifikuar nga 142 shtete dhe Konventa e Uashingtonit e ratifikuar nga 155 shtete, e cila posedon një sistem special dhe quhet ICSID-International Centre for the Settlement of Investment Disputes.

Ndërsa konventat regionale të cilat shërbejnë si burim i të drejtës së arbitrazhit ndërkombëtar, pos konventës evropiane janë edhe Konventa e Mercasur-it e shteteve të Amerikës Jugore e vitit 1998, Konventa e OHADA-s në Afrikë, Konventa Internacionale e Panamasë e vitit 1975 dhe Konventa e Amanit e vitit 1987 e lidhur ndërmjet shteteve arabe. Në fund vlen të theksohet se si burime juridike për të drejtën e arbitrazhit mund të shërbejnë edhe rregulloret, praktika dhe doktrinat për arbitrazhin.

4. GJYKATA DHE ARBITRAZHI, NGJASHMËRITË DHE DALLIMET NDËRMJET TYRE

Për nga vështrimi, si gjykata po ashtu edhe arbitrazhi kryejnë funksion të njëjtë juridiko-gjykimore dhe se vendimet e tyre përfundimtare gëzojnë fuqi të njëjtë juridike. Edhe përkundër kësaj ngjashmërie këto dy institucione thelbësisht dallojnë mes vete. Dallimi ndërmjet këtyre dy institucioneve është se në gjykatë të rregullt gjykimin e kryen gjyqtari i zgjedhur apo i emëruar në përputhje me ligjin e shtetit, ndërsa në arbitrazh personi të cilit investiturën apo autorizimin ia jep pala me kontratën për arbitrazhin. Gjyqtari është bartës i funksionit publik, ndërsa arbitri nuk është bartës i funksionit publik. Gjyqtari gëzon besimin e shtetit, ndërsa arbitri besimin e palës të cilin rendi juridik shtetëror ia respekton. Misioni i gjyqtarit është i përhershëm, ndërsa misioni i arbitrit është i kufizuar dhe përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar për çështjen. Dallimi tjetër dhe më thelbësor është se gjyqtari është i obliguar të gjykojë vetëm në bazë të ligjit në fuqi, ndërsa arbitri mund të gjykojë në bazë të së drejtës kompetente (materiale dhe procedurale) të cilën e zgjedhin vetë palët, por edhe sipas drejtshmërisë nëse ashtu e kërkojnë palët me kontratën e tyre për arbitrazhin. Gjykatën e organizon dhe koncipon shteti me ligjet e tij ndërsa arbitrazhin e iniciojnë dhe koncipojnë vetë palët me kontratën e tyre për arbitrazhin. Këto janë disa nga ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet gjykatës dhe arbitrazhit.

5. ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR ARBITRAZHIT

Shkaqet të cilat i nxisin palët që kontestojnë e tyre ta zgjidhin pranë arbitrazhit apo gjykatës janë të shumta. Përkrahësit e arbitrazhit japin disa argumente nga të cilat palët motivohen për t'u përcaktuar që kontestet e tyre t'i zgjidhin me arbitrazh e ato janë se:

- arbitrazhi kontestet e parashtruara pranë tij i zgjidh në mënyrë miqësore dhe pa i tronditur marrëdhëniet e bashkëpunimit të mëtejme ndërmjet palëve në kontest.

- arbitrazhi do të jetë objektiv dhe i paanshëm në trajtimin e palëve pavarësisht se cili është nacionaliteti i tyre apo vlera e kontestit.

- arbitrazhi është autonom gjatë punës së tij dhe se palët janë faktori kryesor në konstituimin dhe koncipimin e punës së tij, gjë që nuk mund të ndodhë kështu edhe me gjykatën.

- arbitrazhi është më efikas, më i shpejtë dhe me më pak formalitete si dhe me shpenzime më të ulëta për zgjidhjen e kontesteve në raport me gjykatën.

- arbitrazhi garanton fshehtësinë e procedurës, përveç nëse palët janë marrë vesh ndryshe.

Pra këto ishin disa prej argumenteve të cilat palët i motivojnë për t'u përcaktuar për arbitrazhin si mekanizëm për zgjidhjen e kontestit.

Në anën tjetër, kritikët e arbitrazhit dobësitë e tij i shohin në:

- njëshkallshmërinë e tij si dhe mohimin e të drejtës së ushtrimit të ankesës ndaj vendimit të arbitrazhit.

- problemin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj.

- kufizimin e fushëveprimit të arbitrazhit rreth shqyrtimit të çështjeve tjera, të cilat do të ishin aktuale për lëndën kryesore në shqyrtim, sepse kështu e kufizon kontrata.

- mundësinë që arbitri si gjyqtar privat lehtë mund të ndikohet nga pala ekonomikisht më e fortë në dëm të palës më të dobët etj.

Vlen të ceket se edhe vetë përkrahësit e arbitrazhit si pikë të dobët të tij e konsiderojnë mungesën e fuqisë së tij për të aplikuar masat e përkohshme të sigurisë. Pra, këto ishin disa prej përparësive dhe mangësive të arbitrazhit si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve. Andaj mbetet në vullnetin e palëve që ato të përcaktohen se kontestin e tyre do ta zgjidhin me arbitrazh apo përmes gjykatës.

6. LLOJET E ARBITRAZHIT

Ndarja e arbitrazhit në lloje të ndryshme ndihmon që rreth tij të kemi njohuri më të thukëta si dhe ndihmon që palët të jenë më mirë të informuara se cilit arbitrazh duhet drejtuar për zgjidhjen e kontestit të tyre. Për ndarjen e arbitrazhit në lloje të caktuara ekzistojnë edhe kritere, në bazë të të cilave klasifikohet se cili lloj i arbitrazhit nuk kufizohet vetëm në lëminë civilo-juridike, por mund të zgjidhë edhe konteste nga lëmia e së drejtës publiko-juridike. Prandaj, arbitrazhi fillimisht ndahet në arbitrazhin e të drejtës publike dhe arbitrazhin e të drejtës private.

6.1. ARBITRAZHI I TË DREJTËS PUBLIKE

Arbitrazhet e të drejtës publike janë të gjitha ato arbitrazhe përmes të cilave zgjidhen kontestet e natyrës publiko-juridike. Palë pranë

këtij lloj arbitrazhi janë shteti dhe institucionet e tij. Arbitrazhi i të drejtës publike ndahet në arbitrazh publik nacional dhe në arbitrazhin publik ndërkombëtar.

a) Arbitrazhi i së drejtës publike nacionale. Me këtë lloj arbitrazhi zgjidhen kontestet e natyrës publike brenda territorit të një shteti si fjala vjen kontestet ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, apo kontestet të cilat lindin nga mosrespektimi i kontratës kolektive të punës, si dhe kontestet tjera të kësaj natyre të cilat janë arbitrabile për t'u zgjidhur me arbitrazh.

b) Arbitrazhi i të drejtës publike-ndërkombëtare. Me anën e këtij lloj arbitrazhi zgjidhen kontestet e shfaqura ndërmjet shteteve sovraane, ku shtetet dhe institucionet e tyre prezantohen si palë në kontest. Me arbitrazhin e të drejtës publike ndërkombëtare zgjidhen kontestet e natyrave të ndryshme ndërmjet shteteve sovraane si kontesti rreth përcaktimit të vijës kufitare apo siç ishte rasti me pengjet amerikane në Iran në vitin 1979, i cili u zgjodh përmes tribunalit të formuar nga këto dy shtete në Hagë.

6.2. ARBITRAZHI I TË DREJTËS PRIVATE

Arbitrazhet e të drejtës private janë ai lloj i arbitrazheve, që formohen mbi bazën e kontratës për arbitrazhin. Palë apo subjekte pranë arbitrazhit të së drejtës private zakonisht janë subjektet fizike dhe juridike të së drejtës civile, por në rrethana të caktuara subjekte të këtij arbitrazhi mund të jenë edhe shtetet sovraane me institucionet e tyre. Për shtetin si subjekt i këtij lloj arbitrazhi më së miri flet Konventa e Uashingtonit për ICSID arbitrazhin e vitit 1965.

Rreth përcaktimit të karakterit të arbitrazhit se është arbitrazh vendor, ndërkombëtar apo anacional ndihmojnë kriteret si: kriteri gjeografik (*selia e arbitrazhit*), prania e elementit të huaj në kontest (*natyra e kontestit*) dhe e drejta kompetente (*materiale dhe procedurale*) e aplikuar gjatë shqyrtimit dhe zgjidhjes së kontestit (*marrjes së vendimit përfundimtar*).

Mbështetur në kriteret e lartpërmendura arbitrazhi i të drejtës private ndahet në disa grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë këto lloje: arbitrazhi nacional, arbitrazhi i huaj apo ndërkombëtar dhe arbitrazhi anacional. Në grupin e dytë bëjnë pjesë arbitrazhet civilo-juridike dhe arbitrazhet tregtare. Ndërsa në grupin e tretë bëjnë pjesë arbitrazhet e përkohshme ad-hoc dhe ato institucionale apo të përhershme. Ndërsa arbitrazhet institucionale ndahen në arbitrazhe të përgjithshme dhe në

arbitrazhe të specializuara. Pos këtyre llojeve që u përmendën ekzistojnë edhe lloje të tjera të arbitrazheve për të cilat do të bëhet fjalë më vonë dhe me theks të veçantë për arbitrazhin i cili gjykon sipas parimit të drejtshmërisë.

6.2.1. ARBITRAZHET NACIONALE, NDËRKOMBËTARE DHE ANACIONALE

a) Arbitrazhi nacional apo vendor. Arbitrazh nacional konsiderohet ai i cili aktivitetin renda territorit të shtetit aktual dhe është i lidhur ngushtë për sistemin e tij për këtë shërben e drejta angleze për arbitrazhin ku thuhet se: *“arbitrazhi i brendshëm është ai selia e të cilit gjendet brenda territorit anglez si dhe kur të dyja palët posedonin shtetësinë angleze në momentin e lidhjes së kontratës për arbitrazhin”*. Qëndrim të ngjashëm me të drejtën angleze mbajnë edhe konkordatet itrazhin të vitit 1969.

b) Arbitrazhi i huaj apo ndërkombëtar. Për identifikimin e arbitrazhit se është vendor tar ndihmojnë këto dy kriteret juridike, kriteri subjektiv dhe kriteri objektiv.

Kriteri subjektiv ka të bëjë me pjesëmarrësit në procedurën e arbitrazhit. Nëse ndonjëra prej palëve kontraktuese është me shtetësi të huaj, arbitrazhi i cili shqyrton çështjen është i karakterit ndërkombëtar. Ndërsa kriteri objektiv ka të bëjë me natyrën e kontestit, pra nëse lënda e kontestit është e natyrës ndërkombëtare, atëherë arbitrazhi i cili e shqyrton atë është i karakterit ndërkombëtar. Rreth identifikimit të arbitrazhit se është vendor apo ndërkombëtar bëhet fjalë edhe në burimet ndërkombëtare për arbitrazhin si, ligji-model i UNCITRAL-it si dhe Konventa Evropiane e vitit 1961 ku në nenin 1 pika a thuhet se *“arbitrazhi është ndërkombëtar nëse palët në momentin e lidhjes së kontratës për arbitrazhin kishin shtetësi të ndryshme, më tej thuhet se nëse palët kontraktuese kanë shtetësi të njëjtë, por lënda e kontestit është e lidhur ngushtë me shtetin tjetër ku duhet të b rhen disa obligime të dala nga ajo kontratë, atëherë arbitrazhi i cili shqyrton këtë(lëndë është i karakterit ndërkombëtar ”*.

c) Arbitrazhi anacional apo apatridë. Në vitet e 80-ta të shek. XX disa autorë të së drejtës së arbitrazhit u angazhuan për shkëputjen e arbitrazhit nga sistemi juridik nacional. Arbitrazhin e shkëputur nga sistemi juridik nacional këta autorë do ta konsideronin si arbitrazh anacional apo supernacional. Angazhimi për një arbitrazh të këtillë nuk

gjete përkrahje sepse asnjë shtet nuk do të pranonte që brenda territorit të tij të ngritet padia për anulimin e vendimit të nxjerrë nga një arbitrazh i këtillë për arsye se për nxjerrjen e atij vendimi nuk ishin aplikuar as e drejta materiale e as ajo procedurale e sistemit të tij juridik, prandaj edhe nuk dëshirojnë të marrin një përgjegjësi të këtillë mbi vete.

6.2.2. ARBITRAZHET E TË DREJTËS CIVILE DHE ARBITRAZHET TREGTARE

Tek arbitrazhet e të drejtës private ekziston edhe ndarja në arbitrazhe civiloidike dhe në arbitrazhe tregtare.

a) Arbitrazhe civilo-juridike konsiderohen të gjitha ato arbitrazhe, të cilat i zgjidhin kontestet e kësaj natyre dhe rregullohen me ligjet e procedurës kontestimore si dhe janë arbitrale për t'u zgjidhur me arbitrazh.

b) Arbitrazhet tregtare. Në këtë lloj arbitrazhi bëjnë pjesë të gjitha ato arbitrazhe të cilat zgjidhin kontestet e dala nga marrëdhënia tregtare ndërmjet palëve në kontest. Thënë shkurt, klasifikimi në arbitrazhe civilo-juridike dhe në arbitrazhe tregtare kryesisht bëhet përmes përmbajtjes së lëndës së kontestit. Nëse lënda e shtruar për zgjidhje i përket natyrës civilo-juridike, atëherë edhe arbitrazhi i cili zgjidh atë quhet arbitrazh civil, e nëse përmbajtja e lëndës është e natyrës tregtare, arbitrazhi i cili do ta zgjidhë atë quhet arbitrazh tregtar.

6.2.3. ARBITRAZHET AD-HOC, INSTITUCIONALE DHE TË SPECIALIZUARA

Në kuadër të llojeve të së drejtës së arbitrazhit privat, ekziston edhe ndarja në arbitrazhe të përkohshme, arbitrazhe të përhershme-institucionale dhe të specializuara.

a) Ad-hoc arbitrazh (apo i përkohshëm) quhet arbitrazhi i cili shqyrton vetëm një rast të parashtruar për zgjidhje. Organizimi dhe koncipimi i ad-hoc arbitrazhit (arbitrazhit të përkohshëm) tërësisht u takon palëve në kontest. Ky lloj arbitrazhi pasi të nxjerrë vendimin për rastin, automatikisht pushon së ekzistuari. Meqenëse përgjegjësia rreth organizimit dhe koncipimit të tij u takon vetëm palëve, atëherë shtrohet pyetja se a do të jenë palët të zonja të bartin këtë përgjegjësi. Prandaj palëve u rekomandohet që të përzgjedhin rregullat e UNCITRAL-arbitrazhit, të cilat apostafat janë të përgatitura për ad-hoc arbitrazhet, apo për

këshilla dhe udhëzime t'u drejtohen ekspertëve juridik ose qendrave të specializuara për këtë lëmi.

b) Arbitrazhet e përhershme apo institucionale quhen ato arbitrazhe të cilat posedojnë një aparat administrativ dhe janë të organizuara pranë Odave Ekonomike apo ndonjë asociacioni tjetër të brendshëm apo ndërkombëtar. Arbitrazhet institucionale edhe pse posedojnë një organizim të mirë administrativ si dhe rregulloret e tyre prapëseprapë nuk mund të barazohen me gjykatat sepse edhe tribunalit të këtij arbitrazhi pas nxjerrjes së vendimit përfundimtar i pushon misioni. Në botë veprojnë një numër i konsideruar i arbitrazheve institucionale të tregtisë ndërkombëtare e ndër to më të njohurat janë ICC arbitrazhi me seli në Paris dhe LCIA arbitrazhi me seli në Londër etj. Vlen të theksohet se këto dy arbitrazhe si dhe disa tjera nuk janë të lidhura për asnjë asociacion nacional por veprojnë si të pavarura, ndërsa disa të tjera si ai i Moskës, Stokholmit apo ndonjë tjetër funksionojnë pranë Odave Ekonomike të shteteve të tyre edhe pse janë të karakterit ndërkombëtar. Në kuadër të arbitrazhit institucional veprojnë edhe arbitrazhet e specializuara andaj në vazhdim do të themi disa fjalë për to.

c) Arbitrazhe të specializuara quhen ai lloj i arbitrazheve të cilat organizohen dhe funksionojnë si pranë asociacioneve nacionale, po ashtu edhe të atyre ndërkombëtare. Lëndë shqyrtimi pranë këtyre arbitrazheve janë kontestet e dala nga mosmarrëveshjet ndërmjet shoqërive, të cilat merren me shërbime dhe transport të produkteve të caktuara. Në radhën e arbitrazheve të specializuara bëjnë pjesë arbitrazhi detar në Londër (*London maritime arbitration*) i cili merret me zgjidhjen e kontesteve në transportin detar. Pastaj arbitrazhi GAFTA, po ashtu me seli në Londër dhe zgjidh kontestet ndërmjet prodhuesve dhe tregtarëve të drithërave dhe ushqimeve. Arbitrazh i specializuar është edhe ai i cili zgjidh kontestet ndërmjet kompanive, të cilat merren me tregtinë e kafesë (*Cafe Trade Federation*), gjithashtu me seli në Londër. Duhet theksuar se arbitrazhet e specializuara mund të veprojnë edhe sipas parimit të dyshkallshmërisë dhe se secili prej tyre posedon specifikat e tija. Përpos këtyre llojeve të arbitrazheve që u përmendën ekzistojnë edhe lloje tjera të arbitrazhit të së drejtës ndërkombëtare. Në vazhdim do të përmendim disa prej tyre.

6.2.4. LLOJET TJERA TË ARBITRAZHIT

Sipas teorisë dhe praktikës dihet se ekzistojnë edhe lloje tjera të arbitrazhit, por duhet theksuar se këto lloje të arbitrazheve, të cilat do të

përmenden në vazhdim nuk janë në lidhshmëri të drejtpërdrejtë me kriteret e përhershme dhe profesionale për arbitrazhin. Në lloje tjera radhiten këto arbitrazhe: arbitrazhet formale dhe joformale, arbitrazhet e administrara dhe jo të administruara, arbitrazhet rituale dhe jo rituale, arbitrazhet e hapura dhe të mbyllura etj. Kohëve të fundit vërehet edhe ndarja në arbitrazhe të cilat respektojnë afate dhe në ato të cilat nuk i respektojnë ato si dhe arbitrazhet e përshpejtuara (*Fasr Trock Arbitration*), të cilat veprojnë sipas dëshirës së palëve. Po ashtu ekzistojnë edhe arbitrazhe, të cilat zgjidhin konteste ku në njërën apo të dyja palët shfaqen më shumë subjekte fizike apo juridike (*multiparti*) të dala nga kontratat zingjimore të njohura me emrin konsorciume. Arbitrazhet gjithashtu ndahen në arbitrazhe, të cilat njohin dhe ato të cilat nuk njohin apo nuk përdorin rregullat e UNCITRAL-arbitrazhit. Arbitrazhet gjithashtu ndahen në arbitrazhe të kontrolluara dhe më pak të kontrolluara nga organet kompetente shtetërore. Po ashtu arbitrazhet ndahen në arbitrazhe, të cilat funksionojnë sipas të drejtës së Common Law-it dhe atyre që funksionojnë sipas të

drejtës kontinentale. Në Angli ekzistojnë arbitrazhe obligative (*compulsory arbitration*) të cilat nuk respektojnë vullnetin e palëve dhe u gjasojnë gjykatave shtetërore. Në lloje tjera të arbitrazhit bën pjesë edhe arbitrazhi, i cili merret me zgjidhjen e kontesteve sportive me seli në Llozanë të Zvicrës dhe përfaqësitë e tij në Denver dhe Sidnej. Në fund ekziston edhe një lloj i arbitrazhit, i cili është mjaft interesant për t'u trajtuar dhe quhet arbitrazhi i cili gjykon sipas parimit të drejtshmërisë.

6.2.5. ARBITRAZHI I CILI GJYKON SIPAS PARIMIT TË DREJTSHMËRISË

Prania e arbitrazhit i cili gjykon sipas parimit të drejtshmërisë është mjaft e rrallë në praktikë, por në aspektin juridik është mjaft interesant për t'u njohur me mënyrën e funksionimit të tij. Arbitrat e këtij lloj arbitrazhi vendimet përfundimtare për çështjen në shqyrtim i nxjerrin pa u mbështetur as në ligjin nacional as në rregullat ndërkombëtare e as në normat autonome të arbitrazhit, por ato i nxjerrin duke u mbështetur në drejtshmëri. Forma e këtillë e nxjerrjes së vendimit pa u mbështetur në norma juridike konsiderohet si përjashtim, por është e mundur nëse palët decidivisht kanë kërkuar që vendimi për kontestin në fjalë të nxirret në bazë të *eh aequo et bona apo amiable compositeurs*. Zgjidhjen e kontestit sipas parimit të drejtshmërisë e arsyetojnë kërkesat e tregtisë bashkëkohore ndërkombëtare.

Ithtarët e arbitrazhit i cili vendos sipas parimit të drejtshmërisë, përkrahjen e tyre e mbështesin në thënien e Justinianit se “*në të gjitha çështjet më mirë është të kihet kujdes për të drejtën dhe drejtshmërinë sesa për parimin e rreptë juridik (pllacuit in omnibus reb praecipuam esse iustitiae acuitatsque cuam stricti iuris rationem)*”.

Në anën tjetër kundërshtarët e arbitrazhit, i cili gjykon sipas parimit të drejtshmërisë mendojnë se ky lloj gjykimi i pambështetur në burime juridike krijon hapësirë për keqpërdorimin e autorizimit të palëve dhënë arbitrave dhe mohon esencën e ekzistimit të institutit të arbitrazhit si dhe rrënon autoritetin dhe perspektivën e tij.

Pa marrë parasysh përkrahjen dhe kritikën që i adresohen, ky lloj arbitrazhi zë vend të merituar si në ligjet nacionale, po ashtu edhe në konventat ndërkombëtare për arbitrazhin. Ndër ligjet nacionale të cilat e njohin këtë lloj arbitrazhi janë: ligji gjerman, zviceran dhe i SHBA-ve për arbitrazhin. Ndërsa prej rregullave ndërkombëtare këtë lloj arbitrazhi e njohin ligji model i UNCIRAL-it i vitit 1985, ku në nenin 28 të tij thuhet “*arbitrat do të vendosin sipas drejtshmërisë, në bazë të zakoneve dhe uzansave tregtare, nëse palët decidivisht kështu e kanë autorizuar atë*”. Për arbitrazhin i cili vendos sipas parimit të drejtshmërisë bën fjalë edhe Konventa Evropiane për arbitrazhin e vitit 1961 (neni 7 pika 2). Vlen të theksohet edhe kjo se edhe arbitrazhi, i cili gjykon sipas parimit të drejtshmërisë, kontraktohet njësoj si edhe arbitrazhet tjera. Ky lloj arbitrazhi më shumë praktikohet në shtetet e të drejtës kontinentale sesa në ato të së drejtës së Comon Law-it. Arbitrazhi i cili vendos sipas parimit të drejtshmërisë edhe pse vendimin përfundimtar nuk e mbështet në norma juridike, qoftë në ato nacionale apo ndërkombëtare, ai prapëseprapë nuk mund të vendosë sipas vetë dëshirës, por patjetër duhet të mbështetet në Lex Mercatoria, burim i cili përmbledh zakonet dhe uzansat e tregtisë ndërkombëtare.

Ligji model dhe rregullat e UNCITRAL-arbitrazhit, rekomandojnë që arbitrazhi i cili vendos sipas parimit të drejtshmërisë pos respektimit të Lex Mercatorias ai patjetër duhet të veprojë edhe në përputhshmëri me kontratën e palëve për arbitrazhin.

KAPITULLI I TRETË

III. ARBITRAZH I TREGTISË NDËRKOMBËTARE

1. NOCIONI DHE KONSTRUKTI JURIDIK I ARBITRAZHIT TË TREGTISË NDËRKOMBËTARE

1.1. NOCIONI I PËRGJITHSHËM

Njëra ndër karakteristikat e shekullit të njëzetë në zhvillimin e drejtësisë dhe biznesit pa dyshim është edhe afirmimi i arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare si mekanizëm alternativ për zgjidhjen e kontesteve. Në fondin e marrëdhënieve ndërkombëtare ekziston një numër i konsiderueshëm kontratash rreth qarkullimit ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve si: kontratat për shitblerje, shpëdicion, investime të huaja, veprimtari bankare, sigurime, konsorciume, pronësi intelektuale etj. I ithë ky lloj kontratash me karakter ndërkombëtar është e pabesueshme se mund të realizohen pa klauzolën për arbitrazhin.

Nxitja dhe zhvillimi i arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare në cilësinë e gjyqësisë private si dhe me autonominë e tij në raport me gjykatën e rregullt, shënon fillimin e një oke të re në afirmimin e këtij instituti të komuniteti i biznesit, si atij të brendshëm po ashtu edhe atij ndërkombëtar. Ngritjen e popullaritetit të arbitrazhit ndërkombëtar më së iri e dëshmon raporti vjetor mbi punën e ICC arbitrazhit në Paris për vitin 1993, ku thuhet se janë shqyrtuar rreth 352 kërkesëpadi, të cilat vinin nga 52 shtete të ndryshme të 60tës. Në anën tjetër, ngritja e arbitrazheve regjionale si dhe nxjerrja e disa ligjeve nacionale përkrah konventave ndërkombëtare për arbitrazhin, gjithashtu janë dëshmi e qartë për prestigjin e arbitrazhit që po e fiton në botën e biznesit.

Rritja e popullaritetit të arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare kohëve të fundit u ndikua nga rritja e vullshme e vëllimit të marrëdhënieve në ekonominë ndërkombëtare, ku një pjesë e obligimeve të dala nga këto marrëdhënie nuk realizoheshin fare apo realizoheshin pjesërisht, andaj edhe ishte e logjikshme që mosrealizimi i obligimeve të këtilla duhej zgjidhur disi. Pra, internacionalizimi i ekonomive nacionale,

ndërvlerësia e tregjeve nacionale dhe ndërkombëtare si dhe shumëllojshmëria e marrëdhënieve kontraktuale ndërkombëtare kërkonin një mekanizëm të forcuar juridik për t'i zgjidhur kontestet e dala nga ato marrëdhënie.

1.2. KONSTRUKTI JURIDIK I ARBITRAZHIT TREGTAR

Për ta kuptuar sa më lehtë strukturën e arbitrazhit, autonominë e tij në raport me gjykatën dhe organet tjera shtetërore si dhe lidhshmërinë e tij për ligjet nacionale dhe konventat ndërkombëtare është e nevojshme të shtrohet pyetja se, ç'është arbitrazhi. Pra, arbitrazhi është gjyqësi specifike të cilën e koncipojnë vetë palët duke u përcaktuar për formën më të shpejtë dhe më të thjeshtë të zgjidhjes së kontestetit të tyre në rrugë private. Megjithatë, arbitrazhi si gjyqësi private dhe e zgjedhur nga palët patjetër duhet të veprojë në kuadër të ligjeve ekzistuese për arbitrazhin të shtetit në të cilin funksionon ai, por mundet të veprojë edhe në kuadër të ligjeve tjera (*kompetente*) apo edhe në përputhje me dispozitat e konventave ndërkombëtare për arbitrazhin, meqë vendimi i nxjerrë ka nevojë të njihet dhe ekzekutohet edhe në shtetin tjetër.

Tribunali i arbitrazhit mund të konstituohet vetëm në bazë të marrëveshjes së palëve. Palët me kontratën e tyre për arbitrazhin përcaktojnë edhe të drejtën kompetente (*materiale dhe procedurale*), e cila aplikohet për zgjidhjen e kontestetit në fjalë. Gjithashtu palët mund të përcaktohen edhe për gjuhën, e cila do të përdoret gjatë zhvillimit të procedurës pranë arbitrazhit. Si ligjet nacionale, po ashtu edhe rregullat e procedurës së arbitrazhit bëjnë fjalë edhe rreth kompetencës së arbitrazhit për zgjidhjen e kontestetit konkret. Ndërsa kompetenca e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare formulohet vetëm atëherë kur palët në kontest kanë shtetësi të ndryshme.

Vendimi i arbitrazhit mund të ekzekutohet edhe në shtetin tjetër nëse i plotëson kushtet për njohje dhe ekzekutim në atë shtet. Karakteristikat e lartpërmendura tregojnë qartë se mbi to ndërtohet dhe qëndron konstrukti juridik i arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare.

2. ELEMENTET TË CILAT ARBITRAZHIT TREGTAR I JAPIN KARAKTER NDËRKOMBËTAR

Nga vet titulli arbitrazh i tregtisë ndërkombëtare kuptohet se lënda, të cilën duhet ta shqyrtojë ky arbitrazh duhet të jetë e natyrës

tregtare dhe duhet të përmbajë elemente të huaja. Teoria dhe praktika e të drejtës së arbitrazhit kërkojnë praninë e tri elementeve, të cilat arbitrazhit i japin karakter ndërkombëtar e ato janë: a) që kontesti të jetë me karakter ndërkombëtar, b) kontesti të jetë i karakterit tregtar dhe c) të ekzistojë kontrata për arbitrazhin.

a) Kontesti ndërkombëtar. Elementet të cilat kontestit i japin karakter ndërkombëtar janë; shtetësia ndryshme e palëve, vendi i lidhjes dhe realizimit të kontratës, vendi i selisë së arbitrazhit etj. Të tria këto elemente janë të një rëndësie të caktuar për kualifikimin e kontestit se është me karakter ndërkombëtar apo jo. Arbitrazhit për t'i dhënë karakter ndërkombëtar nuk ekziston ndonjë rregull administrativ por kjo varet nga prania e elementit të huaj, i cili është i pranishëm në kontratën për arbitrazhin.

Rreth kualifikimit të termit “ndërkombëtarë” shtetet mbajnë qëndrime të ndryshme. E drejta franceze konsideron se arbitrazhi për të qenë me karakter ndërkombëtar, kontesti i shtruar pranë tij për zgjidhje duhet të rrjedhë nga marrëdhënia e tregtisë së jashtme pa marrë parasysh shtetësinë e palëve. Ndërsa e drejta angleze kërkon që njëra prej palëve pa tjetër duhet të jetë me shtetësi tjetër. Ky qëndrim i të drejtës angleze u shërbeu si model shumë shteteve tjera rreth kësaj çështjeje.

Pos ligjeve nacionale rreth termit “ndërkombëtar” bëjnë fjalë edhe disa konventa ndërkombëtare për arbitrazhin si Konventa Evropiane e vitit 1961 dhe Ligji Model i UNCITRAL-it i vitit 1985. Në ligjin model të UNCITRAL-it thuhet se kontesti është ndërkombëtar nëse palët kontraktuese kishin vendbanime apo shtetësi të ndryshme.

b) Kontesti tregtar. Rreth termit “kontest tregtar” autorët disi nuk janë unik. Disa prej tyre mendojnë se kjo shprehje i takon së kaluarës dhe se dinamika e zhvillimeve takon një interpretim më gjithëpërfshirës ku do të përfshiheshin të gjitha ato konteste, të cilat burojnë nga veprimtaria ekonomike me element të huaja, e jo vetëm nga veprimtaria siç mendon grupi tjetër i dijetarëve. Termin “tregtar” në aspektin gjithëpërfshirës e njej edhe Ligji model i UNCITRAL-it i vitit 1985 i cili u rekomandon shteteve shfrytëzuese të këtij ligji se me interpretimin e gjerë apo gjithëpërfshirës të këtij termi përfshihet e tërë materia, e cila buron nga të gjitha marrëdhëniet e natyrës tregtare apo biznesore.

c) Kushti i tretë pa të cilin nuk mund të ketë themelim dhe aktivizim të arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare është edhe kontrata për arbitrazhin për të cilën do të bëhet fjalë te kapitulli i tretë i këtij punimi.

3. VËSHTRIM I SHKURTËR MBI ZHVILLIMIN E ARBITRAZHIT TREGTAR NDËRKOMBËTAR

Arbitrazhi fillimisht ishte i themeluar dhe organizuar për zgjidhjen e kontesteve brenda shtetit, pra ishte me karakter nacional. Si shenja të para për veprimtarinë e arbitrazhit në nivel ndërkombëtar mund të merren zgjidhjet e kontesteve të ndryshme, të shfaqeshin ndërmjet poliseve greke (shtetet-qytete) në Greqinë e Vjetër. Mbështetur disa të dhëna të njohësve të historisë së arbitrazhit del se edhe arbitrazhi i tregtisë kombëtare zë fillin që në kohën e historisë së vjetër. Ata thonë se arbitri i sotëm i isë ndërkombëtare e ka prejardhjen nga *funksjoneri* shtetëror romak (*praetor egrinos*) detyra e të cilit ishte që me procedurë të shpejtë të zgjidhë kontestet në të t'ishin palë edhe qytetarët e huaj joromak apo tregtarët udhëtarë⁴⁰.

Gjurmët e arbitrazhit ndërkombëtar janë të pranishme edhe në kohën e historisë së mesme. Lulëzimi i tregtisë pos efektit dobiprurës përcillej edhe me problemet, të cilat ej zgjidhur. Meqenëse gjyqet e kohës me vështirësi i përballonin zgjidhjet e këtyre problemeve, atëherë u ndie nevoja për fuqizimin e arbitrazhit si mekanizëm alternativ për zgjidhjen e atyre kontesteve. Perioda e kohës së mesme shquhet me krijimin e zakoneve uzansave tregtare, të cilat më vonë u bënë burime juridike të arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare. Shikuar nga aspekti zhvillimor arbitrazhi që nga perioda e kohës së sme e këndeje kaloi një rrugë të gjatë e plot sfida. Arbitrazhi i tregtisë ndërkombëtare ej drejtpërdrejt nga zhvillimi i tregtisë ndërkombëtare dhe marrëdhëniet e zhvillimit ekonomik me botën. Ky arbitrazh hovin më të madh të zhvillimit të tij e arriti pas Luftës Dytë Botërore, ku edhe u themeluan arbitrazhet institucionale dhe të specializuara ndërkombëtare, gjegjësisht shtëpitë e arbitrazheve. Në disa shtete u themeluan arbitrazhet e përhershme sipas organizimit, por ndërkombëtare sipas natyrë së funksionimit. Për arbitrazhin interesim treguan edhe ish-shtetet socialiste.

4. E DREJTA E ARBITRAZHIT TË TREGTISË NDËRKOMBËTARE DHE KARAKTERISTIKAT E SAJ

Shprehja “*e drejta e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare*” është shprehje relativisht e re dhe pak e përdorur në raport me shprehjen të drejtat e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare e cila ishte e ambientuar në

40 Novelat e Justinianit 82,11,1 (viti 539) dhe Kodex Justiniani, 2,55,5 (viti 530). Rreth prejardhjes së arbitrazhit Homannat Arbitration in Anejet Grece, Arbitration International fq. 188. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 20.

praktikën e arbitrazhit. Dallimi ndërmjet këtyre dy shprehjeve nuk është edhe aq i rëndësishëm, por shprehjen e dytë e përdorin numër më i madh i autorëve të kësaj lëmie në veprat e tyre.

Shprehja e drejta e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare (*le droit commercial internationa d'arbitrage apo international commercial atbiration laë*) në kuptimin e gjerë të fjalës nënkupton, përmbledhje rregullash me të cilat rregullohet themelimi i tribunalit, zhvillimi i procedurës si dhe nxjerrja, njohja dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit. Përkufizimi kaq i gjerë për arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare na jep të besojmë se ky arbitrazh për dallim nga arbitrazhi nacional shfrytëzon burime të shumëfishta juridike si, ligjet nacionale, konventat ndërkombëtare si dhe një burim të ri dhe specifik "*lex mercatoria*" i cili përbëhet prej zakoneve, uzansave, standardeve si dhe sjelljeve të komunitetit punues në të drejtën e qarkullimit të tregtisë ndërkombëtare. Kjo ishte karakteristika e parë e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare.

Karakteristika e dytë e të drejtës së arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare ka të bëjë kontestet e natyrës tregtare, të cilat do të zgjidhen pranë këtij arbitrazhi.

Ndërsa karakteristika e tretë e të drejtës së arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare ka të bëjë me atë se ky arbitrazh funksionon në bazë të dispozitave materiale dhe procedurale. Dispozitat materiale tribunalit i shërbejnë për t'u mbështetur në to për zgjidhjen e thelbit të kontestit, ndërsa dispozitat procedurale i shërbejnë për të zhvilluar procedurën për shqyrtimin e çështjes si dhe nxjerrjen e vendimit përfundimtar. Përzgjedhja e këtyre dy lloj dispozitave (*kompetente*) bëhet nga vetë palët apo arbitrat e tvre ose janë të përcaktuara me ligjin e shtetit për arbitrazhin apo me rregulloret e arbitrazheve.

Si karakteristike e katërt e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare është se kjo e drejtë konsiderohet si e drejtë e re apo e drejtë e cila është në formësim e sipër dhe se ende nuk posedon kornizat e saj juridike të forcuara. E drejta e arbitrazhit ndërkombëtar sit dihet shfrytëzon si burimet nacionale po ashtu edhe ato ndërkombëtare andaj edhe angazhohet për unifikimin e këtyre burimeve. Në kuadër të së drejtës së arbitrazhit vazhdimisht zhvillohet një luftë ndërmjet burimeve nacionale dhe atyre ndërkombëtare sepse burimet e brendshme anojnë kah e drejta nacionale, ndërsa burimet ndërkombëtare anojnë kah e drejta universale. Unifikimi i këtyre dy lloj burimeve do të ndikonte në formësimin e kësaj të drejte si dhe në lehtësimin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare.

5. NATYRA JURIDIKE DHE PËRKUFIZIMET PËR ARBITRAZHIN E TREGTISË NDËRKOMBËTARE

5.1. NATYRA JURIDIKE E ARBITRAZHIT TREGTAR NDËRKOMBËTAR

Siç kemi cekur më parë përcaktimi i natyrës juridike të arbitrazhit do të ndihmonte që të kemi një pasqyrë sa më complete të këtij institucioni. Disa autorë mendojnë se në inat e kohës përcaktimi i natyrës juridike të arbitrazhit nuk ka fare rëndësi. E në anën tjetër ekzistojnë autorë, të cilët përcaktimin e natyrës juridike të arbitrazhit e shohin si nevojë të përbashkët të teorisë dhe praktikës dhe tek natyra juridike e arbitrazhit hasin përgjigjen më të mirë në çështjen e definimit, specifikave si dhe përmbajtjes së nocionit të arbitrazhit. Përcaktimi i natyrës juridike të arbitrazhit ndihmon në njohjen e prejardhjes në përcaktimin e pozitës së arbitrazhit në sistemin juridik nacional apo në të drejtën ndërkombëtare si dhe tregon në dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet institutit të arbitrazhit në raport me institucionet tjera të kësaj natyre. Në vazhdim, do të përmendim disa përkufizime të autorëve të ndryshëm rreth arbitrazhit.

5.2. PËRKUFIZIMET PËR ARBITRAZHIN

Ph. Fouchard për arbitrazhin thotë se “palët me marrëveshje kontestin e tyre ua besojnë për zgjidhje personave të cilët i zgjedhin ata vetë”⁴¹. Ndërsa **Rene David** për arbitrazhin thotë “*arbitrazhi është një teknikë për zgjidhjen e një problemi, i cili shfaqet mes dy apo më shumë personave me ndihmën e personit apo personave të tretë, të cilët autonominë e tyre e nxjerrin nga marrëveshja private pa ndërhyrjen e shtetit*”⁴². Përkufizim për arbitrazhin jep edhe **Ch. Jarresson** ku thotë “*arbitrazhi është Institucion përmes të cilit personat tjerë zgjidhin kontestin ndërmjet dy e më shumë palëve duke realizuar një mision gjyqësor të cilin palët ua kanë besuar*”⁴³. Rreth natyrës definicione për arbitrazhin japin edhe **A. Goldshtajn** dhe **S. Trivo** ku thonë se

41 Ph. Fouchard, L'arbitrage commercial international, Dalos, 1965, nr.11. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 13.

42 R. David. L'arbitrage dans le commerce international, Ekonomika 1982, fq 9. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 33.

43 Ch. Jarresson. L'a notion d'arbitrage LEDI 1997, nr 285, Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 33.

“arbitrazhi është organ gjykimor, autonom dhe joshtetëror i themeluar me marrëveshjen e palëve, të cilat ia besojnë atij nxjerrjen e një vendimi meritor për kontestin e tyre”⁴⁴. Për arbitrazhin, por duke u mbështetur në teorinë juridikionale **Mihailo Jezdiqi** thotë “arbitrazhet janë ente të themeluara nga individët apo shoqatat profesionale private me karakter gjysmëpublik për të zgjidhur kontestet të cilat rrjedhin nga qarkullimi i tregtisë së jashtme apo ndërkombëtare ku edhe është kontraktuar kompetenca e tyre”⁴⁵. Siç duket, rreth natyrës juridike të arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare më i përafërti

përkufizimi i M. Jezdiqit. Përkufizimet e lartpërmendura si duket ndikuan që autorët e të drejtës së arbitrazhit të ndahen në dy grupe. Në grupin e parë rreshtohen të gjithë ata autorë, të cilët mendojnë se arbitrazhi i tregtisë ndërkombëtare i përket natyrës gjykimore, ndërsa në grupin e dytë bëjnë pjesë autorët të cilët mendojnë se arbitrazhi është institucion kontraktual.

5.3. PËRCAKTIMI I PALËVE PËR ARBITRAZHIN TREGTAR NDËRKOMBËTAR

Ekzistojnë disa arsye që palët i motivojnë për t’u përcaktuar që kontestet e tyre t’i zgjidhin me arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare, arsyet janë se:

- kontrata e tyre përmban elemente të huaja.
- palët dëshirojnë që kontesti i tyre të zgjidhet në mënyrë sa më objektive.
- palët kanë dëshirë që kontestin e tyre ta zgjidhin në mënyrë miqësore dhe pa i tronditur marrëdhëniet e mëtejme afariste ndërmjet tyre.
- kontestet e rastit zgjidhen sipas praktikës “fer” dhe marrëdhënieve vepruese “bona fides” dhe
- palët shprehin një dozë mosbesimi ndaj gjykatave nacionale etj.

Të gjitha këto shkaqe ndikojnë që arbitrazhi të fitojë rolin dominues në zgjidhjen e kontesteve të dala nga marrëdhënia e tregtisë ndërkombëtare.

44 Prof. Dr. Siniša Trivo, Dr. Poznić Borivoje, Dr. Vargić N., Dr. Varadi Tibor, Arbitražno Rešavanje Sporova, Novi Sad, 1973 fq. 5.

45 Shif. Dr. Jezdić Mihailo. E drejta Ndërkombëtare Private. Libri IIë, fq 137, Beograd, 1965, përkthyer në shqip nga Hamdi Vraniqi, Prishtinë, 1976.

KAPITULLI I KATËRT

IV. KONTRATA PËR ARBITRAZHIN

1. KONTRATA-ELEMENT QENËSOR PËR ARBITRAZHIN

Për ta kuptuar më drejt dhe më mirë kontratën si element qenësor për arbitrazhin e nevojshme që të bëhet fjalë për nocionin, llojet, përmbajtjen, formën si dhe kushtet për lidhjen e kontratës për arbitrazhin.

1.1. NOCIONI I KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Nëse palës i shkelet ndonjë e drejtë subjektive për ta mbrojtur atë ajo i drejtohet gjykatës por pa ndonjë përgatitje paraprake për një opsion të tillë. E kur bëhet fjalë për arbitrazhin si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve situata qëndron më ndryshe. Zgjidhja kontesteve me arbitrazh mund të ndodhë vetëm atëherë kur palët paraprakisht e kanë kontraktuar atë. Kontrata për arbitrazhin është aso lloj kontrate përmes së cilës palët n lirshëm vullnetin e tyre se kontestet e dala nga ajo marrëdhënie pronësoro-juridike do t'ia besojnë për zgjidhje arbitrazhit.

Esenca e kontratës për arbitrazhin qëndron në faktin se këtu bëhet fjalë për një marrëdhënie privato-juridike ndërmjet palëve përmes së cilës ato bartin zgjidhjen e kontestit në kompetencën e arbitrazhit, pra duke mënjeluar kompetencën e gjykatës së rregullt për zgjidhjen e atij kontesti.⁴⁶ Nga ky përkufizim kuptohet se kontrata për arbitrazhin është baza kryesore mbi të cilën mbështetet themelimi i kompetencës së lit me të gjitha efektet juridike të cilat burojnë nga ajo.

46 Rreth definicioneve të ndryshme të kontratës për arbitrazhin shif. V. Ruade-Hadenfeld. 37, Jaksić Aleksandar, Međunarodna trgovinska arbitraža, Beograd, 2003, fq. 194.

1.2. LLOJET E KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Kontrata për arbitrazhin zakonisht shfaqet në dy forma standarde e ato janë: *klauzola kompromisore dhe kompromisi*.

a) Klauzola kompromisore - (në gjuhën frënge) clause compromisorie është forma më pranishme e kontratës për arbitrazhin e lidhur ndërmjet palëve. Palët me rastin e lidhjes kontratës kryesore qoftë për shitblerje apo ofrim shërbimesh në kuadër të saj mund të instalojnë edhe dispozitën më të cilën parashohin se çfarëdo kontesti, i cili do të burojë ajo marrëdhënie juridike do t'i besohet për zgjidhje arbitrazhit të caktuar. Klauzola arbitrazhin si dispozitë në vete zakonisht vendoset në fund të kontratës kryesore.

Klauzola për arbitrazhin do të ketë këso përmbajtje se palët janë të pajtimit që kontesti, i cili mund të rrjedhë nga kjo kontratë do të zgjidhet nga arbitrazhi institucional, i cili funksionon pranë Odës Ekonomike të Kosovës duke aplikuar rregulloren e tij. Pra me klauzolën kompromisore zgjidhen të gjitha ato konteste, të cilat mund të shfaqen më vonë nga marrëdhënia juridike ekzistuese.

b) Kompromisi - (në gjuhën frënge) *act de compromissi apo compromiss darbitrage* është forma e dytë e kontratës për arbitrazhin. Kjo formë e kontratës për arbitrazhin lidhet vetëm atëherë kur kontrata kryesore është futur në krizë për t'u realizuar dhe se kontestet të cilat burojnë nga ajo kontratë tanimë veç janë shfaqur. Palët, për të arritur tek marrëveshja apo kompromisi e kanë paksa më të vështirë sepse tani përmasat e kontesteve të shfaqura veç janë të dukshme.

Vlen të theksohet se, si klauzola kompromisore po ashtu edhe kompromisi, si në burimet juridike nacionale po ashtu edhe në ato ndërkombëtare gëzojnë status të njëjtë.

Më herët disa ligje nacionale për arbitrazhin klauzolën kompromisore nuk e njihnin fare, pro një diskriminim i tillë ndërmjet këtyre dy formave të kontratës tanimë është tejkualuar. Në tejkalimin e këtij diskriminimi kontribuan: Protokollin e Gjenezës i vitit 1923, Konventa e Nju Jorkut e vitit 1958, Konventa Evropiane e vitit 1961 dhe Ligji model i vitit 1985 i cili i barazon ato. Nga e tëra kjo që u tha mund të konkludohet se kontrata për arbitrazhin është akti më i rëndësishëm sepse me të konstituohet kompetenca si dhe iniciohet procedura pranë tij.

1.3. PËRMBAJTJA E KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Nëse palët dëshirojnë që kontrata e tyre për arbitrazhin të prodhojë efektet e

juridike, atëherë ajo duhet të përmbajë në vete disa elemente të rëndësishme ashtu përmban çdo kontratë tjetër. Për elementet të cilat duhet t'i përmbajë kontrata për in palët duhet të merren vesh mes vete, meqë këto elemente nuk janë paraprakisht të parashikuara. Megjithatë, disa ligje nacionale, konventa ndërkombëtare si rregullore të arbitrazheve institucionale në mënyrë direkte apo indirekte bëjnë fjalë elementeve, që duhet t'i përmbajë një kontratë për arbitrazhin.

Kontrata për arbitrazhin në vete duhet të përmbajë dy lloje elementesh: elementet fakultative dhe elementet qenësore ose obligative pa të cilat nuk mund të ketë kontratë të plotfuqishme për arbitrazhin.

1.3.1. Elementet fakultative apo anësore

Elementet fakultative apo anësore janë ato elemente, mungesa e të cilave nuk në plotfugishmërinë e kontratës për arbitrazhin, por prania e tyre kontratën e bën të qartë dhe më të plotë. Si elemente fakultative konsiderohen: përzgjedhja e të drejtës kompetente materiale dhe procedurale e cila do të aplikohet në zgjidhjen e atij kontesti, afati i kohëzgjatjes së kontratës për arbitrazhin, e drejta e palëve për t'u tërhequr nga procedura e arbitrazhit etj.

1.3.2. Elementet qenësore

Elementet qenësore janë ato elemente mungesa e të cilave kontratën për arbitrazhin e bëjnë jofunksionale. Në mesin e elementeve qenësore që duhet t'i përmbajë ta për arbitrazhin janë dy më të rëndësishme: përcaktimi i arbitrazhit dhe identifikimi i kontestit.

a) Përcaktimi i arbitrazhit është elementi i parë qenësor me të cilin bëhet konstituimi kompetencës së arbitrazhit pranë të cilit palët dëshirojnë të zgjidhin kontestin e tyre. Përcaktimi për arbitrazhin duhet të jetë i saktë dhe i qartë. Rreth përcaktimit të arbitrazhit shpeshherë mund të ndodhin edhe lajthitje të natyrës “patologjike” si dhe të natyrës blanko.

Klauzola patologjike përcaktimi jo i saktë i palëve për arbitrazhin e caktuar gjë që shpeshherë ndodh në praktikë quhet *clause*

patologiques.⁴⁷ Defekti patologjik ndodh kur palët në vend se të cekin saktë emrin e arbitrazhit p.sh. arbitrazhi pranë Odës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris-ICC arbitrazhi,⁴⁸ ceket vetëm arbitrazhi në Paris ose caktohet arbitrazhi, i cili tanimë nuk ekziston apo arbitrat, të cilët nuk pranojnë kryerjen e një misioni të tillë ose janë në mesin e të vdekurve etj. Pra përcaktimet patologjike krijojnë vështirësi në realizimin e qëllimit si dhe lenë hapësirë për interpretime të ndryshme dhe mundësojnë zvarritjen e procedurës.

Praktika e arbitrazhit njeh edhe klauzolën “*blanko*” për arbitrazhin. Te klauzola nuk kemi një përcaktim të saktë por në marrëveshje thuhet se “*kontesti do të zgjidhet përmes arbitrazhit*”, pa përcaktuar saktësisht se me cilin arbitrazh do të zgjidhet Klauzola “*blanko*” mund të interpretohet pos tjerash edhe se “*ndoshta palët kanë aluduar në arbitrazhin tek i cili i kanë zgjidhur kontestet e mëparshme*”. Edhe përkundër ekzistimit të klauzolave të këtilla në praktikën e arbitrazhit, arbitrazhi nuk do t nga kompetenca e tij por insiston që të konstatojë saktësisht vullnetin e palëve apo jo kompetent për të zgjidhur kontestin e parashtruar. E drejta e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare kohëve të fundit i njeh dhe i pranon të gjitha klauzolat blanko me interpretimin se ato janë të kontraktuara për ad-hoc arbitrazhin.

b) Identifikimi i kontestit elementi tjetër që duhet ta përmbajë kontrata për arbitrazhin është edhe identifikimi i kontestit të cilin arbitrazhi duhet ta zgjidhë. Me rastin e identifikimit të kontestit palët duhet të jenë shumë të sakta përmes një përshkrimi të shkurtër qoftë në mospërmbushjen e kontratës kryesore apo kompensimin e dëmit për të cilin arbitrazhi duhet të nxjerrë vendim. Normalisht palët te klauzola kompromisore e kanë të vështirë për identifikimin e kontestit, i cili ende nuk është shfaqur, ndërsa te kompromisi përshkrimi duhet të jetë i saktë sepse kontesti tanimë veç është i shfaqur dhe për palët⁴⁹. Mosidentifikimi i kontestit mund të jetë shkaktarë i anulimit të kontratës për arbitrazhin.

47 F. Eisman-Los Clauses compromise pathologique, Revue de l'arbitrage, 988, p.119 dhe Ph. Foucard apo at p. 203, Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 240.

48 ICC ose International Comercial Court.

49 Neni 1448 i Ligjit të ri francezë të procedurës civile thotë; Kompromisi nën kërcënimin e anulimit duhet të identifikojë apo përcaktojë lëndën e kontestit. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 243.

1.4. FORMULIMI DHE INTERPRETIMI I KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Formulimi dhe interpretimi i kontratës për arbitrazhin janë akte mjaft të rëndësishme në praktikën e arbitrazhit.

a) Formulimi i kontratës për arbitrazhin si akt mjaft i rëndësishëm duhet të jetë i saktë dhe kërkon kujdes të posaçëm rreth parashtrimin të elementeve qenësore, të cilat duhet t'i posedojë kontrata për arbitrazhin nëse dëshirohet shmangia nga komplikimet e panevojshme lidhur me interpretimin e vullnetit real të palëve. Kontrata e formuluar drejt ndikon në azhuritetin e punës së tribunalit. Për një formulim të drejtë dhe të saktë të kontratës për arbitrazhin palëve u rekomandohet konsultimi me ekspertët e kësaj lëmie apo shfrytëzimi i klauzolave standarde. Me aplikimin e klauzolave standarde palët në vend se të sajojnë vetë elementet, të cilat duhet t'i përmbajë kontrata për arbitrazhin ato vetëm bëjnë marrëveshje se kontesti i tyre p.sh. do të zgjidhet sipas rregullores së ICC arbitrazhit në Paris apo rregullave të UNCITRAL-arbitrazhit⁵⁰ dhe këtu përfundon angazhimi i tyre rreth formulimit të kontratës për arbitrazhin, ndërsa çështjet tjera si konstituimin e tribunalit, përzgjedhja e të drejtës materiale dhe procedurale si dhe elementet tjera rregullohen ashtu siç parashihen me rregullore e përzgjedhur.

b) Interpretimi i kontratës. Interpretimi i kontratës për arbitrazhin si akt u përket gjykatësve apo arbitrave. Objekt për interpretim mund të jenë: identifikimi i arbitrazhit të kontraktuar, mënyra e përzgjedhjes së arbitrave, përzgjedhja e të drejtës procedurale kompetente, gjuha që duhet përdorur etj. Interpretimi i kontratës duhet të bëhet me një hulumtim serioz për të vërtetuar se çfarë kanë dëshiruar palët të arrijnë me marrëveshjen tyre për arbitrazhin.

2. RELACIONI I KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN NË RAPORT ME KONTRATËN KRYESORE

Ndër çështjet që shkakton mjaft polarizime në të drejtën e arbitrazhit është edhe autonomia apo statusi i kontratës për arbitrazhin në raport me kontratën kryesore, e cila është shpallur si e pavlefshme apo e anuluar. Këtu fjala është për klauzolën kryesore si pjesë e kontratës

50 UNCITRAL-United Nations Commission on International Trade Law.

kryesore e jo për kompromisin, i cili lidhet më vonë si në vete, pra ndaras nga kontrata kryesore.

Çështja e parimit të autonomisë së kontratës për arbitrazhin në raport me kontratën shtrohet në dy aspekte, në aspektin teorik dhe në aspektin praktik.

a) në aspektin teorik është mjaft diskutabile se si është e mundur që një pjesë e kontratës, fjala vjen klauzola kompromisore të shkëputet nga tërësia e kontratës kryesore dhe të bëhet e pavarur prej saj në mënyrë që të vazhdojë rrugëtimin e vet të pavarur dhe të prodhojë efekte juridike.

b) ndërsa në aspektin praktik çështja shtrohet se a është i mundur konstituimi i arbitrazhit në bazë të klauzolës për arbitrazhin si pjesë e kontratës kryesore, e cila shpallet e pavlefshme, apo konstituimi i tribunalit të arbitrazhit, në rrethana të këtilla, do të rrënohet bashkë me kontratën kryesore.

2.1. AUTONOMIA E KLAUZOLËS SË ARBITRAZHIT

Kohëve të fundit në të drejtën e arbitrazhit dominon qëndrimi se klauzola për arbitrazhin duhet të gëzojë autonominë e saj në raport me kontratën se validiteti juridik i saj vlerësohet ndaras nga ajo.⁵¹ Doktrina juridike rreth autonomisë së kontratës për arbitrazhin nisët nga fakti se kontrata për arbitrazhin nga përmbajtja e saj nuk konsiderohet si kontratë e pastër materialo-juridike sepse po të ishte e tillë automatikisht do të pësonte fatin e kontratës kryesore por në vete përmban të dyja këto elemente materialo-juridike po ashtu edhe ato procedurale juridike. Prania e këtyre dy elementeve mundëson bërjen e dallimit ndërmjet kontratës për arbitrazhin dhe kontratës kryesore dhe për këtë arsye ekziston mundësia që njëra kontratë të mbizotërojë tjetrën. Deri në Luftën e Dytë Botërore ka mbizotëruar qëndrimi se kontrata për arbitrazhin gjithëherë duhet të pësojë fatin e kontratës kryesore, andaj edhe arbitrazhet kur ndonjëra prej palëve kontestonte plotvlefshmërinë e kontratës kryesore, në raste të këtilla ato e shpallnin veten jokompetente për zgjidhjen e atij kontesti që buronte nga ajo kontratë.

Disa autorë mendojnë se autonomia e kontratës për arbitrazhin është e mundur për nga momenti i lidhjes së kontratës kryesore parimisht ekzistojnë dy kontrata njëra si kontratë primare, e cila ka të bëjë me

51 Mbi mëvetësinë e klauzolës për arbitrazhin. Ph. Fochard, at auters, *Troite de l'arbitrage commercial international*, 1996, pp 213-259, si dhe A. Reidfern e M. Hunter, *la and practice of international commercial arbitration*, 1991, pp 174-176. Trajković M., *Međunarodno arbitražno pravo*, Beograd, 2000, fq. 267.

obligimet komerciale ndërmjet palëve dhe tjetra si kontratë kolaterale, e cila ka të bëjë me obligimet e palëve që ndërmjet tyre do të zgjidhen përmes arbitrazhit. Mendimi për ndarjen e së arbitrazhit nga kontrata kryesore pranohet me vështirësi sepse edhe teoria edhe praktika e arbitrazhit nuk e mohojnë faktin se kontrata kryesore është një tërësi edhe pse në veten e saj përmban klauzolën e veçantë për arbitrazhin.

Rreth autonomisë së kontratës për arbitrazhin në raport me kontratën kryesore ekziston mendimi se arbitrazhi është ai i cili mund t'i evitohet pasojat "jonormale", të cilat rrjedhin nga kontrata jonormale por të shkaktuara nga fugia mbinatyrore apo ndonjë faktorë tjetër. Kur flitet për autonominë e kontratës për arbitrazhin shtrohet pyetja se çfarë do të ndodhë nëse kontratën kryesore e ka lidhur personi i paautorizuar nga pala ndërsa klauzolën për arbitrazhin e nënshkruan përfaqësuesi i palës me autorizim të plotë. Në këtë situatë do të ishte jologjike thonë praktikët që kontrata për arbitrazhin të shuhet bashkë me kontratën kryesore sepse detyra e kontratës për arbitrazhin është që t'i korrigjojë mangësitë e kontratës kryesore.

Autonomia e kontratës për arbitrazhin si parim gjen mbështetje si në buimet juridike ndërkombëtare, po ashtu edhe në ligjet nacionale për arbitrazhin.

a) Autonomia e kontratës për arbitrazhin në burimet juridike ndërkombëtare. Kohëve të fundit praktika e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare është angazhuar që kontrata për arbitrazhin të jetë autonome apo e pavarur nga kontrata kryesore. Nga burimet juridike ndërkombëtare ndër të parat që inkorporoi parimin e autonomisë së kontratës për arbitrazhin nga kontrata kryesore është rregullorja e arbitrazhit pranë Odës së Tregtisë Ndërkombëtare apo ICC arbitrazhi me seli në Paris, në të cilën thuhet se klauzola për arbitrazhin është e pavarur dhe se tribunali do të respektojë atë edhe përkundër mosekzistimit të kontratës kryesore, çka nënkupton se arbitrat në raste të këtilla nuk ta shpallin veten jokompetent për shkak të mosekzistimit të kontratës kryesore.⁵² Autominë e kontratës për arbitrazhin ndërkombëtar e njohin edhe rregullat e UNCITRAL-it të vitit 1976, ku thuhet se „kontrata për arbitrazhin është kontratë në vete në raport me pjesët tjera të kontratës kryesore dhe se anulimi i kontratës kryesore nuk do të kushtëzojë edhe

52 Neni 8, par. 4 i rregullores së ICC arbitrazhit i viteve 1975, ndërsa me ndryshimet në vitin 1998, vetëm i ndryshohet vendi (p.sh. neni 6 parimi 4). Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 269.

anulimin e kontratës për arbitrazhin."⁵³ Parimin e autonomisë së kontratës për arbitrazhin në raport me kontratën kryesore e njohin edhe gjyqi i LCIA⁵⁴ arbitrazhi ndërkombëtar me seli në Londër në rregulloren e vitit 1985 si dhe Shoqata Amerikane e Arbitrazhit (AAA)⁵⁵ në rregulloren e saj të vitit 1992. Njohja e autonomisë kontratës për arbitrazhin nga këto dy rregullore të arbitrazheve jep të kuptohet se gradualisht po braktiset sistemi juridik i Common Law-it për arbitrazhin.

Rreth autonomisë së kontratës për arbitrazhin në raport me kontratën kryesore, konventa ndërkombëtare si ajo e Nju Jorkut po ashtu edhe ajo Evropiane për arbitrazhin disi në mënyrë të tërthortë bëjnë fjalë për këtë çështje. Më e qarta rreth autonomisë së kontratës për arbitrazhin është Konventa e Uashingtonit e vitit 1965 ku në nenin 41 të kësaj rregulloreje thuhet se "*tribunali i arbitrazhit vendos vet për kompetencën e tij*".

b) Autonomia e kontratës për arbitrazhin në ligjet nacionale.

Edhe ligjet nacionale, shumica prej tyre e njohin autonominë e kontratës për arbitrazhin në raport me kontratën kryesore. Rreth njohjes së autonomisë së kësaj kontrate shumica prej tyre u ndikuan nga Ligji model i UNCITRAL-it i vitit 1985. Ndër ligjet nacionale të cilat njohën autonominë e kësaj kontrate janë: ligji belg për arbitrazhin i vitit 1972, ligji holandez i procedurës civile 1986, ligji zviceran i të drejtës private ndërkombëtare etj. Pjesa tjetër e ligjeve për njohjen e autonomisë së kontratës për arbitrazhin në raport me kontratën kryesore u ndikuan nga praktika gjyqësore apo praktika e arbitrazhit, kështu vepruan ligji anglez, i ShBA-ve dhe ai francez për arbitrazhin.

2.2. PASOJAT JURIDIKE TË AUTONOMISË SË KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Pasojat apo efektet juridike të cilat i prodhon autonomia e kontratës për arbitrazhin veprojnë në dy drejtime: drejtimi i parë ka të bëjë me pavarësinë e kontratës arbitrazhin në raport me kontratën kryesore dhe i dyti ka të bëjë me mundësinë që kontrata për arbitrazhin t'i nënshtrohet ndonjë ligji tjetër e jo atij, i cili ishte aplikuar në kontratën kryesore.

53 Neni 20.pika 2 i rregullores së UNCITRAL arbitrazhit. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 269.

54 LCIA.

55 AAA - Amerikan Asociacion Arbitration.

a) Autonomia e kontratës për arbitrazhin në raport me kontratën kryesore. Me autonominë e kontratës për arbitrazhin kuptojmë se ekzistimi, plotvlefshmëria si dhe efektet e tjera të kontratës për arbitrazhin nuk e kanë të lidhur fatin e tyre juridik me fatin e kontratës kryesore. Nga kjo kuptohet se nëse konstatohet se kontrata kryesore është inekzistente, e anuluar, e ndërprerë apo në të është inkorporuar ndonjë risi, kjo nuk nënkupton që të gjitha këto veprime automatikisht do të godasin edhe kontratën për arbitrazhin. Shpallja e kontratës kryesore si inekzistente, e anuluar, e shkëputur etj., çon drejt trajtimit të dy situatave. Situata e parë çon drejt pozitës që arbitrat të vendosin vetë ekzistimit dhe plotvlefshmërisë së kontratës kryesore dhe nëse konstatojnë plotvlefshmërinë e saj, atëherë ata vazhdojnë me procedurën për zgjidhjen e kontestit të nga ajo kontratë. Ndërsa situata e dytë krijohet atëherë kur arbitrat konstatojnë mosekzistimin apo anulimin e kontratës kryesore nga shkaqe të arsyeshme ku dhe shtrohet pyetja se si të veprohet me tej me atë kontratë. Lidhur me situatën e dytë juridike ka kundërshtuar dhënien e autorizimit të arbitrave që ata të vendosin pasojat juridike të kontratës, e cila tanimë është inekzistente apo e anuluar. Një qëndrim të këtillë dikur e mbante edhe praktika gjyqësore franceze ku thuhej se *“kontrata për arbitrazhin pëson fatin e njëjtë me atë të kontratës kryesore përveç nëse palët në kontratën për arbitrazhin shprehimisht kanë paraparë se arbitrat mund të vendosin edhe pasojat juridike të kontratës së asgjësuar”*, çka nënkuptohet se mbijetueshmëria e kontratës për arbitrazhin në raport me kontratën kryesore nuk do të ishte e kontestueshme në të drejtën franceze.⁵⁶ Qëndrim identik me të drejtën franceze rreth autonomisë së kontratës për arbitrazhin mban edhe e drejta angleze.

Nëse konstatohet mosekzistimi i kontratës kryesore ndërsa me padi kërkohet që të për pasojat juridike të saj atëherë arbitrat janë të autorizuar që të nxjerrin një vendim për të. Pavlefshmëria e kontratës kryesore drejtpërdrejt godet dhe asgjëson kontratën për arbitrazhin. Nëse konstatohet se kontratën kryesore e ka lidhur pala të cilës i mungonte aftësia për të kontraktuar, atëherë në këtë situatë arbitrazhi e shpall veten jokompetent për të zgjidhur kontestin e dalë nga ajo kontratë. Kontrata kryesore e lidhur në rrethanat e lajthitjes parimisht ajo është inekzistente. Në anën tjetër nëse kontrata për arbitrazhin është e lidhur në suaza normale dhe kontesti i shfaqur është sjellë pranë arbitrazhi për shqyrtim, në këtë rast shtrohet pyetja se si të veprojë arbitrazhi, të shpall veten

56 Matulsky, juris classeur periodique, 1956, fq. 9460. J. Perović, Ugovor o međunarodnoj trgovinskoj arbitraži, 2002, fq. 25.

kompetent për zgjidhjen e atij kontesti apo jo. Fillimisht arbitrazhi duhet konstatojë mosekzistimin e kontratës kryesore me një vendim të karakterit deklarativ, ndërsa mbi pasojat juridike do të vendosë sipas rregullave të përgjithshme varësisht nga kërkesëpadia. Nëse palët nuk kanë filluar me përmbushjen e obligimeve të dala nga kontrata kryesore, atëherë nuk bëhet fjalë për pasoja juridike, e nëse i kanë përmbushur ato në tërësi apo pjesërisht, arbitrazhi në këtë situatë do të aplikojë rregullat e së drejtës aplikative lidhur me restituimin (*kthimin në gjendjen e mëparshme si dhe kompensimin e dëmit*).

b) Mundësia e aplikimit të ligjit tjetër në rregullimin e kontratës për arbitrazhin. Pasoja apo efekti tjetër i parimit të autonomisë së kontratës për arbitrazhin ka të bëjë me mundësinë që kontrata për arbitrazhin të mos rregullohet me dispozitat e të njëjtit ligj me të cilat është rregulluar kontrata kryesore. Thënë shkurt, kontrata për arbitrazhin mund t'i nënshtrohet ndonjë ligji tjetër nga ai i aplikuar në kontratën kryesore. Aplikimin e ligjit tjetër për rregullimin e kontratës për arbitrazhin shumë qartë e definojnë edhe Konventa e Romës⁵⁷ në të cilën thuhet se “*klauzola kompromisore paraqet pjesën distinktive të kontratës të cilën palët apo arbitrat e tyre mund t'ia nënshtrojnë ndonjë ligji tjetër nga ai me të cilin është rregulluar pjesa tjetër e kontratës*”, (neni 3, paragrafi 1 dhe 4 i kësaj konvente), pra Konventa e Romës duke u mbështetur në parimin e autonomisë së kontratës për arbitrazhin, njeh mundësinë e rregullimit të kontratës për arbitrazhin qoftë edhe me ligjin kompetent (*të përzgjedhur nga palët apo arbitrat e tyre*).

Në kuadër të efekteve të parimit të autonomisë së kontratës për arbitrazhin shtrohet edhe pyetja se sipas cilës së drejtë tani duhet vlerësuar plotvlefshmërinë e kontratës për arbitrazhin. E drejta krahasimore njeh tri metoda rreth përcaktimit të normave, të cilat do të aplikoheshin në rregullimin e kontratës për arbitrazhin e ato janë: metoda kolizive (*e konfliktit të ligjeve*), metoda e rregullave materiale dhe metoda e kombinuar kolizivo-materiale - in favorem validatis.

3. KONTRATA PËR ARBITRAZHIN DHE KUSHTET PËR LIDHJEN E SAJ

Për nga natyra e saj edhe kontrata për arbitrazhin i përket të drejtës obligative-detyrimore. Kjo kontratë për të qenë e plotëfuqishme si dhe për të prodhuar efekte juridike duhet t'i plotësojë kushtet e përcaktuara

57 Konventa e Romës, shih neni 3, paragrafi 1 dhe 4.

nga e drejta obligative e ato janë: 1) aftësia e palëve për të kontraktuar, 2) vullneti i palëve për të kontraktuar, 3) lënda apo objekti për të cilën kontraktohet dhe 4) forma në të cilin lidhet kontrata.

3.1. AFTËSIA E PALËVE PËR TË KONTRAKTUAR ARBITRAZHIN

Kontrata për arbitrazhin për të qenë e plotfuqishme si dhe për të prodhuar efekte juridike nevojitet që palët të posedojnë aftësinë për të kontraktuar (*capacite de compromittre*). Me aftësi kontraktuese nënkuptohet se personi i cili dëshiron të kontrakttojë arbitrazhin patjetër duhet të posedojë aftësinë për të vepruar, aftësi të cilën e përcaktojnë ligjet nacionale. Vetë natyra juridike e kontratës për arbitrazhin hap dilemën për të kontraktuar arbitrazhin palëve u nevojitet posedimi vetëm i aftësisë për të vepruar apo edhe i aftësisë kontestimore. Rreth aftësisë së palëve për të kontraktuar arbitrazhin ekzistojnë dy mendime: mendimi sipas teorisë juridikcionale dhe mendimi teorisë kontraktuale.

a) **Aftësia e palëve sipas teorisë juridikcionale** thuhet se të gjitha sistemet juridike nacionale, të cilat janë përcaktuar për karakterin juridikcional të natyrës së arbitrazhit, në mungesë të rregullave precize rreth përcaktimit të aftësisë së palëve për të kontraktuar mbajnë qëndrimin se palët kontraktuese duhet të posedojnë aftësi edhe juridike për të vepruar (*civilo-juridike*) si dhe aftësinë kontestimore (*proceduralo-juridike*). Në këso lloj konkludimi çon fakti se edhe kontrata jashtëprocedurale për arbitrazhin prodhon efekte proceduralo-juridike.⁵⁸ Në favor të kësaj thuhet se aftësia juridike dhe aftësia për të qenë palë në kontratë për arbitrazhin si dhe aftësia për të vepruar dhe ajo kontestimore nuk përputhen në tërësi, andaj për lidhjen e kontratës nevojitet posedimi i të dyja aftësive, si civilo-juridike po ashtu edhe asaj proceduralo-juridike.⁵⁹

b) *Aftësia e palëve sipas teorisë kontraktuale*, për të kontraktuar arbitrazhin është e mjaftueshme që palët të posedojnë vetëm aftësinë për të vepruar. Sipas Fouchardit dhe Davidit ky koncept burimin e gjen në nenin 5059 të kodit civil francez ku thuhet se “*të gjithë personat mund të kontraktojnë arbitrazhin në bazë të së drejtës, të cilën lirshëm e*

58 T. Varadi. O arbitra`i i njenoi pravnoj prirodi i arbitra`nom ugovoru nav. delo str., 25. Perović. J., Ugovor o Međunarodnoj trgovinskoj arbitraži, Beograd, 2002, fq. 88.

59 J. Juhart. Navedeni zbornik pod nazivom, Spolna trgovinska arbitraža, 1. Str. 122. Perović. J., Ugovor o međunarodnoj trgovinskoj arbitraži. Beograd, 2002, fq. 88.

posedojnë”,⁶⁰ ndërsa aftësia kontestimore e palëve kërkohet vetëm atëherë kur lidhja e kontratës për arbitrazhin ka për qëllim kryerjen e ndonjë veprimi kontestimor.

Me rastin e konstatimit të aftësisë së palëve për të kontraktuar arbitrazhin duhet pasur kujdes se kjo aftësi nevojitet për lidhjen e kontratës apo për ekzekutimin e saj. Nëse kontrata për arbitrazhin kuptohet si kontratë materialo-juridike, e cila prodhon efekte proceduralo-juridike për lidhjen e saj palët duhet të posedojnë vetëm aftësinë për të vepruar, ndërsa aftësia kontestimore kërkohet vetëm atëherë kur vjen te ekzekutimi i saj. Çështja e aftësisë së palëve për të kontraktuar më shumë i përket teorisë se sa praktikës. Në planin praktik, aftësia për të vepruar aplikohet te personat fizikë si palë kontraktuese, ndërsa kur është në pyetje personi juridik aftësia e tij shndërrohet në autorizimin përfaqësim.

Përcaktimi i aftësisë kontraktuese rregullohet më ligj dhe palët nuk mund ta ndryshojnë dhe as ta përzgjedhin atë. Për përcaktimin e aftësisë së palëve për të vepruar kompetent ligji vendor - *lex fori* ose *lex causae* - ligji i domicilit apo vendbanimit të palëve.

Në kuadër të aftësinë për të kontraktuar do të përmendim edhe aftësinë e palës për të kontraktuar arbitrazhin në emër të ndonjëres prej palëve nëse ajo është e penguar për ta bërë atë. Zakonisht përfaqësimi përdoret te personat juridikë por - edhe te personat fizikë. Aftësia e përfaqësuesit rregullohet përmes autorizimit të dhënë nga pala e përfaqësuar. Sipas rregullave të së drejtës obligative personi juridik përfaqësohet nga përfaqësuesi i tij ligjor, ndërsa personi fizik nga avokati i tij por jo sipas ligjit por me kontratën për përfaqësim.

Si te kontratat tjera po ashtu edhe te kontrata për arbitrazhin i autorizuari vepron në emër dhe për llogari të të autorizuarit, ku të drejtat dhe obligimet e dala nga ajo kontratë bien në barrën e të përfaqësuarit, qoftë ai përfaqësim ligjor, qoftë kontraktual. Autorizimi zakonisht jepet në formën e shkruar.

3.2. VULLNETI I PALËVE PËR TË KONTRAKTUAR ARBITRAZHIN

Njëri ndër kushtet thelbësore që kontrata për arbitrazhin të jetë e plotfuqishme dhe të prodhojë efekte juridike është edhe vullneti i shprehur i palëve për të kontraktuar arbitrazhin. Vullneti dhe pëlqimi

60 Ph. Fouchard, F. Gailard, B. Golman, Op{ti citat str. 271. Perović. J., Ugovor o međunarodnoj trgovinskoj arbitraži, Beograd, 2002, fq. 88.

duhet të jenë serioz, konkret, i realizueshëm dhe i lirshëm. Mungesa e ndonjërit prej këtyre kushteve e vënë në pikëpyetje ekzistimin dhe efektet juridike të kontratës për arbitrazhin. Shprehja e lirë e vullnetit dhe pëlqimit të palëve për të kontraktuar arbitrazhin vlejnë si për arbitrazhin vendor, po ashtu për atë ndërkombëtar. Praktika dëshmon se kur ndonjëra prej palëve synon t'i shmanget kompetencës së arbitrazhit zakonisht thirret në mungesën e vullnetit apo për të kontraktuar arbitrazhin, mungesë e cila e vë në pikëpyetje kontratën në fjalë. Palët, pos lajthitjes nganjëherë thirren edhe në faktin se lidhjen e kontratës e kanë bërë nën masat e kërcënimit, gjë që prania e kësaj mase çon në anulimin e kontratës për arbitrazhin.

Në fund vlen të theksohet se kur ndonjëra nga palët kontraktuese konteston

plotfuqishmërinë e kontratës për arbitrazhin për shkak të mungesës së vullnetit për të kontraktuar, atëherë shtrohet pyetja se a është në kompetencën e tribunalit për të konstatuar atë mangësi apo duhet drejtuar gjykatës. Sipas parimit competence-competence, vlerësimi i këtyre mangësive mbetet në kompetencën e tribunalit të arbitrazhit.

3.3. LËNDA APO OBJEKTI I KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Kushti tjetër për të qenë e plotfuqishme kontrata për arbitrazhin ajo duhet të posedojë lëndën apo objektin e saj. Lënda e kontratave përbëhet prej bërjes, mosbërjes dhe durimit apo prestimit të diçkasë (ndonjë veprimi). Kontrata për arbitrazhin për të qenë e plotfuqishme është rregull që lënda e saj të jetë e mundshme, e përcaktuar dhe e lejueshme për t'u realizuar. Ky rregull vlen si për kontratën e arbitrazhit vendor, po ashtu edhe të atij ndërkombëtar. Në vazhdim do të bëhet fjalë rreth mundshmërisë, përcaktueshmërisë dhe lejueshmërisë së kontratës për arbitrazhin.

a) Mundshmëria e lëndës së kontratës për t'u realizuar. Nëse palët kontraktuese janë përcaktuar për zgjidhjen e kontestit të tyre pranë një arbitrazhi, i cili ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë, atëherë lënda e kontratës është e mundshme për t'u zgjidhur, e nëse palët janë përcaktuar për një arbitrazh, i cili në momentin e kontraktimit ekzistonte por tanimë nuk ekziston apo nuk ka ekzistuar fare, në këtë situatë krijohet pamundshmëria për realizimin e lëndës së kontraktuar. Në raste të këtilla krijohen dy situata, në situatën e parë kemi të bëjmë me ndërprerjen e kontratës për arbitrazhin për shkak të pamundësisë së realizimit të saj

sepse arbitrazhi i kontraktuar tanimë nuk ekziston, ndërsa në situatën e dytë

kontrata për arbitrazhin shpallet inekzistente sepse pamundësia e zbatimit të saj ishte e pranishme që në momentin e lidhjes së kontratës sepse arbitrazhi i kontraktuar nuk ka ekzistuar fare. Sipas situatës së parë e cila u krijua me shuarjen e funksionimit të të mëvomshëm të arbitrazhit të kontraktuar quhet “pamundësi subsekvente”. Ndërsa sipas situatës së dytë e cila ishte krijuar që në momentin e lidhjes së kontratës për arbitrazhin, i cili fare nuk ka ekzistuar, quhet “pamundësi iniciale”.

b) Përcaktueshmëria e lëndës për arbitrazhin. Për të qenë kontrata për arbitrazhin e plotëfuqishme si kusht parashihet edhe përcaktueshmëria e lëndës së obligimeve. Kjo nënkupton se palët kontraktuese saktësisht duhet të përcaktojnë lëndën e obligimeve rreth kontestit të shfaqur apo që mund të shfaqet më vonë të cilin do t’ia besojnë arbitrazhit të caktuar. Rreth përcaktueshmërisë së lëndës është bërë fjalë te klauzola patologjike për arbitrazhin, andaj këtu nuk do të bëhet fjalë më tepër.

c) Arbitrabiliteti apo lejueshmëria e lëndës për t’u kontraktuar dhe realizuar. Kontrata për arbitrazhin përkatësisht lënda e saj për të prodhuar efekte juridike pos plotëfuqishmërisë ajo duhet të jetë edhe e lejueshme apo arbitrabile për t’u realizuar. Në njërën anë ajo duhet të jetë e lidhur ndërmjet palëve, të cilave u lejohet kontraktimi i kompetencës së arbitrazhit (*arbitrabiliteti ratione personae*) dhe në anën tjetër se çështja ka të bëjë me

materien e lëndës, e cila është e përshtatshme për t’u zgjidhur me arbitrazh (*arbitrabiliteti ratione materiae*). Arbitrabiliteti, si ai subjektiv (*ratione personae*) po ashtu dhe ai objektiv (*ratione materiae*), janë të varur drejtpërdrejt nga dispozitat e rendit publik shtetëror, i cili me anën e dispozitave ligjore e kufizon autonominë e vullnetit të palëve duke përcaktuar se kush mund të lidhë kontratë për arbitrazhin dhe cila mund të jetë lënda e asaj kontrate. Pra rregullat lidhur me arbitrabilitetin e kontratës për arbitrazhin janë të natyrës imperative (*ius cogens*), pjesë e rendit publik të shtetit dhe palët gjatë kontraktimit duhet të kenë kujdes në moscenimin e tyre. Në rast se arbitrazhi e nxjerr vendimin në rrethanat e mosarbitrabilitetit të lëndës së kontratës ai vendim do të jetë i kontestueshëm.

Në anën tjetër arbitrabiliteti objektiv ka të bëjë me lejueshmërinë apo përshtatshmërinë e lëndës së kontratës për t’u zgjidhur me arbitrazh. Disa autorë arbitrabilitetit objektiv i kushtojnë kujdes më të madh se sa atij subjektiv.

Për arbitrabilitetin objektiv pos ligjeve nacionale bëjnë fjalë edhe konventat ndërkombëtare për arbitrazhin si, Protokollin i Gjenevës i vitit 1923, Konventa e Nju e vitit 1958 dhe Konventa Evropiane e vitit 1961 etj. Në Konventën e Nju Jorkut thuhet se: vendimet të arbitrazhit mund t'i refuzohet njohja dhe ekzekutimi nëse lënda e kontratës për arbitrazhin nuk ishte arbitrabile për t'u zgjidhur me arbitrazh. Ndërsa Konventa Evropiane çështjen e vlerësimit të arbitrabilitetit të lëndës së kontratës ua lë për zgjidhje ligjeve nacionale për arbitrazhin.

Të drejtat nacionale arbitrabilitetin e lëndës së kontratës për arbitrazhin e rregullojnë secila në mënyrën e saj. Disa të drejta si ajo gjermane, bullgare etj., në mënyrë taksative përcaktojnë se cilat konteste janë arbitrabile e cilat jo, ndërsa e drejta zvicerane parasheh se të gjitha kontestet pronësoro-juridike janë arbitrabile dhe mund të zgjidhen me arbitrazh. Në anën tjetër e drejta e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare njih konteste, të cilat nuk janë arbitrabile, si: kontestet e dala nga korrupsioni, antitrusti, patentet, vulat etj.

3.4. FORMA E LIDHJES SË KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Në të drejtën e arbitrazhit dominon rregulla se kontrata për arbitrazhin zakonisht duhet të jetë në formën e shkruar. Rreth formës së shkruar të kontratës për arbitrazhin bëjnë fjalë si konventat ndërkombëtare, po ashtu edhe ligjet nacionale si dhe rregulloret e arbitrazheve. Siç dihet ekzistojnë dy lloje të formës së shkruar të kontratës për arbitrazhin. Forma e parë quhet *solemnitate ad validaten*, formë e cila konsiderohet si kusht për ekzekutimin e kontratës për arbitrazhin dhe forma e dytë *ad probationem*, formë e cila konsiderohet si mjet për të dëshmuar ekzistimin e kontratës për arbitrazhin. Forma më e pranuar e kontratës së shkruar është ajo e cila është shkruar me dorë, makinë shkrimi apo ndonjë mjet tjetër dhe e nënshkruar me vetë dorën e palëve. Në praktikë vërehet se si konventat ndërkombëtare po ashtu edhe ligjet nacionale rreth formës së shkruar të kontratës gjithnjë e më shumë po vijnë duke e zbutur qëndrimin e tyre sepse dinamika e zhvillimeve në shek. XX e posaçërisht dinamika e zhvillimit të tregtisë, si asaj nacionale po ashtu edhe asaj ndërkombëtare, e në anën tjetër zhvillimi i informatikës dhe telekomunikacionit nuk durojnë ngadalësim dhe formalizëm të tepruar në lidhjen e marrëdhënieve juridike sepse prania e mjeteve moderne të komunikimit ndërmjet palëve për të kontraktuar kërkon thjeshtësi e jo formalizëm.

- **Konventat ndërkombëtare.** Prej konventave ndërkombëtare të cilat mbajnë qëndrim rreth formës së shkruar të kontratës për arbitrazhin

janë: Konventa e Nju Jorkut e vitit 1958, Konventa Evropiane e vitit 1961 dhe Ligji model i Uncitral-it për arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare i vitit 1985.

- **Ligjet nacionale** ende mbajnë qëndrimin se kontrata për arbitrazhin duhet të jetë në formën e shkruar por disa prej tyre kanë filluar ta zbusin këtë qëndrim. Ligji spanjoll dhe ai norvegjez në një farë mënyre po e braktisin rigorozitetin e formës së shkruar të kontratës për arbitrazhin ndërsa disa ligje tjera si, ai francez i vitit 1988-91, hap debatin se forma e shkruar e kontratës shërben si kusht qenësor (*ad solemnitatem*) për ekzistimin e kontratës apo shërben si mjet dëshmues për ekzistencën e saj (*ad probationem*). E drejta amerikane për arbitrazhin ende ruan formën e shkruar të kontratës për arbitrazhin si element qenësor, por disi më të butë ku parashihet se për lidhjen e kontratës mund të shërbejë edhe porosia nëse ajo është realizuar.

4. EFEKTET JURIDIKE TË KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Edhe kontrata për arbitrazhin njësoj sikurse edhe kontratat e tjera prodhon efektet e saj juridike, andaj edhe me të drejtë thuhet se “*kontrata e lidhur ndërmjet palëve është ligj për palët*”.⁶¹ Kështu thuhet në ligjin francez të së drejtës civile.

Kur bëhet fjalë për efektet juridike të kontratës në përgjithësi shtrohen dy çështje të cilave duhet dhënë përgjigje e ato janë: e para, se ndërmjet cilëve persona kontrata prodhon efekte juridike dhe e dyta, se çfarë janë ato obligime të cilat i prodhon kontrata në raport me palët kontraktuese. Në parim kontratat prodhojnë efekte juridike vetëm ndërmjet palëve kontraktuese por në raste të caktuara ato efekte mund të shtrihen edhe te personat e tretë. Për të shtrirje të efekteve do të bëhet fjalë te ndërrimi i subjekteve në kontratë

Kontrata për arbitrazhin është aso lloj kontrate përmes së cilës palët obligohen që konteste, të cilat do të rrjedhin nga marrëdhënia e tyre juridike do t'a besojnë për zgjidhje arbitrazhit e jo gjykatës. Nga ky përkufizim mund të kuptohet se kontrata për prodhon efekte të dyfishta e ato janë efektet pozitive dhe efektet negative.

61 Një rregull i tillë gjendet në të drejtën civile franceze, neni 1134 ku thuhet se “kontrata e lidhur sipas ligjit ka vlerën e ligjit për palët. Perović J., Ugovor o međunarodnoj trgovinskoj arbitraži, Beograd, 2002, fq. 153.

4.1. EFEKTET POZITIVE TË KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Efektet pozitive të cilat dalin nga kontrata për arbitrazhin janë: a) dhënia e besimit, b) dhënia e kompetencës dhe c) akti i konstituimit të tribunalit, i cili do të zgjidhë atë kontest.

a) Dhënia e besimit arbitrazhit për të zgjidhur kontestin. Për t'ia besuar zgjidhjen e kontestit arbitrazhit të paraparë me kontratë pos ligjeve nacionale bëjnë fjalë edhe disa konventa ndërkombëtare për arbitrazhin si: Protokollin i Gjenevës i vitit 1923, Konventa e Jorkut e vitit 1958 etj. Në nenin 2 pika 1 të Konventës së Nju Jorkut thuhet se “*secili shtet nënshkruet i kësaj konvente njeh kontratën e shkruar me të cilën palët obligohen që të lënë në kompetencën e arbitrazhit të gjitha kontestet apo disa prej tyre, të cilat janë shfaqur apo do të shfaqen më vonë nga marrëdhënia e tyre juridike për zgjidhje*”. Si në të drejtën e arbitrazhit vendor po ashtu edhe të atij ndërkombëtar ndaj palëve, të cilat refuzojnë respektimin e kontratës së lidhur për arbitrazhin parashihen sanksione dhe mekanizma të ndryshëm për të realizuar atë.

b) Dhënia e kompetencës. Efekti i dytë pozitiv i kontratës për arbitrazhin ka të bëjë dhënien e kompetencës tribunalit të arbitrazhit për ta zgjidhur atë kontest, i cili tanimë besuar për zgjidhje. Në vazhdim do të bëhet fjalë rreth kompetencës së arbitrazhit.

- Parimi competence-competence, që arbitrazhi të vendosë për kompetencën e tij. Me parimin kompetenca e kompetencës kuptojmë se tribunali i arbitrazhit është i autorizuar që të kualifikojë vetveten se është apo jo kompetentë për të zgjidhur kontestin e parashtruar pranë tij për zgjidhje. Parimi që arbitrazhi të vendosë për kompetencën e tij në njëfarë mënyrë atij i mundëson që të pavarësohet nga ndikimi i gjykatës së rregullt. Ky parim u krijua mu atëherë kur arbitrazhi kishte nevojë për forcimin e pozitës së tij si trup i

gjyqtarëve privatë. Të drejtën për të vendosur për kompetencën e tij arbitrazhi e fitoi pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa para kësaj lufte për kompetencën e tij vendoste gjykata kompetente.

Shprehja competence-competence fillimisht rrodhi nga gjuha gjermane që nëkuptonte të drejtën e arbitrave që për zgjidhjen e kontestit të caktuar të vendosnin pa kurrfarë kontrolli shtesë gjyqësor. Këtë shprehje më vonë e përvetësoi edhe doktrina franceze për arbitrazhin por me një interpretim më ndryshe nga ajo gjermane ku thuhej se “*vendimit të arbitrazhit duhet shtuar edhe një kontroll të mëvonshëm gjyqësor në*

kompetencën e tij". Doktrina franceze përmes interpretimit të kësaj shprehjeje i jep përparësi në kohë që arbitrazhi i pari të vendosë për kompetencën e tij por nën rezervën se për një kompetencë të tillë më vonë do të deklarohet edhe gjykata e rregullt.

Parimi kompetenca e kompetencës përveçse kontribuoi në autonominë e tribunalit të arbitrazhit në njëfarë mënyre konsiderohet edhe si pengesë evidente edhe për palën, e cila synon kundërshtimin e kompetencës së arbitrazhit si dhe zvarritjen e procedurës për zgjidhjen e kontestit.

Parimi i kompetencës së arbitrazhit për të vendosur për kompetencën e tij gjen vend si në konventat ndërkombëtare po ashtu edhe në ligjet nacionale për arbitrazhin.

- ***Parimi competence-competence në burimet ndërkombëtare për arbitrazhin.*** Me parimin që arbitrazhi të vendosë vetë për kompetencën e tij janë marrë edhe konventat ndërkombëtare si, Konventa Evropiane e vitit 1961, Konventa e Uashingtonit e vitit 1965 si dhe Ligji model i UNCITRAL-it i vitit 1985.

Në Konventën Evropiane rreth parimit competence-competence thuhet "*nën rezervën e ndonjë kontrolli gjyqësor të paraparë sipas ligjit vendor lex-forit, arbitri kompetenca e të cilit kontestohet, është i autorizuar që të vazhdojë arbitrimin sepse vetë do të nxjerrë vendimin për kompetencën e tij si dhe do të vendosë për plotfuqishmërinë e kontratës për arbitrazhin*".⁶². Sipas kësaj kuptohet se kjo konventë deklarohet në favor të së drejtës së arbitrit që ai vetë të vendosë për kompetencën e tij.

Ndërsa në Konventën e Uashingtonit të vitit 1965 rreth parimit competencecompetence thuhet se "*tribunali vendos vetë për kompetencën e tij*".⁶³

Edhe Ligji model i UNCITRAL-it i vitit 1985 bën fjalë rreth parimit competencecompetence ku thuhet se "*arbitrat vetë vendosin për kompetencën e tyre, për plotvlefshmërinë e kontratës për arbitrazhin nëse ajo kontestohet si dhe për thelbin e kontestit*".⁶⁴ Është interesant të theksohet se Ligji-model i UNCITRAL-it çështjes së kompetencës i jep karakter fakultativ dhe në njëfarë mënyre lejon që procedura rreth

62 Neni 5 pika 3 i Konventës Evropiane. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 298.

63 Neni 32 i Konventës së Uashingtonit. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 299.

64 Neni 16 pika 1, 2 dhe 3 të ligjit model të UNCITRAL-it Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 299.

kompetencës së tribunalit në të njëjtën kohë të zhvillohet edhe pranë gjykatës së rregullt.⁶⁵

- *Parimi competence-competence në ligjet nacionale dhe rregulloret e arbitrazheve.* Një numër i konsiderueshëm i ligjeve nacionale gjithashtu njeh parimet e kompetencës së tribunalit për të vendosur për kompetencën e tij si e drejta franceze, ruse, zvicerane, algjeriane etj. E drejta franceze parimin e kompetencës e njeh si për arbitrazhin e brendshëm po ashtu edhe për arbitrazhin ndërkombëtar, i cili zhvillohet sipas të drejtës kompetente franceze.⁶⁶ Ndërsa e drejta ruse rreth parimit competence-competence disi është më origjinale sepse dispozitat e ligjit rus kompetencën e arbitrazhit nuk e shohin vetëm si e drejtë por edhe si obligim për të vendosur për kompetencën e tij".⁶⁷ E ligji kinez për arbitrazhin rreth parimit competence-competence ka një qasje paksa më ndryshe ku thuhet se "këshilli i arbitrazhit ka autorizimin për të vendosur për kompetencën e tij, por në rast se njëra palë konteston vlefshmërinë e kontratës për arbitrazhin dhe kërkon që arbitrat të deklarohen për atë pavlefshmëri, ndërsa pala tjetër po të njëjtën gjë e kërkon, pranë gjykatës shtetërore, atëherë për të dyja këto kërkesa vendos gjykata shtetërore".⁶⁸

Rreth parimit competence-competence siç kemi theksuar më parë bëjnë fjalë si rregullat e UNCITRAL arbitrazhit të vitit 1976, po ashtu edhe rregulloret e disa arbitrazheve institucionale.

Në rregullat e UNCITRAL-arbitrazhit thuhet se "arbitrazhi është i autorizuar të vendosë për të gjitha kundërshtimet me të cilat kontestohet kompetenca e tij duke përfshirë edhe kontestimin e plotvlefshmërisë së kontratës për arbitrazhin. Ndërsa rregullorja e ICC arbitrazhit rreth parimit competence-competence është identike me atë të UNCITRAL-arbitrazhit. Në këtë rregullore thuhet se "nëse i padituri deponon kundërshtimin rreth plotvlefshmërisë së kontratës për arbitrazhin, tribunali i arbitrazhit vendos që ai të vazhdojë me procedimin nëse është i kënaqur me plotvlefshmërinë e kontratës e nëse nuk është i kënaqur atëherë

65 Argument për të ashtuquajturin "concurrent control", sipas Redfemit do të ishte një inkurajim për të paditurin që të zvarrit procedurën pranë arbitrazhit, sepse ligji model lejon që çështja e kompetencës të hapet njëkohësisht edhe pran gjykatës. A. Redfern, op. cit. str. 281. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 299.

66 Neni 1466 i ligjit të ri francez për procedurën civile ku thuhet se; nëse njëra palë konteston kompetencën e arbitrit, arbitrit i takon që vetë të vendos për kufijtë e autorizimit të tij. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 300.

67 Shif nenin 161 të ligjit rus për arbitrazhin e tregtisë së jashtme. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 300.

68 Neni 4 i rregullave të arbitrazhit kinez, për arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 300.

*informon palët se nuk do të procedojë me shqyrtimin e çështjes, ndërsa pala e paditur mban të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës kompetente që të vendosë rreth plotvlefshmërisë së asaj kontrate“.*⁶⁹ Edhe rregullorja e arbitrazhit ndërkombëtar me seli në Londër. Përkundër qëndrimit jostabil të së drejtës angleze rreth parimit competence-competence, kjo e drejtë decidivisht deklarohet se ”gjyqi i arbitrazhit e ka të drejtën për të vendosur rreth kompetencës së tij si dhe për çfarëdo kundërshtimi lidhur me plotvlefshmërinë e kontratës për arbitrazhin“.⁷⁰ Qëndrim gati të njëjtë me rregulloren e ICC arbitrazhit rreth parimit competence-competence mbanë edhe rregullorja e Shoqatës Amerikane për Arbitrazhin (AAA) si dhe rregulloret e arbitrazheve tjera.

c) Konstituimi i tribunalit të arbitrazhit. Edhe akti i konstituimit të tribunalit të arbitrazhit konsiderohet si njëri ndër efektet pozitive të kontratës për arbitrazhin si dhe shënon fazën fillestare të procedurës për zgjidhjen e kontestit. Zhvillimi i procedurës së arbitrazhit që nga konstituimi i tribunalit e deri tek përfundimi i shqyrtimit të kontestit bëhet vetëm për një qëllim, pra për nxjerrjen e një vendimi përfundimtar dhe meritore për kontestin në fjalë. Siç dihet, gjykatat janë organ i përhershëm ndërsa tribunali i arbitrazhit duhet të konstituohet për secilin rast që do ta shqyrtojë. Lidhur me konstituimin e tribunalit të arbitrazhit palët paraprakisht duhet të merren vesh për disa çështje si, caktimin e numrit të arbitrave, procedurën e emërimit të tyre, atributet apo kualitetet e tyre etj

- **Numri i arbitrave** - palët me marrëveshjen e tyre caktojnë numrin e përbërjes së tribunalit. Nëse kontesti është i një vlere të vogël atëherë atë e zgjidh një arbitër i vetëm, e nëse është i një vlere më të madhe atëherë palët përcaktohen për tribunal. Sipas praktikës tribunali i arbitrazhit zakonisht përbëhet prej numrit tek të arbitrave si tre, pesë etj., sepse numrat dy, katër, gjashtë mund të komplikojnë situatën gjatë marrjes së vendimit me shumicë votash. Vlen të ceket se e drejta angleze parashih edhe numrin qift të arbitrave, por nëse vjen deri tek bllokimi i nxjerrjes së vendimit me shumicë votash, atëherë ftohet i tretë i quajtur “*umpire arbitri apo mbiarbitri*” dhe kështu sigurohet shumica e votave për nxjerrjen e vendimit.

- **Procedura rreth emërimit të arbitrave** - rreth emërimit të arbitrave palët gëzojnë autonomi të plotë por gjithnjë duke iu përmbajtur

69 Neni 6 pika 1 i rregullores së ICC arbitrazhit. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 301.

70 Neni 14 i rregullores së LCIA arbitrazhit në Londër. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 301.

kontratës për arbitrazhin sepse atë vetë e kanë lidhur. Sipas rregullave secila palë emëron arbitrin e saj, ndërsa dy arbitrat e zgjedhur emërojnë arbitrin e tretë për kryesues të tyre. Nëse palët për shkaqe të caktuara nuk i kanë emëruar arbitrat atëherë këtë e bën instituti i arbitrazhit në bazë të rregullores së tij. Autonomia e palëve rreth emërimit të arbitrave njihet si me konventat ndërkombëtare po ashtu edhe me ligjet nacionale për arbitrazhin.

Konventat ndërkombëtare të cilat njohin autonominë e palëve rreth emërimit të arbitrave janë: Protokolli i Gjenevës i vitit 1923, Konventa e Gjenevës e vitit 1927, Konventa e Nju Jorkut e vitit 1958 etj. Në Konventën e Nju Jorkut në nenin 5/d, thuhet se “*njohja dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit të huaj do të refuzohet nëse themelimi i gjyqit të arbitrazhit nuk është bërë në përputhje me kontratën e palëve për arbitrazhin, apo në përputhje me ligjin e shtetit të arbitrazhit*”. Sipas kësaj konvente në themelimin e tribunalit përparësi ka autonomia e palëve e në mungesë të saj vjen në shprehje ligji i shtetit të selisë së arbitrazhit.

Siç cekëm më parë autonominë e palëve rreth themelimit të tribunalit të arbitrazhit e njohin edhe ligjet nacionale si, ligji zviceran, francez, holandez, italian etj. Në ligjin zviceran të së drejtës private ndërkombëtare në nenin 179 thuhet se: *arbitrat emërohen, mënjanohen dhe ndërrohen sipas marrëveshjes së palëve*. Dispozita të ngjashme me ligjin zviceran përmbajnë edhe ligjet e shteteve të tjera për arbitrazhin si ai francez, italian etj.

- **Aftësia vepruese dhe atributet e arbitrave.** Ekziston një parim i përgjithshëm se “arbitër mund të jetë secili person i cili është i aftë për të vepruar”. Këtë parim e njohin shumica e ligjeve nacionale si ai rumun, portugez etj., ndërsa ligji çek ia shton edhe kushtin e të qenit moshplotë. Disa ligje tjera nacionale si ai hungarez, egjiptian, italian etj., vetëm përcaktojnë kriteret se kush mund të ushtrojë detyrën e arbitrit e disa të tjera përcaktojnë kriteret rreth aftësisë profesionale që duhet ta posedojë arbitri si p.sh. jurist, ekspert i lëmisë së caktuar etj. Pra sipas natyrës së kontestit duhet të jetë edhe aftësia profesionale e arbitrit. Ndërsa në disa ligje nacionale nuk parashihet si kriter përkatësia gjinore e arbitrit edhe pse më herët gjinisë femërore i ndalohej për të arbitruar sepse konsiderohej se asaj i mungonte aftësia për të vepruar. Një ndalesë e këtillë për femrën ka ekzistuar në ligjin holandez deri në vitin 1954, në ligjin grek deri në vitin 1971, si dhe në disa kantone zvicerane deri në nxjerrjen e konkordatës së vitit 1969. Ndalesa e këtillë ekziston edhe sot në ligjin indonezian të procedurës civile neni 617 edhe pse statusi i femrës ishte i

barabartë me atë të mashkullit. Në ligjin e ri francez për procedurën civile parashihet se funksionin e arbitrit mund ta kryejë vetëm personi fizik (neni 1451 pika 1) ndërsa personi juridik vetëm mund ta autorizojë arbitrin e jo të arbitrojë (neni 1451 pika 2). Kjo mënyrë e rregullimit të ligjit francez ka për qëllim të dihet saktësisht se kush mbanë përgjegjësinë për vendimin e nxjerrë. Sipas disa ligjeve tjera nacionale arbitrave u ndalohet ushtrimi i ndonjë funksioni tjetër paralel me atë të arbitrit, kështu parasheh ligji austriak, turk etj. Konsiderohet se atributet të cilat duhet t'i posedojë arbitri janë garanci e mjaftueshme për palët që gjykimi do të jetë i drejtë dhe objektiv. Romakët e vjetër kishin respekt të veçantë ndaj personalitetit të arbitrit, ndërsa grekët e vjetër arbitrin e quanin (*istor - ai i cili di*).⁷¹ Meqenëse arbitrat konsiderohen figura qendrore në procedurën e arbitrazhit ata duhet të posedojnë disa attribute për të qenë të respektuar e ato janë: autonomia dhe paanshmëria në veprimtarinë e tyre gjatë arbitrimit.⁷²

4.2. EFEKTET NEGATIVE TË KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Ana tjetër e efekteve që i prodhon kontrata për arbitrazhin janë efektet negative. Me efekte negative kuptojmë mohimin e kompetencës së gjykatës shtetërore për zgjidhjen e kontestit të caktuar. Nëse kontesti është kontraktuar që të zgjidhet me arbitrazh, e në anën tjetër lejohet zgjidhja e tij edhe përmes gjykatës shtetërore, atëherë gjyqësia e arbitrazhit e humb kuptimin e ekzistimit të saj, ndërsa mohimi i kompetencës së gjykatës shtetërore e forcon edhe më shumë autoritetin e arbitrazhit si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve.

Nëse gjykata shtetërore gjatë zhvillimit të procedurës për zgjidhjen e kontestit të caktuar konstaton se paraprakisht ka ekzistuar një marrëveshje ndërmjet palëve që ai kontest të zgjidhet me arbitrazh, atëherë gjykata e shpall veten jokompetente për ta zgjidhur atë. Gjykata vendimin për ta shpallur veten jokompetente nuk e ndërmerr sipas detyrës zyrtare *ex-lege* por me arsyetimin se palët me vullnetin e tyre zgjidhjen e atij kontesti ia kanë besuar arbitrazhit, meqë ato janë zotëruesit e kontratës së tyre andaj edhe mund t'i drejtohen qoftë gjykatës, qoftë arbitrazhit për zgjidhjen e kontestit.

71 Për historinë është bërë fjalë edhe në Iliadën e Homerit. Perović. J., Ugovor o Međunarodnoj trgovinskoj arbitraži, Beograd, 2002, fq. 167.

72 Ph. Fouchard, E. Gailard dhe B. Goldman, cit. i përgjithshëm, fq. 583. Perović. J., Ugovor o međunarodnoj trgovinskoj arbitraži, Beograd, 2002, fq. 172.

5. NDËRRIMI I SUBJEKTEVE TE KONTRATA PËR ARBITRAZHIN

Në praktikën e arbitrazhit nganjëherë mund të ndodhë që për shkaqe të caktuara të bëhet bartja e kontratës prej personit, i cili e ka lidhur atë tek personi tjetër. Veprimi i këtillë quhet ndërrim i subjekteve në marrëdhënien kontraktuese. Me rastin e ndërrimit të subjekteve automatikisht shtrohet pyetja se cili do të jetë fati i mëtejme i kontratës për arbitrazhin. Sipas rregullës edhe pas ndërrimit të ndonjërit prej subjekteve kontraktuese kontrata për arbitrazhin edhe më tej do të prodhojë efekte juridike sepse *marrësi mbi vete i kontratës* me pranimin e saj automatikisht bëhet palë e kontratës së bartur tek ai edhe pse nuk e ka lidhur vetë atë. Nëse bartja e kontratës për arbitrazhin nuk bëhet përnjëherë me kontratën kryesore, atëherë ajo do të anulohet sepse mbetet pa lëndën apo objektin e saj.

Në teori dominon qëndrimi se me bartjen e të drejtave dhe obligimeve të dala nga kontrata kryesore njëkohësisht barten edhe të drejtat dhe obligimet të cilat dalin nga kontrata për arbitrazhin tek personi tjetër - pranuesi i kontratës, pra të gjitha të drejtat dhe obligimet e palës barten te personi i cili pranon bartjen e kontratës mbi vete. Prof. B. Pozniq thotë se, *bartja e të drejtave dhe obligimeve te personi tjetër mund të pengohen vetëm nëse cesionari dhe cesusi me një deklaratë decidive janë dakorduar se kontrata për arbitrazhin nuk do të jetë e vlefshme në të ardhmen.*⁷³ Qëndrim të njëjtë me Prof. Poznic mban edhe e drejta franceze për arbitrazhin ku thuhet se *“nëse cesionari dhe cesusi janë dakorduar se kontrata e lidhur për arbitrazhin nga palët e mëparshme nuk do të vlejë, atëherë zgjidhjen e kontesteve të dala nga kontrata kryesore do t’a kryejnë pranë gjykatës shtetërore, sepse sipas tyre kontrata për arbitrazhin tanimë nuk ekziston. E nëse nuk ekziston një deklaram i tillë, atëherë kontrata për arbitrazhin mbetet e plotfuqishme dhe arbitrazhi kontestet e rastit të dala nga ajo marrëdhënie juridike do t’i zgjidhë vetë”*.

Çështje tjetër dhe mjaft e rëndësishme te ndërrimi i subjekteve kontraktuese është edhe çështja e dhënies së pëlqimit të të dyja palëve për bartjen e të drejtave dhe obligimeve tek personi tjetër, i cili nuk ishte nënshkruar i kontratës së lidhur në fillim. Në të kundërtën pala tjetër

73 Pozniq Borivoje, Ugovor o arbitraži i arbitraži ni postupak, aps cit. str. 252. Perović. J., Ugovor o međunarodnoj trgovinskoj arbitraži, Beograd, 2002, fq. 199.

kontraktuese ka të drejtën e refuzimit të bartjes së kontratës te personi i tretë.

Nëse kreditori (huadhënësi) të drejtat dhe obligimet e tij të dala nga kontrata i bart tek personi tjetër, në këtë rast atij nuk i nevojitet edhe pëlqimi i debitorit sepse pozita e debitorit nuk ndryshohet. E nëse debitori (borxhliu) të drejtat dhe obligimet e tij i bart te personi i tretë, ai këtë bartje nuk mund ta bëjë edhe pa pëlqimin e kreditorit, sepse për kreditorin ka rëndësi se kush do të jetë borxhliu i tij i ardhshëm.

Rreth ndërrimit të subjekteve në kontratë qëndrimet e doktrinës ndahen në dysh. Në njërin anë theksohet se duke pasur parasysh marrëdhëniet e palëve me arbitrat e tyre, atëherë do të ishte e udhës të zgjidheshin arbitra të rinj me një marrëveshje të re ndërmjet palëve të reja, e në anën tjetër theksohet se; me bartjen e kontratës për arbitrazhin bashkë me kontratën kryesore te personi tjetër barten edhe të gjitha të drejtat dhe obligimet e dala nga ajo kontratë dhe se nuk ka nevojë për lidhjen e një kontrate të re.

6. NDËRPRERJA E KONTRATËS PËR ARBITRAZHIN

Natyra juridike e kontratës për arbitrazhin tërheq pas vete pasoja të veçanta pas ndërprerjes së ekzistimit të saj. Ndërprerja e kontratës kryesore vetvetiu imponon edhe shuarjen e kontratës për arbitrazhin si pjesë përbërëse e saj. Shuarja e këtillë e kontratës për arbitrazhin automatikisht bie në kundërshtim me autonominë e kontratës për arbitrazhin. Ekzistojnë dy forma të ndërprerjes së kontratës për arbitrazhin e ato janë: e para, ndërprerja e kontratës për arbitrazhin e cila vjen si pasojë e ndërprerjes së kontratës kryesore dhe e dyta ka të bëjë me shuarjen e vetë kontratës për arbitrazhin.

a) Ndërprerja e kontratës kryesore. Kontrata kryesore pushon së ekzistuari me rastin e përmbushjes së saj në mënyrë të rregullt si dhe në rastet e kyçjes së risive në të me barazimin ndërmjet palëve dhe me anulimin si dhe shpëputjen e saj. Kyçja e risive apo elementeve të reja me pëlqimin e të dyja palëve kontraktuese shfuqizon të gjitha obligimet e mëparme të dala nga ajo marrëdhënie juridike dhe zëvendësohen më të drejta dhe obligime të reja të cilat dalin nga kontrata e renovuar. Të gjitha këto shkaqe të ndërprerjes së kontratës kryesore në parim vetvetiu do të çonin edhe tek ndërprerja e kontratës për arbitrazhin sepse tanimë nuk ekziston lënda për shqyrtim me të cilën do të merrej arbitrazhi.

b) Ndërprerja e kontratës për arbitrazhin. Ekzistojnë disa shkaqe për ndërprerjen e kontratës për arbitrazhin, e ato janë: nxjerrja e vendimit përfundimtar, meritore për kontestin, ndërprerja e funksionimit të arbitrazhit të përzgjedhur nga palët (pamundësia subsekvente), tërheqja e palëve nga kontrata, goditja e kontratës me sanksion anulimi etj.

6.1 KONTRATA PËR ARBITRAZHIN DHE NDËRPRERJA E SAJ SIPAS LEGJISLACIONIT TË SHQIPËRISË

Ligji i fundit i nxjerrë nga Kuvendi i Shqipërisë për arbitrazhin nr. 8812 i datës 17.05.2001, pos tjerash rregullon edhe marrëveshjen për arbitrazhin si dhe pavlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje apo kontrate. Në nenin 403 të kreut të parë të këtij ligji për marrëveshjen e arbitrazhit thuhet se; *“kontesti i dalë nga kontrata kryesore mund të gjykohet në procedurë arbitrazhi, vetëm nëse ekziston një marrëveshje e palëve (kontrata për arbitrazhin), përmes së cilës ato kanë pranuar që kontestin e shfaqur apo atë i cili mund të shfaqet në të ardhmen, t’ia parashtrojnë për zgjidhje arbitrazhit”*.⁷⁴ Neni në fjalë është mjaft i qartë dhe përmbajtësor rreth kontratës për arbitrazhin. Ndërsa rreth ndërprerjes apo siç thuhet pavlershmërisë së kontratës flitet në nenin 404 të këtij ligji për arbitrazhin ku thuhet se *“është i pavlefshëm kushti për gjykimin e kontestit me arbitrazh kur nuk pasqyrohet me shkrim në vetë marrëveshjen e palëve apo me ndonjë dokument tjetër të shkruar që i referohet asaj marrëveshjeje, siç janë: telegrami, teleksi apo ndonjë mjet tjetër i saktë që përmban provë shkresore”*.⁷⁵ Sipas nenit në fjalë marrëveshja e palëve për arbitrazhin është e pavlefshme nëse në të nuk parashihet mënyra e zgjedhjes së arbitrave si dhe caktimi apo identifikimi i kontestit për zgjidhje. Marrëveshja për arbitrazhin mund të shfuqizohet edhe nëse ndonjëri prej arbitrave të emëruar nuk pranon misionin e besuar për ta kryer atë. Me fjalë të tjera, ligji për arbitrazhin i Republikës së Shqipërisë duket mjaft përmbajtësor dhe i avancuar në krahasim me përvojën e paktë që posedon.

74 Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë neni 403 fq 148. Botim i qendrës së publikimeve zyrtare, Tiranë, Qershor, 2010.

75 Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë neni 404, fq. 148. Botim i qendrës së publikimeve zyrtare, Tiranë, Qershor, 2010.

6.2. KONTRATA PËR ARBITRAZHIN SIPAS LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS

Në ligjin e Kosovës për arbitrazhin⁷⁶, pos tjerash definohet edhe çështja e marrëveshjes apo kontratës për arbitrazhin. Në nenin 2 të kreut të parë të këtij ligji thuhet se, me marrëveshjen për arbitrazhin nënkuptohet se *“marrëveshja e arritur ndërmjet palëve që disa apo të gjitha kontestet juridike, të cilat janë shfaqur apo mund të shfaqen në të ardhmen nga kontrata e tyre kryesore do të zgjidhen me arbitrazh”*.⁷⁷ Ndërsa në nenin 5 të kreut të dytë thuhet se *“një mosmarrëveshje apo kontest mund të zgjidhet me arbitrazh, vetëm nëse ekziston marrëveshja apo kontrata e palëve për arbitrazhin”*. Gjithashtu në paragrafin e dytë të këtij neni thuhet se *“të gjitha kontestet që kanë të bëjnë me kërkesat civilo-juridike apo pronëso-ro-juridike mund t’i nënshtrohen arbitrazhit, përveç nëse kjo është e ndaluar me ligj”*.⁷⁸ Ky ligj pos tjerash vërehet se bën fjalë edhe për arbitrabilitetin e kontestit për zgjidhje pranë arbitrazhit. Po ashtu në nenin 6 të këtij ligji bëhet fjalë edhe për formën e shkruar të kontratës, por në njëfarë mënyre duke iu shmangur formalitetit rigoroz të saj ku thuhet se; *“marrëveshja për arbitrazhin duhet të lidhet në formën e shkruar”*.⁷⁹ ku në vijim theksohet se kontrata për arbitrazhin konsiderohet e lidhur edhe përmes mjeteve të komunikimit siç janë letrat, telegramet, teletekstet, bile edhe konosmanet, paditë dhe kundërpaditë të ushtruara nga ndonjëra prej palëve me të cilat dëshmohet se ka ekzistuar një marrëveshje për arbitrazhin nëse këtë pala tjetër nuk e mohon. Ligji i Kosovës për arbitrazhin në përmbajtjen e tij nuk parasheh asnjë rregull rreth ndërprerjes së kontratës për arbitrazhin.

76 Ligji për Arbitrazhin 02/L-75 i nxjerrë me datën 15.05.2001. Kuvendi i Kosovës.

77 Neni 2 i Ligjit për Arbitrazhin i aprovuar në Kuvendin e Kosovës, nr.02/L-75 i datës 15.05.2001.

78 Neni 5 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për Arbitrazhin i Kosovës, nr. 02/L-75.

79 Neni 6 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për Arbitrazhin i Kosovës, nr. 02/L-75.

KAPITULLI I PESTË

V. PROCEDURA DHE VENDIMET E ARBITRAZHIT

1. PROCEDURA E ARBITRAZHIT

Gjykata shtetërore kur i qaset ndonjë problemi për ta zgjidhur e ka më lehtë sepse ekzistojnë rregulla procedurale mbi të cilat ajo e mbështet veprimin e saj. Është rregull se pran gjykatave shtetërore gjithherë aplikohet e drejta procedurale e shtetit të gjykatës dhe se ky rregull kurrsesi nuk mund të anashkalohet.

Kur bëhet fjalë për arbitrazhin si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet palëve, situata është më ndryshe. Siç kemi theksuar më parë natyra juridike e vetë arbitrazhit është dualiste sepse në njërën anë arbitrazhi është krijesë e marrëveshjes së palëve të cilin ato e formojnë dhe e koncipojnë atë e në anë tjetër arbitrazhi ekziston dhe funksionon vetëm duke iu falënderuar ligjdhënësit sepse ligjdhënësi është ai i cili e lejon dhe ia përcakton kufijtë e veprimtarisë së tij. Pra ligjdhënësi është ai i cili përcakton fuqinë e vendimit të arbitrazhit, kufijtë e autonomisë së palëve si dhe raportet ndërmjet arbitrazhit dhe gjykatës shtetërore. Siç dihet arbitrazhi si gjyqësi private formalisht nuk është pjesë e ndonjë sistemi juridik nacional dhe se bazë për ta vënë në funksion atë është autonomia e vullnetit të palëve, andaj edhe është logjike që të thuhet se korniza procedurale brenda së cilës funksionon arbitrazhi dallon nga ajo e cila zhvillohet pranë gjykatave shtetërore. Prandaj në pyetjen se cila e drejtë procedurale aplikohet pranë gjykatës shtetërore përgjigjja është se e drejta procedurale vendore (lex fori), ndërsa në pyetjen se cila e drejtë procedurale aplikohet pranë arbitrazhit, përgjigjja do të ishte paksa më e komplikuar.

1.1. NOCIONI I TË DREJTËS KOMPETENTE NË PROCEDURËN E ARBITRAZHIT

Me nocionin “*e drejta procedurale*” kuptojmë përmbledhje rregullash, të cilat shërbejnë për organizimin e gjykatave apo arbitrazheve,

konstatimin e kompetencës së tyre, rregullimin e sjelljes së palëve dhe arbitrave gjatë shqyrtimit të çështjes, rregullimin e mënyrës së nxjerrjes së vendimit, rregullimin e caktimit të afateve si dhe çështje tjera, të cilat mund të shfaqen gjatë shqyrtimit të kontestit. Shkurt, me nocionin e drejta procedurale kuptojmë se bëhet fjalë për aso lloj normash juridike në bazë të të cilave themelohet kompetenca e gjyqit të arbitrazhit dhe konstatohet e vërteta rreth gjykimit të atij kontesti. E drejta procedurale ndryshe mund të quhet edhe e drejtë formale sepse përcakton formën në të cilën mund të shfaqen disa pjesë të së drejtës materiale si p.sh. shkresat e palëve, veprimet e caktuara të gjyqtarëve apo arbitrave etj. Forma apo procedura e aplikuar ka për qëllim ruajtjen e të drejtës së palëve si dhe ruajtjen e sinqeritetit dhe dinjitetit të gjyqtarëve apo arbitrave gjatë zhvillimit të procedurës.

Ndërmjet të drejtës procedurale dhe të drejtës materiale ekziston një lidhshmëri e pandërprerë duke i shërbyer njëra tjetrës. Por, ndikimi i të drejtës materiale është disi më i dukshëm në raport me të drejtën procedurale. Ndervartësia ndërmjet këtyre dy të drejtave ka për qëllim realizimin e funksionimit themelor të gjyqësisë shtetërore apo gjyqësisë private (arbitrazhit).

Si e drejta procedurale, po ashtu edhe ajo materiale më së miri u përshtatet gjykatave shtetërore si dhe arbitrazheve të brendshme sepse ato janë të rregulluara në harmoni me natyrën juridike të normave ligjore nacionale. Ndërsa arbitrazhi i tregtisë ndërkombëtare nuk e posedon një të drejtë procedurale të fiksuar dhe të aplikueshme, gjithashtu nuk e posedon edhe të drejtën materiale të përhershme. Prandaj, nuk mund të flitet për rregulla procedurale të arbitrazhit ndërkombëtar sepse aso lloj rregullash nuk ekzistojnë fare ose ekzistojnë pjesërisht te konventat ndërkombëtare si te ajo e Nju Jorkut po ashtu edhe te rregullat e UNCITRAL-arbitrazhit. Pra, arbitrazhi ndërkombëtar për çdo rast shërbehet me rregulla procedurale të marra nga burime të ndryshme juridike, si nga konventat ndërkombëtare, dokumentet e UNCITRAL arbitrazhit, rregulloret e arbitrazheve të tregtisë ndërkombëtare, praktikës gjyqësore etj.

1.2. AUTONOMIA E RREGULLAVE TË PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT

Kohëve të fundit ne teorinë e së drejtës së arbitrazhit përdoret shprehja “*autonomia e rregullave të procedurës së arbitrazhit*”. Rreth autonomisë së procedurës së arbitrazhit ekzistojnë tri lloj interpretimesh.

Sipas interpretimit të parë, me autonominë e rregullave procedurale nënkuptojmë lidhshmërinë e dispozitave proceduralo-juridike për vullnetin e shprehur të palëve në marrëveshjen e tyre për arbitrazhin për të nxjerrë një vendim për kontestin e shqyrtuar. Me interpretimin e dytë rreth autonomisë së rregullave të procedurës së arbitrazhit kuptojmë mëvetësinë e kësaj procedure në raport me dispozitat ligjore të procedurës, e cila zhvillohet pranë gjykatës shtetërore rreth zgjidhjes së ndonjë kontesti. Ndërsa, sipas interpretimit të tretë, autonomia e rregullave të procedurës së arbitrazhit ka të bëjë me lirinë e palëve dhe arbitrave të tyre nga çfarëdo kriteri për të vlerësuar rregullat e procedurës sipas masës së tyre. Shprehja autonomi rrjedh nga e drejta franceze (*autonomie du droit applicable a la procedure*), e cila bën fjalë për lirinë e vlerësimit të procedurës së arbitrazhit por pa ndonjë lidhshmëri automatike për ndonjë ligj nacional apo burim tjetër juridik.

a) Roli i palëve në përzgjedhjen e të drejtës procedurale. Palët në arbitrazh duhet të përcaktohen për të drejtën procedurale kompetente gjatë lidhjes së kontratës për arbitrazhin. Ashtu siç përcaktohen për të drejtën materiale kompetente. Pra, me rastin e përzgjedhjes të së drejtës procedurale palët mund të përcaktohen qoftë për ndonjë të drejtë procedurale nacionale apo për ndonjë prej rregulloreve të arbitrazhit institucional të tregtisë ndërkombëtare. e cila ne vete përmban edhe rregullat procedurale si p.sh rregullat e UNCITRAL arbitrazhit apo te ndonjë arbitrazhi tjetër me renome botërore. Rregulloret e arbitrazheve edhe pse janë mjaft të kompletuara ato prapëseprapë palëve u lejojnë që të përcaktohen rreth selisë së arbitrazhit dhe gjuhës, e cila do të përdoret pranë tij. Në fund, parimi rreth autonomisë së rregullave të procedurës palëve u lejon që ato të përcaktohen për ndonjë të drejtë procedurale nacionale, nëse ajo u përgjigjet specifikave të kontestit të tyre (të përcaktohen për ligjin e procedurës civile të ndonjë shteti) apo

kombinimin në mes të disa të drejtave procedurale siç ndodh me procedurën *lexmercatoria*.⁸⁰

b) Përcaktimi i të drejtës procedurale kompetente nga ana e arbitrave. Nëse rregullat procedurale për arsye të ndryshme nuk janë përzgjedhur nga vetë palët, atëherë ato i përzgjedhin arbitrat e tyre. Përzgjedhja e të drejtës procedurale është paksa më e lehtë se sa përzgjedhja e të drejtës materiale kompetente sepse për aktin e

80 Mbi të drejtën e palëve që të mendojnë apo konoceptojnë procedurën vetjake, shkruar B. Goldman, në artikullin *La valente des parties et le re de le arbitre dans l'arbitre international*. *Revue de l'arbitrage*, 1981, p. 474. Trajković M., *Međunarodno arbitražno pravo*, Beograd, 2000, fq. 452.

përzgjedhjes nuk ekzistojnë kritere, të cilave duhet përmbajtur patjetër si dhe nuk ekzistojnë norma kolizive të cilat duhet respektuar. Nëse arbitrave u mbetet përzgjedhja e të drejtës procedurale, atëherë ata janë të pavarur në këtë përzgjedhje. Ata mund të përcaktohen për rregullore të ndonjë arbitrazhi institucional, për të drejtën procedurale të selisë së arbitrazhit apo edhe të ndonjë shteti tjetër. Po ashtu arbitrat mund të përcaktohen edhe për rregulla të nxjerra nga konventat dhe burimet tjera juridike ndërkombëtare etj.

Nëse arbitrat përcaktohen për rregulla procedurale aplikimi i të cilave është i gabuar vendimi i nxjerrë sipas këtyre rregullave mund të anulohet. E nëse arbitrat do të përcaktoheshin për aplikimin e një të drejte procedurale tjetër nga ajo e selisë së arbitrazhit, atëherë shtrohet pyetja se si do të trajtohet vendimi i nxjerrë në këso rrethana. E drejta e arbitrazhit ndërkombëtar një aplikim të tillë e lejon, por Konventa e Nju Jorkut e vitit 1958 vendimin e nxjerrë në këso rrethana e trajton si vendim të arbitrazhit të huaj për shtetin e selisë së arbitrazhit, të cilit do t'i nevojitej njohja për t'u ekzekutuar edhe në shtetin ku është nxjerrë ai. Sipas parimit të autonomisë së rregullave procedurale, nëse palët janë përcaktuar për aplikimin e një të drejte kompetente materiale gjatë lidhjes së kontratës për arbitrazhin, ndërsa përzgjedhjen e të drejtës procedurale ka mbetur ta bëjnë arbitrat atëherë ata janë të lirë dhe mund të përcaktohen për aplikimin e ndonjë të drejte procedurale, e cila nuk vjen nga burimi i njëjtë juridik me të drejtën materiale kompetente. E drejta franceze njeh dy momente të përzgjedhjes së të drejtës procedurale nga arbitrat. Një grup autorësh mendojnë se përzgjedhja e të drejtës procedurale duhet të kryhet që në fillim sepse më lehtë do t'u jepej përgjigje të gjitha çështjeve që do të shfaqen gjatë zhvillimit të procedurës së arbitrazhit. Ndërsa grupi tjetër mendon se nuk është racionale që arbitrat në fillim të punës të lidhen për rregullat e procedurës së caktuar sepse pastaj do të jetë e vështirë për t'u dhënë përgjigje situatave specifike, të cilat mund të shfaqen.

Teoria e të drejtës së arbitrazhit duke u mbështetur në parimin e autonomisë së rregullave procedurale, palëve apo arbitrave të tyre për shkaqe praktike u garanton lirinë e përzgjedhjes së të drejtës procedurale për ta aplikuar atë nëse ajo u përgjigjet interesave të tyre. Pra, nëse arbitrave u përgjigjet më së miri marrja në pyetje e palëve apo dëshmitarëve sipas procedurës angleze, atëherë le ta përdorin atë procedurë e nëse nuk u përshtatet le të përcaktohen për ndonjë procedurë tjetër meqë praktika ua lejon këtë

1.3. BURIMET JURIDIKE RRETH AUTONOMISË SË PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT

Përcaktimi i palëve si për të drejtën procedurale po ashtu edhe për të drejtën materiale kompetente mbështetjen e gjejnë si në burimet juridike ndërkombëtare po ashtu edhe në burimet nacionale të së drejtës së arbitrazhit.

a) Burimet juridike ndërkombëtare. Rreth autonomisë së rregullave procedurale rol të rëndësishëm luan Konventa e Nju Jorkut e vitit 1958 ku theksohet se *“refuzimi i njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj mund të ndodhë edhe për arsye të pranisë së disa gabimeve procedurale, të cilat ndodhin gjatë përzgjedhjes apo aplikimit të gabuar të së drejtës procedurale kompetente”*.⁸¹ Sipas kësaj konvente, shkaqet për refuzimin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj janë pavlefshmëria e kontratës për arbitrazhin, pamundësia e palës për të prezantuar pikëpamjet e saj rreth rastit në shqyrtim, mosinformimi në mënyrë të rregullt për emërimin e arbitrave dhe përzgjedhjen e së drejtës procedurale kompetente. mospërputhja e vendimit me kontratën për arbitrazhin, anulimi i vendimit të arbitrazhit në bazë të ligjit të shtetit në territorin e të cilit është nxjerrë ai si dhe gabime tjera të kësaj natyre.

Me autonominë e rregullave procedurale merret edhe Konventa Evropiane e vitit 1961, ku thuhet se *“arbitrat mund të konfirmojnë vetë rregullat e procedurës”*.⁸² Pra kjo nënkupton se nëse palët nuk janë përcaktuar për rregullat procedurale, këtë mund ta bëjnë arbitrat e tyre.

Ligji model i UNCITRAL-it i cili u shërben si model shumë ligjeve nacionale për arbitrazhin lidhur me autonominë e rregullave procedurale thotë se *“palët sipas vullnetit të tyre dhe varësisht nga specifikat e kontestit mund të përcaktohen për rregullat procedurale të ndonjë arbitrazhi institucional, apo këtë përcaktim ua lënë arbitrave”*. Rregullat procedurale të përzgjedhura nga vetë palët apo arbitrat e tyre duhet të sigurojnë barazinë ndërmjet palëve, lirinë e palëve rreth përcaktimit të selisë së arbitrazhit, lirinë e përcaktimit të gjuhës, e cila do të përdoret në procedurë si dhe lirinë e angazhimit të ekspertëve etj.⁸³

81 Neni V i Konventës së Nju Jorkut. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 455.

82 Neni IV pika 2 dhe neni IV pika 4 (d). Konventa Evropiane. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 456.

83 Nenet 18.19.20.21.22.24 dhe 26 të ligjit-model të Uncitral-it. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 456.

Rregullat e UNCITRAL arbitrazhit duket të jenë më të avancuara lidhur me

autonominë e rregullave procedurale të aplikuara në punën e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare. Rregullat e Uncitral-arbitrazhit zakonisht u dedikohen ad-hoc arbitrazheve, por efikasiteti dhe prakticiteti i tyre i bën të pranuar edhe tek arbitrazhet institucionale të tregtisë ndërkombëtare. Aplikimi i rregullave të UNCITRAL arbitrazhit vjen në shprehje vetëm nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe (si p.sh rreth selisë së arbitrazhit, të drejtës kompetente, gjuhës etj).⁸⁴

Në kuadër të burimeve juridike ndërkombëtare për autonominë e rregullave procedurale bëjnë fjalë edhe rregulloret e disa arbitrazheve institucionale duke filluar që nga formimi i tribunalit, shqyrtimi i çështjes e deri te nxjerrja e vendimit final. Edhe në rregulloret e këtyre arbitrazheve parashihet se në mungesë të përcaktimit nga palët rregullat procedurale mund t'i përcaktojnë edhe vetë arbitrat duke u përcaktuar për ndonjë të drejtë procedurale.⁸⁵

b) Ligjet nacionale. Për autonominë e rregullave procedurale bëjnë fjalë edhe ligjet nacionale për arbitrazhin si, ligji francez, italian, zviceran, anglez, rus, gjerman, spanjoll etj. Disa prej këtyre ligjeve bëjnë fjalë për lirinë e palëve dhe arbitrave të tyre rreth përcaktimit të së drejtës procedurale kompetente e disa të tjera parashohin kufizime në këtë çështje duke precizuar se çfarë duhet të sigurojë një e drejtë e këtillë.

1. 4. NDIKIMI I SELISË SË ARBITRAZHIT NË PËRCAKTIMIN E TË DREJTËS PROCEDURALE

Në të kaluarën e drejta procedurale e shtetit të selisë së arbitrazhit me automatizëm aplikohet për zgjidhjen e kontestit në fjalë. Një praktikë e këtillë aplikohet në shtetet e të drejtës anglo-saksone (*quid indicion fonim elegit ius - përzgjedhja e forumit është edhe përzgjedhje e së drejtës*) kështu thoshin anglezët. Mirëpo, me kalimin e kohës një rregull e këtillë u braktis dhe dominoi parimi i autonomisë së rregullave procedurale ku në plan të parë vihej vullneti i palëve si rreth përzgjedhjes së selisë po ashtu edhe rreth përzgjedhjes së të drejtës procedurale. E drejta e autonomisë së palëve rreth përzgjedhjes së selisë dhe të drejtës procedurale mundësonte që arbitrazhi si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve të ngritet mbi rregullativën nacionale dhe kështu t'u

84 Nenet 15.16.17.33 etj. Rregullat e UNCITRAL-arbitrazhit. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 456.

85 Neni 15 I rregullores së I.C.C. arbitrazhit në Paris. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 457.

mundësohet palëve që të zgjedhin një të drejtë në mesin e shumë të drejtave për rregullimin e kontestit të tyre.

Braktisja e parimit të automatizmit dhe aplikimi i autonomisë së palëve në përzgjedhjen e selisë dhe procedurës së arbitrazhit nuk konsiderohet edhe si hap aq i qëlluar sepse përcaktimi i palëve për aplikimin e një të drejte procedurale tjetër nga ajo e selisë së arbitrazhit sepse vendimi i axjerrë në këso rrethana do të konsiderohet si vendim i arbitrazhit të huaj edhe për shtetin e selisë së arbitrazhit. Po ashtu edhe aplikimi i të drejtës procedurale tjetër nga ajo e shtetit të selisë së arbitrazhit, shtetin e selisë së arbitrazhit e liron nga obligimet të cilat duhej t'i ofronte arbitrazhit si masat e sigurisë së përkohshme po ashtu edhe ndihmat tjera. Pra, siç po vërehet braktisja e parimit të automatizmit dhe afirmimi i autonomisë së palëve për përzgjedhjen e selisë dhe të drejtës procedurale tjetër pas vete bart edhe rreziqe, të cilat u cekën më parë. Për t'iu shmangur rreziqeve të përmendura palëve u rekomandohet që me rastin e përcaktimit të së drejtës procedurale kompetente të përcaktohen për ndonjë të drejtë që vjen nga burimet ndërkombëtare e jo për ndonjë të drejtë të huaj nacionale sepse e drejta e përzgjedhur nga burimet ndërkombëtare do të denacionalizonte apo do të deterritorializonte arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare.

Rreth. shkëputjes nga parimii autorizimit të aplikimit të së drejtës procedurale të shtetit të selisë së arbitrazhit kontribuan edhe konventat ndërkombëtare si: Protokolli i Gjenevës (1923), Konventa e Gjenevës (1927), Konventa e Nju Jorkut (1958) si dhe Konventa Evropiane (1961 por në njëfarë mënyre duke e ruajtur edhe parimin e automatizmitp.sh. në Konventën e Nju Jorkut thuhet se refuzimi i njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj ndodh nëse procedura pranë arbitrazhit nuk është zhvilluar në përputhje me të drejtën procedurale të shtetit të selisë së arbitrazhit.⁸⁶

Përkrahsit e teorisë për aplikimin e të drejtës procedurale dhe materiale me

automatizëm të shtetit të selisë së arbitrazhit thonë se një sistem juridik si gjykatën po ashtu edhe arbitrazhin mund t'i mbajë nën kontroll vetëm përmes selisë së tyre.

86 Neni V.1.d i Konventës së Nju Jorkut. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 461.

1.5. PËRKUEIZIMET, KARAKTERISTIKAT DHE PARIMET E PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT

- **Përkufizimet e procedurës së arbitrazhit.** Rreth procedurës së arbitrazhit ekzistojnë përkufizime të ndryshme, por formulimi më i plotë duket të jetë ky në të cilin thuhet se me procedurën e arbitrazhit kuptojmë "përmbledhje rregullash me të cilat rregullohet sjellja e palëve dhe arbitrave të tyre që nga momenti i parashtrimit të padisë e gjer tek nxjerrja e vendimit përfundimtar për kontestin e caktuar". Procedura e arbitrazhit vështrohet në dy koncepte: konceptin e gjerë dhe në konceptin e ngushtë. Sipas konceptit të gjerë procedura e arbitrazhit zhvillohet në tri faza e ato janë: faza e ngritjes së padisë, faza e shqyrtimit kryesor të çështjes dhe faza e nxjerrjes së vendimit përfundimtar për kontestin. Ndërsa koncepti i ngushtë përmban vetëm dy faza dhe atë fazën e parashtrimit të padisë dhe fazën e shqyrtimit kryesor të çështjes, e cila përmbledh në vete edhe vendimin përfundimtar, kurse veprimet tjera si, anulimi, njohja dhe ekzekutimi i vendimit janë aktivitete shtesë dhe i përkasin procedurës gjyqësore e jo arbitrazhit. Pra, duket qartë se koncepti i parë sqaron më mirë tërësinë e veprimtarisë së arbitrazhit rreth zgjidhjes së një kontesti i cili më vonë ose do të pranohet ose do të kontestohet.

- **Karakteristikat e procedurës së arbitrazhit.** Procedura e arbitrazhit posedon dy karakteristika e ato janë: lidhmëria për shprehjen e lirë të vullnetit të palëve dhe arbitrave të tyre dhe efikasiteti dhe joformaliteti i procedurës. Këto dy karakteristika janë të pranishme tek procedurat e të gjitha llojeve të arbitrazhit. Karakteristika e parë e procedurës, pra lidhshmëria për shprehjen e lirë të vullnetit të palëve apo arbitrave të tyre vjen si rrjedhojë e autonomisë dhe karakterit privat të arbitrazhit, ndërsa karakteristika e dytë e procedurës, joformaliteti dhe efikasiteti e bëjnë arbitrazhin specifik duke i dhënë përparësi në raport me gjykatën

- **Parimet themelore të procedurës së arbitrazhit.** Procedura e arbitrazhit vepron mbi këto parime si, trajtimi i barabartë i palëve gjatë zhvillimit të procedurës, mosshqyrtimi i çështjeve të cilat nuk janë arbitrabile apo janë në kundërshtim me rendin publik të shtetit të selisë së arbitrazhit, ruajtja e fshehtësisë së procedurës, e cila mund të publikohet vetëm me pëlqimin e palëve si dhe efikasiteti dhe joformaliteti i procedurës, të cilat edhe ndikojnë në koston e ulët të shpenzimeve për zgjidhjen e kontestit të caktuar. Ndërsa tubimi i dëshmimeve dhe fakteve nuk dallon nga procedura e zhvilluar pranë gjykatës përpos asaj se

arbitrat shfrytëzojnë burimet juridike nacionale dhe ndërkombëtare ndërsa gjyqtarët shfrytëzojnë vetëm ato nacionale. Po ashtu tribunali pos ofrimit të fakteve nga palët ai edhe vetë mund t'i hulumtojë, hetojë dhe vlerësojë ato. Tribunali i arbitrazhit me lutje mund t'i drejtohet gjykatës së huaj për marrjen në pyetje të dëshmitarit i cili posedon shtetësinë e asaj gjykate. Pra këto ishin disa prej parimeve të procedurës të cilat arbitrazhit i japin vendin e merituar dhe përparësinë në raport me gjykatën.

- **Shqiptimi i masave të përkohshme të sigurisë.** Njëra prej specifikave të arbitrazhit është edhe shqiptimi i masave të përkohshme të sigurisë nga ky mekanizëm. Në raste të caktuara dhe sipas nevojës masat i shqipton tribunali i arbitrazhit në bashkëpunim me gjykatën kompetente dhe i realizon ato. Masat e përkohshme të sigurisë, arbitrazhi i shqipton me arsyetimin e mbrojtjes së interesit të palëve, ruajtjen e fakteve të cilat shërbejnë për konstatimin e së vërtetës për çështjen si dhe ruajtjen e kushteve për zbatimin e mëvonshëm të vendimit të arbitrazhit etj.

Si konventat ndërkombëtare po ashtu edhe ligjet nacionale për arbitrazhin shqiptimin e masave të përkohshme të sigurisë si te arbitrazhi po ashtu edhe te gjykata nuk konsiderojnë se ato bien në kundërshtim me kontratën për arbitrazhin. Të njëjtin qëndrim rreth shqiptimit të masave të sigurisë e mbajnë edhe rregulloret e arbitrazheve institucionale.

1.6. PROCEDURA E ARBITRAZHIT SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1.6.1. PROCEDURA E ARBITRAZHIT SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Me braktisjen e rendit socialist Republika e Shqipërisë orientohet drejtë organizimit të rendit shoqëror demokratik dhe ekonomisë së tregut. Në këtë fazë transicioni pos transformimit të institucioneve shtetërore u transformua edhe institucioni i arbitrazhit, prej një arbitrazhi shtetëror si pjesë e administratës në një arbitrazh autonom dhe sipas standardeve ndërkombëtare. Është me interes të dimë mënyrën e organizimit të arbitrazhit në rrethanat e demokracisë shqiptare. Legjislatura e Republikës së Shqipërisë ligjin e fundit për arbitrazhin nr. 8812 e nxori më 17.05.2001. Në këtë ligj pos tjerash trajtohet edhe procedura për arbitrazhin ku thuhet se në procedurën e arbitrazhit për të zgjidhur kontestin e tyre mund të paraqiten si palë të gjithë ata persona, të cilët vendbanimin e tyre e kanë në Republikën e Shqipërisë si dhe procedura të

zhvillohet brenda territorit të shtetit shqiptar.⁸⁷ Sipas kësaj dispozite del se ligji në fjalë shërben për organizimin e arbitrazhit të brendshëm, kurse neni 439 i po këtij ligji parasheh se arbitrazhi ndërkombëtar do të rregullohet me ligj të veçantë në një të ardhme të afërt. Në ligjin e Shqipërisë rreth procedurës së arbitrazhit flitet në kapitullin e tretë, më saktësisht prej nenit 415 e gjer tek neni 427. Në këtë ligj parashihet se procedura e arbitrazhit fillon që nga momenti i konstituimit të tribunalit. Përzgjedhjen e procedurës kompetente e bëjnë vetë palët e në mungesë të tyre atëherë përzgjedhja u mbetet arbitrave. Në nenin 417 të këtij ligji thuhet se tribunali i arbitrazhit mund të vendosë edhe për kompetencën e tij si dhe për vlefshmërinë e kontratës për arbitrazhin.

Gjykata e arbitrazhit palëve në procedurë u siguron prezantimin e provave dhe fakteve të nevojshme, të cilat ndihmojnë në zgjidhjen objektive të kontestit. Po ashtu, gjykata e arbitrazhit sipas ligjit shqiptar mund të angazhohet edhe vetë në tubimin e provave dhe fakteve si dhe për tubimin e tyre mund t'i drejtohet edhe gjykatës kompetente. Në nenin 422 të këtij ligji thuhet se procedura pranë arbitrazhit mund të zhvillohet edhe në mungesë të ndonjëres prej palëve në kontest. Procedura përfundon pas mbledhjes së fakteve dhe provave, mbyllet së hetimit dhe mbajtjes së seancës së fundit ku edhe nxirret vendimi përfundimtar për kontestin (neni 427) dhe krejt në fund në nenin 427 të këtij ligji thuhet se ligj i zbatueshëm për gjykatën e arbitrazhit në Shqipëri është ai i legjislaturës shqiptare.

1.6.2. PROCEDURA E ARBITRAZHIT SIPAS LIGJIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kosova me statusin e Krahinës Autonome në kuadër të ish-Jugosllavisë së atëhershme deri në vitin 1974 nuk gëzonte të drejtën e themelimit dhe zhvillimit të arbitrazhit, sepse kjo e drejtë ishte e rezervuar vetëm për republikat dhe federatën e atëhershme jugosllave. Me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë të gjitha republikat u shndërruan në shtete të pavarura dhe sovraane. Kosovës, për t'u pavarësuar nga Serbia, pas një lufte të përgjakshme iu desh që të futet nën protektoratin ndërkombëtar. Gjatë periudhës së protektoratit në Kosovë u inaugurua një qeverisje e përkohshme e përbërë nga tri pushtete, pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe ai gjyqësor. Bashkë me konsolidimin e institucioneve filloi

87 Neni 400 i ligjit për arbitrazhin nr. 8812 i datës 17.05.2001. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë. Botimi i Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Tiranë, Qershor, 2010.

edhe organizimi i jetës ekonomike, por jo më në bazë të ekonomisë së planifikuar por në baza të një ekonomie të lirë apo ekonomisë së tregut. Përkrah zhvillimit të një ekonomie të tillë shfaqen edhe probleme, të cilat kërkojnë zgjidhje urgjente. Për zgjidhjen urgjente të këtyre problemeve Kuvendi i Qeverisjes së Përkohshme të Kosovës e pa të nevojshme për të nxjerrë ligjin për arbitrazhin, i cili konsiderohet ligji i parë i kësaj nat. re pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Duke u mbështetur në kornizën e atëhershme kushtetuese (kreu 5.1.ç dhe 9.1.26.a) si dhe në rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001 9 me datën 09.05.2001 Kuvendi i Kosovës nxori ligjin për arbitrazhin nr. 02/I /75. Në këtë ligj pos tjerash bëhet fjalë edhe për procedurën e arbitrazhit dhe atë prej nenit 16 e deri tek neni 28 të kreut të V. Sipas dispozitave të këtij ligji procedurën e zgjedhin vetë palët e në mungesë të përzgjedhjes së palëve procedurën e përzgjedh tribunali. Dispozitat e këtij ligji parashohin trajtimin e barabartë të palëve duke ua mundësuar lirshëm prezantimin e kërkesave të tyre rreth kontestit në fjalë. Vendin apo selinë e arbitrazhit sipas dispozitave të këtij ligji e përzgjedhin vetë palët e në mungesë të marrëveshjes së tyre e cakton tribunali i arbitrazhit. Nëse palët nuk janë marrë vesh rreth gjuhës e cila do të përdoret gjatë procedurës, atëherë këtë e cakton vetë tribunali. Po ashtu dispozitat e këtij ligji rregullojnë edhe çështjen e afateve nëse për këtë palët nuk janë marrë vesh. Ligji u mundëson palëve në kontest që padinë, kundërpadinë apo përgjigjen në padi ta ndryshojnë apo plotësojnë atë përveç nëse tribunali konstaton se ai ndryshim dhe plotësim nuk është i lejuar.

Sipas dispozitave të këtij ligji palët duhet të jenë mirë të informuara rreth ecures së procedurës pranë arbitrazhit po ashtu dispozitat e këtij ligji për arbitrazhin mundësojnë që palët të vendosin se seancat të jenë të hapura apo të mbyllura për publikun. Nga kjo kuptohet se pikërisht janë palët ato të cilat në duart e tyre kanë përzgjedhjen e procedurës së arbitrazhit.

Tribunali i arbitrazhit gjatë shqyrtimit të çështjes mbanë proces-verbal dhe siguron përkthimin e dokumenteve të nevojshme. Me përfundimin e prezantimit të provave dhe fakteve, dëgjimin e palëve si dhe veprimet tjera, tribunali e mbyll seancën dëgjimore. Seanca e mbyllur rihapet vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe me kërkesën e ndonjëres prej palëve. Provat sipas këtij ligji për arbitrazhin i prezantojnë vetë palët ndërsa tribunali i verifikon dhe i vlerëson ato. Tribunali mund të angazhohet edhe vetë në mbledhjen e provave apo të kërkojë prova shtesë nga palët. Dispozitat e këtij ligji parashohin edhe dëgjimin dëshmitarëve të cilët dëshmitë e tyre mund t' i ofrojnë me gojë ose me shkrim.

Tribunali për çështjen në shqyrtim mund të caktojë edhe ekspertë e nëse ndonjëra prej palëve nuk pajtohet me mendimin e atij eksperti, ajo mund ta angazhojë ekspertin e saj. Sipas rregullave të procedurës së këtij ligji nëse paditësi nuk e ngrit padinë në afatin e caktuar pa ndonjë arsye, procedura mbyllet. Nëse i padituri brenda afatit të paraparë nuk e kundërshton padinë e parashtruar nga paditësi, procedura vazhdon. Procedura e arbitrazhit fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë nga pala e caktuar. Këto ishin disa prej karakteristikave të procedurës sipas ligjit për arbitrazhin të Republikës së Kosovës, çka vërehet qartë se janë mjaft të përafërta me procedurat e ligjeve për arbitrazhin të shteteve tjera.

II. VENDIMET E ARBITRAZHIT

2.1. NOCIONI DHE PËRKUFIZIMI I VENDINEVE TË ARBITRAZHIT

Për të formuluar një përkufizim përmbajtësor dhe unik rreth nocionit të vendimit të arbitrazhit është çështje bukur e vështirë. sepse shumica e burimeve juridike si e atyre nacionale po ashtu edhe e atyre ndërkombëtare për arbitrazhin disi janë të përmbajtura në kualifikimin dhe definimin e rezultateve të këshillimit të arbitrave ku do të përfshiheshin të gjitha çështjet apo ato më të rëndësishmet në një vendim të nxjerrë nga tribunali i arbitrazhit. Megjithatë me nxjerrjen e vendimit kuptohet përfundimi i procedurës si dhe shpallja e rezultatit përfundimtar të punës së tribunalit apo arbitrit të vetëm për lëndën e shqyrtuar. Mendoj se në njëfarë mënyre do të ishte nocioni më i përafërt rreth përkufizimit të vendimit të arbitrazhit.

Siç u cek më parë se është e pamundur që të gjitha çështjet apo ato më të rëndësishmet të përfshihen me një vendim të vetëm, atëherë për ta përmbushur këtë detyrë arbitrazhi detyrohet që pos vendimit përfundimtar të nxjerrë edhe vendime tjera. Në vijim do të bëhet fjalë për llojet, formën dhe përmbajtjen pastaj efektet, procedurën dhe afatet e nxjerrjes së vendimeve, si të arbitrazhit të brendshëm po ashtu edhe të atij ndërkombëtar.

2.2. LLOJET E VENDIMEVE TË ARBITRAZHIT

Fillimisht vendimet e arbitrazhit ndahen në dy grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë të gjitha ato vendime. të cilat kanë të bëjnë me drejtimin

e rrjedhve të procedurës, ndërsa grupit të dytë i përket vendimi përfundimtar. i cili ka të bëjë me zgjidhjen e kontestit në fjalë.

2.3. VENDIMET E ARBITRAZHIT TË NXJERRA GJATË ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS

Për mbarëvajtjen e procedurës gjatë shqyrtimit të çështjes si dhe për ta nxjerrë një vendim përfundimtar sa më objektiv. Arbitrazhi gjatë zhvillimit të procedurës e sipas nevojës mund të nxjerrë vendime të ndryshme si: a) vendime preliminare dhe mesovendime, b) vendime të pjesshme, c) vendime në rast të mungesës së ndonjërës nga palët dhe ç) vendime në bazë të barazimit të palëve.

a) Vendimet preliminare dhe mesovendimet. Vendim preliminar (internim or preliminar i avard) quhet ai vendim, të cilin arbitrat e nxjerrin para apo gjatë zhvillimit të procedurës. Vendimi preliminar me të cilin zgjidhet një pjesë e kontestit ndihmon dhe lehtëson punën në nxjerrjen e vendimit përfundimtar.

Mesovendimet (interlokutari avard) janë aso lloj vendimesh, të cilat tribunali i arbitrazhit i nxjerr sipas modelit të mesovendimeve gjyqësore dhe shërbejnë për të konstatuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë e jo lartësinë e saj. Pala të cilës i shqiptohet mesovendimi mund të kuptojë se pozita e saj në procedurë është tejte e dobët dhe se rrugëdalja e saj nga kjo situatë është gjetja e një kompromisi me palën tjetër. Mesovendimet zakonisht i nxjerr arbitrazhi dyshkallësh.

Rregullat e Uncitral arbitrazhit vendimet preliminare dhe mesovendimet i barazojnë me tyre.⁸⁸ Mesovendimi palëve u shërben si udhërrëfyes për sjelljet e tyre të mëtejme në raport me kontestin si dhe u qartëson atyre se cili do të jetë vendimi përfundimtar.

b) Vendimet e pjesshme. Vendim i pjesshëm (sentence partiale apo avard partial) quhet ai me të cilin zgjidhet ndonjëra prej pjesëve të kontestit të shtruar për zgjidhje. Vendimi i pjesshëm i paraprin nxjerrjes së vendimit përfundimtar edhe pse konsiderohet si vendim i veçantë. Nxjerrja e vendimit të pjesshëm është në kompetencën dhe vlerësimin e arbitrave.

Disa të drejta nacionale si ajo zvicerane në mënyrë decitive autorizon arbitrat për nxjerrjen e vendimit të pjesshëm nëse palët nuk

88 Neni 32 i rregullave të UNCITRAL – arbitrazhit. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 491.

janë marrë vesh ndryshe.⁸⁹ Ngjashëm me ligjin zviceran veprojnë edhe ligji holandez dhe ai anglez për arbitrazhin. Ndërsa ligji francez fare nuk bën fjalë për vendimin e pjesshëm të arbitrazhit.

Në anën tjetër praktika dëshmon se vendimi i pjesshëm nuk mund të nxirret te çdo kontest, por vetëm te ato konteste të cilat janë juridikisht të ndashme" pra ato të cilat konsiderohen si tërësi në vete dhe janë të përshtatshme për t'u zgjidhur me vendime të këtilla. Vendimet e pjesshme zakonisht nxirren para vendimit përfundimtar.⁹⁰

c) Vendimi i nxjerrë me rastin e mungesës së ndonjërës prej palëve në procedurë (*sentence par de fault ose de fault avarde*). Mungesa e ndonjërës nga palët gjatë zhvillimit të procedurës nuk e pengon tribunalin e arbitrazhit për të nxjerrë vendimin. Për nxjerrjen e një vendimi të këtillë tribunali motivohet nga arsyeja që palës tjetër të mos i pengohet e drejta e realizimit të interesave të saj. Rregullat e arbitrazhit nuk janë deklaruar rreth çështjes së mungesës së ndonjërës nga palët në procedurë por sipas praktikës së arbitrazhit mospjesëmarrja në procedurë dhe mospërgjigjja në padi brenda afatit të paraparë konsiderohen si mosrespektim për shqyrtimin e lëndës.⁹¹

ç) Vendimet e nxjerra në bazë të barazimit të palëve. Tribunali i arbitrazhit mund të nxjerrë edhe vendimin duke u bazuar në barazimin apo marrëveshjen e palëve (*sentence d'accor apo sentenc avarde*). Ky lloj vendimi nxirret atëherë kur palët gjatë zhvillimit të procedurës arrijnë marrëveshjen për t'u barazuar para se tribunali të nxjerrë vendimin përfundimtar për kontestin. Vendimi i nxjerrë në bazë të barazimit të palëve mund të formësohet nga tribunali në vendim përfundimtar me të gjitha karakteristikat e tij, por ky lloj vendimi dallon nga vendimi përfundimtar i tribunalit se në dispozitivin e tij shënohet marrëveshja e palëve për barazim e jo dispozitat e të drejtës materiale kompetente në bazë të së cilave do të ishte zgjidhur ai kontest. Palët në kontest marrëveshjen për barazim mund ta arrijnë edhe jashtë procedurës së arbitrazhit por një marrëveshje e këtillë nuk posedon karakteristikat e

89 Neni 188 i Ligjit zviceran për arbitrazhin. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 489.

90 Sipas Glosnerit në praktikën e arbitrazhit gjerman vendimi i pjesshëm mund të jetë i ekzekutueshëm njësoj si edhe vendimi përfundimtar. Glosner, Feaeral Republic of Germany LCCA, Internationale Handbeoc on Commercial Arbitration, e cituar te A. Redfern fq. 380. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 490.

91 Kështu thuhet në nenin 21.1 të rregullores së UNCITRAL arbitrazhit, në nenin 23. të rregullores së institutit të arbitrazhit pranë Odës Tregtare në Stokholm dhe në nenin 21.1 të rregullores së ICC arbitrazhit në Paris. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 492.

vendimit përfundimtar të arbitrazhit. Vendimi i nxjerrë në bazë të barazimit dhe i formësuar nga tribunali gëzon të drejtën e njohjes dhe ekzekutimit njësoj si edhe vendimet tjera përfundimtare të arbitrazhit. Ky lloj vendimi duhet të jetë patjetër i nënshkruar si nga vetë palët po ashtu edhe nga të gjithë arbitrat e atij tribunali, sepse në të kundërtën do të konsiderohet si marrëveshje privato-juridike.

Vendimi i nxjerrë në bazë të barazimit të palëve konsiderohet më racional dhe më pak i kushtueshëm, prandaj pos ligjeve nacionale atë e favorizojnë edhe rregulloret e arbitrazheve institucionale të tregtisë ndërkombëtare. Kështu ligji model i Uncitral-it dhe rregullat e Uncitral arbitrazhit gjithnjë stimulojnë marrëveshjen e palëve për barazim gjatë procedurës së arbitrazhit.⁹² ndërsa Konventa e Nju Jorkut edhe pse më herët nuk e njihte këtë lloj vendimi kohëve të fundit atë e trajton njësoj si edhe vendimet tjera të arbitrazhit të huaj nëse ai është i formësuar nga tribunali i arbitrazhit. Tribunali e refuzon legalizimin e vendimit të nxjerrë në bazë të barazimit të palëve nëse konstaton se me atë vendim është arritur ndonjë efekt i kundërligjshëm.⁹³

2.4. VENDIMI PËRFUNDIMTARË I ARBITRAZHIT

Grupit të dytë të vendimeve i përket vendimi përfundimtar i arbitrazhit. Me termin “vendim përfundimtar (sentence definitive apo final avard) kuptojmë se fjala është për vendimin e nxjerrë nga arbitrat si rezultat i dalë nga shqyrtimi i lëndës në kontest”. Sipas fjalorit proceduralo-juridik me vendimin përfundimtar vendoset si për bazueshmërinë po ashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë. Vendimi përfundimtar i arbitrazhit duhet t’u japë zgjidhje të gjitha çështjeve kontestuese, të cilat burojnë nga ajo marrëdhënie kontraktuese ndërmjet palëve sepse për këtë qëllim edhe ishte konstituuar tribunali i arbitrazhit. Me nxjerrjen e vendimit përfundimtar në parim përfundon si ekzistimi i mëtejshëm i kontestit po ashtu edhe misioni i arbitrave, kështu parashihet edhe në ligjin model të UNCITRALIT ku thuhet se; “me nxjerrjen e vendimit përfundimtarë përfundon edhe procedura e arbitrazhit”.⁹⁴ Pra vendim

92 Neni 30 i Ligjit model të UNCITRAL-it dhe neni 34.1 i rregullave të UNCITRAL-arbitrazhit Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 494.

93 Shih. Graig and others. Anotakd Gui de to the 1998. ICC Arbitration on Rules eith Commentari, Ocean Publication, fq. 149. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 495.

94 Neni 32.1 i ligjit model të UNCITRAL-it. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 487.

përfundimtar quhet akti i cili deklarohet për të gjitha çështjet kontestuese dhe merret qëndrimin për thelbin e kontestit në fjalë. Ky ndoshta do të ishte përkufizimi më i përafërt si për vendimin përfundimtar të arbitrazhit nacional po ashtu edhe të atij ndërkombëtar. Karakteristikë kryesore e vendimit është “obligimi” i palëve që ta respektojnë atë, ndërsa termi “përfundimtar” nënkupton mohimin e dyshkallshmërisë dhe pamundësinë e ushtrimit të ankesës kundër atij vendimi. Prandaj me termin përfundimtarë’ nënkuptohet edhe gatishmëria e palëve për ta pranuar dhe zbatuar atë vendim në përpikmëri.⁹⁵

Vendimet e arbitrazhit njësoj sikurse edhe aktgjykimet e gjykatave mund të jenë vendime (kondemnatore) që urdhërojnë plotësimin e kërkesës së paditësit apo kundërshtimin e tij dhe vendime deklarative apo transformuese, varësisht nga ajo se konstatojnë ekzistimin e ndonjë marrëdhënieje juridike apo imponojnë ndryshime në atë marrëdhënie juridike ekzistuese ndërmjet palëve.

2.5. FORMA DHE PËRMBAJTJA E VENDISIT TË ARBITRAZHIT

2.5.1. FORMA E VENDIMIT TË ARBITRAZHIT

Vendimi i arbitrazhit si akt përfundimtar pos tjerash duhet të posedojë edhe formën e tij. Në rast të mungesës së formës vendimi në fjalë nuk do të mund të prodhonte efekte juridike si dhe nuk do të mund të ekzekutohej dhunshëm në rast nevojë. Po ashtu mungesa e formës vendimin do ta çonte drejt anulimit në territorin e shtetit ku është nxjerrë si dhe do të mund t’i refuzohej njohja dhe ekzekutimi në shtetin tjetër.

Kufijtë brenda të cilëve përcaktohet forma e vendimit janë: kontrata për arbitrazhin dhe e drejta procedurale kompetente e përzgjedhur nga vetë palët apo arbitrat e tyre. Formën duhet ta posedojë si vendimi i arbitrazhit të brendshëm po ashtu edhe ai i arbitrazhit ndërkombëtar. Sipas rregullave të UNCITRAL arbitrazhit vendimi duhet të jetë i shkruar, i arsyetuar, i nënshkruar nga të gjithë arbitrat si dhe duhet të përmbajë datën dhe vendin e nxjerrjes së tij.⁹⁶ Rregulla të ngjashme rreth

95 S. Trivo. A Goldštajn, vepra e cituar fq. 328, formulim më tipik të vendimit përfundimtarë e gjejmë në rregulloren e ICC Arbitrazhit në Paris, ku në nenin 6 thuhet se “palët obligohen që pa zvarritje do ta zbatojnë atë vendim si dhe konsiderohet se ato janë tërhequr nga e drejta e çfarëdo forme të ushtrimit të ankesës. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 488;

96 Neni 32 i rregullave të UNCITRAL-arbitrazhit. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 497.

formës së vendimit me ato të UNCITRAL arbitrazhit permban edhe rregullorja e qendrës së arbitrazhit për zgjidhjen e kontesteve investimore ndërmjet shtetit dhe shtetasit të shtetit tjetër (neni 17) e nxjerrë në Uashington. Forma e vendimit të arbitrazhit mund të rregullohet sipas sistemit juridik kontinental dhe sistemit juridik anglo-sakson. Sipas sistemit juridik kontinental elementet e formës së vendimit konsiderohen të domosdoshme si për vendimin nacional po ashtu edhe për vendimin e arbitrazhit. Ndërsa sistemi juridik anglo-sakson formës së vendimit i kushton pak rëndësi. Ekzistojnë të dhëna se e drejta angleze për arbitrazhin pos formës së shkruar ka aplikuar edhe formën gojore (verbale) të vendimit por me kushtin që palëve ky lloj vendimi t’u komunikohet menjëherë.⁹⁷ Me kalimin e kohës dallimi rreth formës së vendimit ndërmjet sistemit juridik kontinental dhe atij anglo-sakson gati është eliminuar në favor të sistemit juridik kontinental.

2.5.2. PËRMIBAJTJA E VENDIMIT

Për të qenë i plotëfuqishëm përveç formës vendimi i arbitrazhit duhet të posedojë edhe përmbajtjen e tij. Si forma poashtu edhe përmbajtja e vendimit janë të varura drejtpërdrejt nga kontrata për arbitrazhin si dhe nga e drejta procedurale kompetente e përzgjedhur nga vetë palët. Elementet kryesore që duhet t’i përmbajë vendimi janë: dispozitivi dhe arsyetimi.

a) Dispozitivi apo masa e shqiptuar - konsiderohet pjesa më e rëndësishme e vendimeve në përgjithësi, kjo vlen edhe për vendimin e arbitrazhit. Dispozitivi i vendimit të arbitrazhit në vete përmban thelbin e qëndrimit të arbitrave rreth çështjes së zgjidhur. Në dispozitivin e vendimit përcaktohen obligimet e palëve si dhe përmbushja e tyre në mënyrë vullnetare nëse palët nuk dëshirojnë të përballen me ekzekutiv të dhunshëm. Dispozitivi i vendimit duhet të jetë i saktë, i qartë dhe të mos lejojë hapësirë për interpretim sipas dëshirës dhe interesit të palëve. Dispozitivi i vendimit nuk guxon të jetë i kundërligjshëm apo palëve t’u urdhërojë diçka që është në kundërshtim me normat imperative të rendit publik, nacional apo ndërkombëtarë.

b) Arsyetimi i vendimit (motivation reasoning) është elementi tjetër të cilin duhet ta posedojë vendimi i arbitrazhit. Përmes arsyetimit arbitrat sqarojnë dhe argumentojnë qëndrimin e tyre me rastin e nxjerrjes së dispozitivit të vendimit në fjalë.

97 A. Redfern, M. Hunter, vepra e cituar fq. 386. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 497.

Arsyetimi i vendimit duhet të përmbajë kërkesat e palëve, kronologjinë e kontestit, prezantimin e fakteve të parashtruara si nga palët po ashtu edhe nga dëshmitarët dhe ekspertët si dhe përshkrimin e rregullave dhe shkaqeve në bazë të të cilave është nxjerrë dispozitivi i atij vendimi. Për sa i përket përpilimit të arsyetimit të vendimit nuk ekziston ndonjë standard të cilit duhet përmbajtur. Më thelbësorja është se arsyetimi duhet të qartësojë dispozitivin e vendimit dhe palëve t'u prezantojë argumentet për qëndrimin e marrë të arbitrave. Arsyetimi mund të jetë bindës, më pak bindës dhe fare jobindës. Arsyetimin e vendimit disa ligje nacionale për arbitrazhin si ai francez fare nuk e trajtojnë si pjesë të vendimit. Ndërsa disa ligje tjera, si ai zviceran dhe rus u kërkojnë arbitrave që të arsyetojnë vendimin e nxjerrë.⁹⁸

Po ashtu edhe ligji model i Uncitralit si burim juridik ndërkombëtar, i cili u shërben si model shumë ligjeve nacionale për arbitrazhin parasheh se vendimi i arbitrazhit duhet të jetë i arsyetuar përveç nëse palët janë marrë vesh ndryshe.⁹⁹ Kohëve të fundit dominon qëndrimi se vendimi duhet të jetë i arsyetuar.

2.6. EFEKTET JURIDIKE TË VENDIMIT TË ARBITRAZHIT

Vendimi i arbitrazhit që nga momenti i nxjerrjes shkëputet nga arbitrazhi dhe fillon rrugëtimin e tij te pavarur. Vendimi i nxjerrë menjëherë fillon t'i prodhojë efektet e tij juridike si ndaj palëve të cilat e përmbyllën kontestin po ashtu edhe ndaj arbitrave, të cilët përfunduan misionin e tyre por gjithashtu edhe ndaj organeve, të cilave u kërkohej njohja dhe ekzekutimi i tij. Secila prej këtyre efekteve gjen vendin e vet në të drejtën e arbitrazhit. Në vijim do të bëhet fjalë rreth efekteve të vendimit si ai "res iudicata - çështje e gjykuar" po ashtu edhe efekti tjetër "inter partes - veprimi ndërmjet palëve pjesëmarrësve në kontest".

a) Res iudicata apo çështja eështë efekti i parë dhe shumë i rëndësishëm

i vendimit pas shkëputjes së tij nga arbitrazhi. Që nga momenti i nxjerrjes vendimi fiton plotëfugishmërinë juridike dhe se kontesti i shtruar për zgjidhje tanimë është përmbyllur. Sipas efektit res iudicata lënda e cila ishte në shqyrtim për të cilën tanimë u nxor një vendim përfundimtarë në arbitrazhi nuk mund të jetë objekt shqyrtimi për arbitrazhin tjetër apo

98 Neni 189 i ligjit zviceran të drejtës private ndërkombëtare i viti 1987 dhe neni 31 i ligjit rus për arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare i vitit 1996. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 500.

99 Neni 31 i ligjit model te UMNCITRAL-it Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 500.

gjykatën kompetente (ne bin is idem res iudicata). E në anën tjetër shtrohet pyetja se si do te trajtohet vendimi i arbitrazhit i cili është anuluar nga gjykata kompetente për shkaqe të arsyeshme, si res iudicata apo jo.¹⁰⁰ Sipas kësaj që u tha nëse vendimi i arbitrazhit është anuluar nga gjykata kompetente atëherë ai nuk prodhon efekte juridike dhe se kontesti në fjalë nuk konsiderohet si çështje e gjykuar dhe si i tillë mund të parashtrohet për zgjidhje pranë një arbitrazhi tjetër apo gjykatës kompetente.

b) Efekti inter partes apo i veprimit ndërmjet palëve në kontest. Efekti i dytë i vendimit të arbitrazhit ka të bëjë me obligimin e palëve për ta përmbushur atë. Palët për ta përmbushur vendimin e arbitrazhit janë pajtuar që në momentin e lidhjes së kontratës për arbitrazhin, kurse me zgjidhjen e kontestit obligimi i tillë merr formën e materializuar dhe vetëm duhet zbatuar atë. Praktika dëshmon se shumica e vendimeve të arbitrazhit realizohen vullnetarisht por ka raste kur duhet të realizohen dhunshëm.

Vendimi i arbitrazhit parimisht vepron vetëm ndërmjet palëve kontraktuese (inter partes) e jo edhe ndaj personave të tretë. Ky parim buron nga kontrata për arbitrazhin, sepse të gjitha pasojat e asaj marrëdhënieje juridike i bartin vetëm palët nënshkruese të kontratës e jo edhe personat e tretë siç ndodh me aktgjykimet e gjykatës. Megjithatë mund të ndodhë që vendimi i arbitrazhit të shtrijë efektin e tij edhe te personi i tretë psh. te pala nënkontraktuese. Kritikët e efekteve të vendimit të arbitrazhit thonë se efekti i vendimit nuk bën të godasë personin e tretë sepse ai nuk e ka kontraktuar dhe as që i ka dhënë kompetencë arbitrazhit për ta nxjerrë atë vendim.

2.7. PROCEDUR4 DHE AF'ATET E NXJERRJES SË VENDIMIT

Edhe pse arbitrat posedojnë autorizimin dhe lirinë e plotë nga palët për të vepruar ata prapëseprapë duhet t'u përmbahen disa rregullave procedurale si dhe respektimit të afatit brenda të cilit duhet nxjerrë

¹⁰⁰ Shembull për këtë çështje shërben rasti Piramids, ku paditësi inicion zgjidhjen e kontestit pranë qendrës së arbitrazhit ndërkombëtare për konteste investimore në Uashington, meqë paraprakisht para gjykatës kompetente franceze ishte anuluar vendimi i nxjerrë nga ICC arbitrazhi në Paris, për shkak të pavlefshmërisë së kontratës për arbitrazhin. Duke pasur parasysh se vendimi i ICC arbitrazhit nuk u konsiderua si res iudicata, kontesti me bazë dhe palë të njëjta ishte e mundur të zgjidhej pranë arbitrazhit të lartpërmendur. The Arab Republic of Egipt US. Sauofherm Pacific Properites et al cour d'eapeale de Paris, July 12. 1984. A. Redeform Jurisdiction denied the piramind cold, ses 1986, Journal 1986, of Busines Law. p. 15. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 503.

vendimin përfundimtar. Në vazhdim do të bëhet fjalë rreth procedurës së nxjerrjes së vendimit dhe afatit brenda të cilit duhet nxjerrë ai.

2.7.1. PROCEDURAT PËR NXJERRJEN E VENDIMIT TË ARBITRAZHIT

Procedura për nxjerrjen e vendimit përfundimtar zhvillohet në dy faza dhe atë faza e këshillimit dhe faza e votimit.

a) faza e këshillimit - kjo fazë i paraprin nxjerrjes së vendimit dhe është e rezervuar vetëm për arbitrat por pa praninë e palëve. Të gjithë arbitrat pjesë e atij tribunali janë të obliguar të marrin pjesë në këshillim dhe të japin kontributin e tyre për zgjidhjen e çështjes. Debati i cili zhvillohet gjatë këshillimit nuk guxon të publikohet, sepse kështu e do parimi i ruajtjes së fshehtësisë së procedurës së arbitrazhit.

b) faza e votimit - pas përfundimit të fazës së këshillimit arbitrat përmes votës së tyre të lirë deklarohen për formën dhe përmbajtjen e vendimit. Vendimi zakonisht merret me shumicë votash. Forma e nxjerrjes së vendimit të arbitrazhit me shumicë votash rregullohet si me dispozitat e ligjeve nacionale po ashtu edhe me dispozitat e burimeve juridike ndërkombëtare për arbitrazhin.

Ndër ligjet nacionale për arbitrazhin të cilat njohin nxjerrjen e vendimit me shumicë votash janë e drejta franceze, çeke, egjiptiane, kineze, ruse etj. Në procedurën e votimit kërkohet pjesëmarrja e të gjithë arbitrave të tribunalit. Vendimi duhet të merret pa asnjë votë kundër,¹⁰¹ kështu parashohin dispozitat e ligjit për arbitrazhin si ai brazilian, peruan etj. Nëse nuk arrihet shumica e nevojshme e votave për nxjerrjen e vendimit, atëherë palët i drejtohen gjykatës kompetente për t'a shfuqizuar kontratën për arbitrazhin.¹⁰² Për të mos komplikuar situatën rreth nxjerrjes së vendimit me shumicë votash, tribunali zakonisht përbëhet prej numrit tek të arbitrave si: 3,5 etj.

Nëse ndonjëri prej arbitrave tërhiqet nga misioni i tij gjatë zhvillimit të procedurës para këshillimit dhe votimit ai zëvendësohet me një arbitër tjetër. E nëse tërhiqet në fazën e këshillimit dhe votimit ai nuk mund të zëvendësohet por punën e vazhdojnë arbitrat e mbetur në tribunal por me përbërje të mangët (truncate tribunale).

101 Shif Bemar Divi L'arbitrage internationale cit. i përgjithshëm fq. 133. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 217.

102 Neni 475 i ligjit të procedurës kontestimore jugosllave si dhe neni 473. i rregullores së arbitrazhit të tregtisë së jashtme. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 517.

Siç e kemi theksuar më park edhe burimet ndërkombëtare me dispozitat e tyre bëjnë fjalë rreth nxjerrjes së vendimit me shumicë votash si ligji model i Uncitral-it,¹⁰³ i cili u shërben si model ligjeve nacionale për arbitrazhin. Gjatë zhvillimit të procedurës së këshillimit dhe votimit mund të ndodhë që ndonjëri prej arbitrave të ndajë mendimin nga të tjerët andaj të shohim në vijim se si trajtohet kjo çështje.

c) mendimi ndryshe – l'opinionone ex prime e se pare ment. Rregulla se vendimin e arbitrazhit duhet t'a nënshkruajnë të gjithë arbitrat nganjëherë bën përjashtim kur ndonjëri prej tyre refuzon ta nënshkruaj atë. Me mendimin ndryshe nënkuptojmë kur ndonjëri prej arbitrave mban qëndrim ndryshe nga arbitrat tjerë rreth dispozitivit të vendimit në tërësi apo ndonjë pjese të tij. Mendimin ndryshe arbitri mund ta shprehë në mënyrë të ashpër apo më të bute. Forma e ashpër e ndarjes së mendimit ndryshe konsiderohet atëherë kur arbitri nuk pajtohet me vendimin në tërësi dhe nuk e nënshkruan atë. Ndërsa forma më e butë e mendimit ndryshe konsiderohet atëherë kur arbitri në parim pajtohet me vendimin e nxjerre por vetëm shpreh pakënaqësinë e tij verbalisht (gojarisht) ndërsa në fund e nënshkruan atë. Pra mendimin ndryshe arbitri mund t'a shprehë me gojë dhe me shkrim. Disa autorë mendojnë se mendimi ndryshe nuk bën të shënohet në arsvetimin e vendimit sepse do të cenohej fshehtësia e procedurës së arbitrazhit. Mendimi ndryshe i arbitrit konsiderohet si akt i tolerueshëm dhe normal. Disa ligje nacionale mendimin ndryshe të arbitrit e kërkojnë e disa tjera nuk e tolerojnë atë. Ndërsa disa ligje tjera nacionale as nuk e kërkojnë e as nuk e ndalojnë shfaqjen e tij, por e lënë në ndërgjegjen e arbitrave.¹⁰⁴ Ekzistojnë ligje nacionale, të cilat fare nuk e trajtojnë këtë çështje.

Lidhur me mendim-ndryshe shtrohet pyetja se cili është ndikimi i këtij akti në fatin e mëtejme të atij vendimi dhe se a duhet njoftuar palët rreth mendimit ndryshe të ndonjërit prej arbitrave. Në pyetjen e parë përgjigja do të ishte se mendimi ndryshe do të ndikonte pozitivisht nëse përmban ndonjë element konstruktiv për atë vendim e në të kundërtën do të shërbejë si bazë e fortë për anulimin e tij nga organi kompetent si dhe ndonjërisë prej palëve do t'i shërbejë si shkas për të mos e respektuar atë vendim nëse është e informuar rreth mendimit ndryshe. Në doktrinë dominon mendimi se arbitri mund të mendojë ndryshe dhe të mos e nën-

103 Neni 3 i ligjit model të UNCITRAL-it. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 217.

104 Neni 458 bis13. Iurdhëresës kontestimore si dhe neni 54 i ligjit kinez për arbitrazhin. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 524.

shkruaj vendimin e nxjerrë por mendimi i tij ndryshe si dhe mosnënshkrimi i vendimit nuk mund të jenë pengesë për nxjerrjes e atij vendimi.¹⁰⁵

2.7.2. AFATI BRENDA TË CILIT NXIRRET VENDIMI I ARBITRAZHIT

Me shprehjen “afat” kuptojmë intervalin kohor brenda të cilit duhet të kryhet apo moskryhet ndonjë veprim. Afati si interval kohor zë vendin e merituar edhe në të drejtën e arbitrazhit. Në vijim do të bëhet fjalë rreth afatit të paraparë brenda të cilit duhet të nxirret vendimi përfundimtar i arbitrazhit.

Fillimisht, afatin e caktojnë palët në kontratën e tyre për arbitrazhin. Përveç palëve afati përcaktohet me ligje dhe me rregulloret e arbitrazheve. Afatin mund ta caktojnë edhe arbitrat e zgjedhur duke u mbështetur në parimin “afati i kuptueshëm”.

Meqë fillimisht përcaktimi i afatit për nxjerrjen e vendimit të arbitrazhit u përket palëve, atëherë atyre u rekomandohet që përcaktimin e tyre ta mbështesin në ligjin në fuqi apo në ndonjërin prej rregulloreve të arbitrazhit sepse çështja e afatit në to është e studiuar dhe analizuar mirë. Fillimi i rrjedhjes së afatit do të duhej llogaritur nga përfundimi i seancës së fundit të tribunalit për çështjen e jo nga momenti i emërimit të arbitrave sepse ky variant u mundëson palëve joserioze për të zvarritur procedurën e nxjerrjes së vendimit.

Burimet e së drejtës ndërkombëtare për arbitrazhin fare pak merren me trajtimin e çështjes së përcaktimit të afateve. Në anën tjetër ligjet nacionale për arbitrazhin, çështjen e përcaktimit të afateve e trajtojnë mjaft mirë, por secili në bazë të specifikave të tij. Kështu, ligji francez parasheh afatin prej 6 muajsh brenda të cilit tribunali duhet të nxjerrë vendimin. Ngjashëm me ligjin francez veprojnë edhe ligji holandez dhe ai zviceran për arbitrazhin. E drejta indiane parasheh afatin prej 4 muajsh, ndërsa ajo izraelite prej 3 muajsh etj. Thënë shkurt, afati sipas ligjeve nacionale oscilon prej shtetit në shtet, duke filluar prej 30 ditësh në SHBA e gjer në dy vite në shtetin e Kilit. Siç theksuam më parë përcaktimin e afatit e parashohin edhe rregulloret e arbitrazheve si rregullorja e ICC arbitrazhit me seli në Paris e cila parasheh afatin prej 6 muajsh etj.

105 Ph. Fouchard, vepra e cituar fq. 781, poashtu J. Robert l'arbitrage. Dalas 1983, fq. 310, dhe D. Bredlin, L'secret du de libers arbitra cit. i përgjithshëm fq. 71. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 526.

Afati i përcaktuar për nxjerrjen e vendimit mund të prolongohet apo shtyhet nëse ekzistojnë shkaqet e arsyeshme për këtë si dhe kërkesa e palëve apo arbitrave të tyre. Në disa sisteme juridike nacionale për shtyrjen e afateve vendosin arbitrat e në disa tjera vendosin gjykatat.

2.7. PROCEDURA PËR NXJERRJEN E VENDIMIT TË ARBITRAZHIT SIPAS LIGJIT TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

2.7.1. PROCEDURA PËR NXJERRJEN E VENDIMIT TË ARBITRAZHIT SIPAS LIGJIT TË SHQIPËRISË

Në kreun e katërt të këtij ligji bëhet fjalë rreth procedurës së nxjerrjes së vendimit të arbitrazhit. Sipas ligjit të Shqipërisë për arbitrazhin nxjerrjes së vendimit i paraprin këshillimi e pastaj vihet deri te votimi. Në nenin 428 të këtij ligji thuhet se diskutimi për nxjerrjen e vendimit nga tribunali bëhet pa praninë e palëve si dhe personave tjerë,¹⁰⁶ duke respektuar parimin e fshehtësisë së procedurës. Sipas ligjit shqiptar për arbitrazhin vendimi nxirret me shumicë votash dhe nënshkruhet nga të gjithë arbitrat. Gjatë zhvillimit të procedurës së këshillimit dhe votimit arbitri ka të drejtë të ndajë mendimin, të votojë kundër si dhe të mos e nënshkruajë atë. Mendimin ndryshe arbitri e prezanton me shkrim. Vendimi i nxjerrë me shumicë votash prodhon efekte juridike edhe pse nuk është i nënshkruar nga të gjithë arbitrat.

Vendimi përfundimtar i arbitrazhit sipas këtij ligji duhet t'i përmbajë këto elemente si përbërjen e tribunalit, vendin dhe datën e nxjerrjes, identitetin e palëve dhe përfaqësuesve të tyre, lëndën e shtruar për zgjidhje, dispozitivin dhe arsyetimin. Interpretimi dhe korrigjimi i gabimeve në atë vendim i takon vetëm tribunalit i cili e ka nxjerrë atë. Në rast nevojë, tribunali ka të drejtën të nxjerrë edhe vendime plotësuese për çështjet të cilat janë lënë pa u trajtuar me kohë. Ligji parasheh se në pamundësi për t'u tubuar tribunali korrigjimet teknike në atë vendim mund t'i kryejë edhe gjykata kompetente shtetërore.

Siç vërehet procedura për nxjerrjen e vendimit përfundimtar të arbitrazhit sipas këtij ligji i plotëson të gjitha standardet e parapara në raport me shtetet demokratike të regjionit, por njëkohësisht edhe i respekton specifikat e shtetit shqiptar.

106 Neni 428 i kodit të procedurës civile të Republikës së Shqipërisë. Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010.

***2.7.2. PROCEDURA PËR NXJERRJEN E VENDIMIT TË
ARBITRAZHIT SIPAS LIGJIT TË KOSOVËS***

Në këtë ligj, pos tjerash rregullohet edhe procedura për nxjerrjen e vendimit të arbitrazhit. Sipas këtij ligji tribunali vendimin e nxjerr në pajtim me dispozitat e kontratës për arbitrazhin si dhe duke marrë parasysh uzansat dhe zakonet tregtare, të cilat vlejné për rastin konkret.

Fillimisht, nxjerrjes së vendimit i paraprin këshillimi e pastaj votimi. Gjatë këshillimit arbitrat kanë të drejtën e shprehjes së mendimit ndryshe. Vendimi merret me shumicë votash dhe përpilohet në formën e shkruar. Pos dispozitivit, vendimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin si dhe datën dhe vendin e nxjerrjes. Sipas ligjit për arbitrazhin, vendimi është përfundimtar, i obligueshëm për palët, i formës së prerë dhe palëve u dorëzohet pasi të kenë paguar shpenzimet për arbitrazhin.

KAPITULLI I GJASHTË

VI. FUQIZIMI, ANULIMI, NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË ARBITRAZHIT

1. FUQIZIMI, EKZEKUTIMI DHE ANULIMI I VENDIMIT TË ARBITRAZHIT

Me nxjerrjen e vendimit përfundimtar mund të thuhet se u përmyll faza rreth zgjidhjes së kontestit në fjalë, por tani hapet faza tjetër e cila do të krijojë mundësitë për zbatimin e tij në praktikë. Gjatë atij rrugëtimi vendimi do të përballet me sfida të shumta deri në zbatimin e tij. Ndër sfidat më të rëndësishme me të cilat mund të përballet vendimi janë ekzekutimi i tij pa të cilin ai nuk do të kishte asnjë vlerë si dhe anulimi apo goditja me masë sanksionuese e cila shkakton asgjësimin e tij. Në vijim do të bëhet fjalë si për ekzekutimin, po ashtu edhe për anulimin e vendimit të arbitrazhit.

1.1. FUQIZIMI I VENDIMIT TË ARBITRAZHIT PËR EKZEKUTIM

Palët me lidhjen e kontratës për arbitrazhin kishin për qëllim që të gjitha kontestet e dala nga marrëdhënia e tyre juridike t'i zgjidhnin me arbitrazh. Me kontratën e lidhur për arbitrazhin palët gjithashtu merren vesh se vendimin e shqiptuar nga arbitrazhi do ta pranojnë si dhe do ta përmbushin ate posa ai të bëhet i plotëfuqishëm (final and binding). Obligimi për përmbushjen e atij vendimi nga palët burimin e ka nga vetë natyra juridike e arbitrazhit si dhe nga rregulloret e arbitrazheve institucionale të tregtisë ndërkombëtare. Rregulloret në fjalë ua përkujtojnë palëve se “edhe nëse në kontratën e tyre për arbitrazhin nuk e kanë paraparë pranimin dhe përmbushjen e vendimit si obligim,

obligimi i tillë ndaj atij vendimi vetvetiu ekziston.¹⁰⁷ Për obligimin e palëve rreth përbushjes së vendimit të arbitrazhit bëhet fjalë edhe në rregullat e Uncitral arbitrazhit ku thuhet se "vendimi i arbitrazhit është përfundimtar dhe obligues për palët dhe se ato marrin mbi vete obligimin se atë do ta përbushin pa vonesë."¹⁰⁸

Mbështetur në natyrën e arbitrazhit vetvetiu kuptohet se palët janë të obliguara që atë vendim ta përbushin pa hezitim. Përbushja e vendimit zakonisht bëhet në mënyrë vullnetare nga palët, por në raste të caktuara vendimi përbushet edhe në mënyrë të dhunshme.

a) Përbushja e vendimit në mënyrë vullnetare. Praktika dëshmon se shumica e vendimeve të arbitrazhit përbushen në mënyrë vullnetare nga palët sepse kështu e kërkon edhe natyra e arbitrazhit si gjyqësi miqësore. Përbushja vullnetare e vendimit ndodh në mos për shkak të korrektësisë atëherë për disa shkaqe tjera si për shkak të kostos më të ulët të zgjidhjes së kontestit në raport me gjykatën si dhe për shkak të dëshirës për ruajtjen e mëtejme të marrëdhënieve afariste ndërmjet palëve në kontest etj.

Përbushja vullnetare e vendimit të arbitrazhit mund të shtyhet apo prolongohet nëse ligji i shtetit të selisë së arbitrazhit apo marrëveshja e palëve i japin mundësi palës së pakënaqur me vendimin që të ushtrojë ankesë në instancat më të larta të arbitrazhit apo gjykatës kompetente.

b) Përbushja e vendimit të arbitrazhit në mënyrë të dhunshme. Pala fituese e kontestit fillimisht angazhohet që palën tjetër ta bindë që ajo vullnetarisht të përbushë obligimet e dala nga vendimi i arbitrazhit. Nëse nuk arrin ta bindë atëherë atë do ta kërcënojë me ndërprerje të bashkëpunimit të mëtejme afarist si dhe me publikimin e mosseriozitetit të saj si palë afariste. Po ashtu e kërcënon edhe me vënie në listën e zezë si palë joserioze. Nëse edhe kërcënimet e këtilla nuk japin rezultate, atëherë pala fituese i drejtohet gjykatës kompetente me kërkesën që përbushja e vendimit në fjalë të realizohet në mënyrë të dhunshme.

Në ligjet e disa shteteve vendimi i arbitrazhit është i ekzekutueshëm menjëherë pas nxjerrjes së tij meqenëse nuk lejohet ushtrimi i ankesës ndaj atij vendimi. Në grupin e dytë të shteteve ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit paraprakisht duhet të deponohet te gjykata kompetente apo të regjistrohet te organet kompetente me qëllim të barazimit të tij

107 Neni 16.8. i rregullores së arbitrazhit ndërkombëtarë me seli në Londër (LCIA). Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 534.

108 Neni 32.2 i rregullave të UNCITRAL arbitrazhit. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 534.

me aktvendimin e gjykatës për të fituar ekzegovaturën e pastaj të ekzekutohet. Kështu parashihet në të drejtën private ndërkombëtare zvicerane, në të drejtën italiane për arbitrazhin etj. Ndërsa në grupin e tretë bëjnë pjesë ato shtete e drejta e të cilave parasheh se pala fituese e kontestit nga gjykata kompetente fillimisht duhet të kërkojë lejen për ekzekutim të dhunshëm për vendimin në fjalë. Një rregull e këtillë parashihet në të drejtën franceze për arbitrazhin. Ekziston edhe grupi i katërt i shteteve, ku të drejtat e tyre për arbitrazhin parashohin se vendimi i arbitrazhit shërben vetëm si dëshmi për borgjin e dalë nga kontrata. Një qëndrim i këtillë parashihet në të drejtën italiane për arbitrazhin e ashtuquajtur “arbitrazhi i lirë-libera a irrituale”, ku për ekzekutimin e vendimit të këtij lloji të arbitrazhit parashihet një procedurë e veçantë gjyqësore. Vlen të theksohet se ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit nuk mund të kryhet mbi pronën publike të shtetit por mbi disa fonde ekonomike dhe tregtare të tij.

1.2. ANULIMI I VENDIMIT TË ARBITRAZHIT DHE SHKAQET PËR ANULIMIN E TIJ

a) Anulimi i vendimit të arbitrazhit. Kur ndonjëra prej palëve është e pakënaqur me vendimin e arbitrazhit dhe e konteston atë, atëherë mund të ndodhë që ai vendim të anulohet nëse ekzistojnë shkaqet e arsyeshme për anulimin e tij. Pos anulimit, vendimi i arbitrazhit mund të përballet edhe me pasoja tjera si rikthimi i tij te tribunali për t’u korrigjuar apo për t’iu nënshtruar një revizioni varësisht nga qëndrimi i sistemit juridik të atij shteti etj. Çështja e anulimit të vendimit të arbitrazhit me dekada ka tërhequr vëmendjen e teorisë së kësaj të drejte.

Për ta përkufizuar nocionin e anulimit të vendimit të arbitrazhit nuk është e lehtë sepse ligjet nacionale secila sipas mënyrës së vet e trajton dhe e përkufizon anulimin si fenomen. Kështu, ligji francez anulimin e konsideron si mjet juridik i cili përdoret kundër vendimit të arbitrazhit “le recours en annulation” me të cilin arrihet jo vetëm anulimi por edhe revizioni i atij vendimi.¹⁰⁹ Ndërsa në të drejtën angleze përdoret shprehja ”challenge” çka nënkupton kontestimin apo mohimin e vendimit të arbitrazhit. Kontestimi apo mohimi i vendimit të arbitrazhit

109 Neni 1485 i ligjit të ri francez për procedurën civile ku thuhet “kur jurisprudenca të cilës i është parashtruar kërkesa për anulimin e vendimit të arbitrazhit ajo vendos për meritumin brenda mësimeve të arbitrazhit. Gjithashtu neni 1491 i po këtij ligji thotë: mjeti juridik për revizionin është i hapur kundër vendimit të arbitrazhit në rastet për kushtet e parapara për aktvendimin. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 542.

sipas të drejtës angleze mund të bëhet përmes ankesës së ushtruar “appeal” e cila ka për qëllim anulimin e vendimit për arsye se në mënyrë joadekuate me të është zgjidhur çështja apo përmes formës tjetër “application” kërkesa e cila i parashtrahet gjykatës kompetente për ta anuluar atë vendim, sepse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për anulimin e tij apo për t’ia kthyer të njëjtin tribunalit në rigjykim.¹¹⁰ Sipas kësaj që u tha kuptohet se kërkesa e palës së pakënaqur jo gjithherë vendimin mund ta çojë në anulim por atë mund ta kthejë në rigjykim, në tërësi apo ndonjë pjesë të tij. Duhet theksuar se kontestimi i suksesshëm i vendimit brenda territorit të një shteti nuk nënkupton se do të prodhojë efekte të njëjta juridike edhe në shtetin tjetër. Kjo ndodh për arsye se ndonjëri prej shteteve konventën ndërkombëtare për arbitrazhin e ratifikon ashtu siç është ajo ndërsa tjetri e ratifikon duke i vënë rezervë.

Kur bëhet fjalë rreth anulimit të vendimit të arbitrazhit, të drejtës krahasimore i intereson të dijë se cilat janë gjykatat kompetente për anulimin e atij vendimi. Praktika dëshmon se llojet dhe nivelet e gjykatave të cilat ushtrojnë të drejtën e kontrollit mbi vendimet e arbitrazhit ndryshojnë prej shtetit në shtet. Ky ndryshim varet kryesisht prej karakterit organizativ të jurisprudencës së tyre. Kështu në të drejtën zvicerane kompetente për anulimin e vendimit të arbitrazhit është gjykata supreme me seli në Llozanë, në Francë gjyqi i apelit, në Angli gjyqi për tregti, në Rusi gjykata supreme, në SHBA gjykata federale, në Shqipëri gjykata e apelit e kështu me radhë. Nga rregulla e lartpërmendur rreth kompetencës së gjykatave për anulimin e vendimit të arbitrazhit të brendshëm bëhet përjashtim në rast se palët janë përcaktuar për aplikimin e ndonjë të drejte të huaj procedurale dhe materiale për zgjidhjen e kontestit të tyre. Në raste të këtilla anulimin e atij vendimi mund ta bëjë gjykata e shtetit e drejta procedurale dhe materiale e të cilit është aplikuar si e drejtë kompetente për nxjerrjen e atij vendimi. Shembull për këtë na shërben e drejta gjermane për arbitrazhin ku dispozitat e saj parashohin

110 Neni 68 i aktit anglez për arbitrazhin ku thuhet se: nëse konstatohet se ekzistojnë parregullsi serioze të cilat i përkasin tribunalit, procedurës apo vendimit të arbitrazhit gjykata mundet a) vendimin t’ia kthejë tribunalit në tërësi apo pjesërisht në rigjykim, b) që vendimin ta anulojë në tërësi apo në ndonjë pjesë të tij. Në nenin 69 po të këtij ligji përpunohet në tërësi çështja e ankesës së palëve drejtuar gjykatës kompetente në bazë të çështjeve juridike të cilat janë iniciuar në atë vendim të arbitrazhit (appeal an point of law) dhe parashihet zgjidhje të këtilla, a) që vendimi të vërtetohet apo fuqizohet, b) që vendimi të ndryshohet, c) që vendimi t’i kthehet tribunalit në tërësi apo ndonjë pjesë e tij në rishqyrtim sipas vërejtjeve të dhëna nga gjykata dhe d) që vendimin të anulohet në tërësi apo ndonjë pjesë e tij. Merkin 99-109. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 542.

anulimin e vendimit të arbitrazhit edhe pse ai është nxjerrë nga arbitrazhi i shtetit tjetër.¹¹¹ Qëndrim të ngjashëm rreth anulimit me ligjin gjerman mban edhe ligji francez ku thuhet se “grykatat kompetente franceze kanë të drejtën për të shqyrtuar dhe anuluar të gjitha vendimet e arbitrazhit të brendshëm dhe arbitrazhit të huaj nëse ato janë nxjerrë brenda territorit të Francës apo sipas të drejtës kompetente franceze.

Rreth anulimit të vendimit bëjnë fjalë edhe rregullat e ligjit model të Uncitrali-it ku thuhet se “grykata e shtetit posedon kompetencën për të anuluar vendimin e arbitrazhit nëse ai është nxjerrë brenda territorit të tij.¹¹² Siç dihet vendimi i anuluar nga grykata kompetente nuk mund të prodhojë efekte juridike si brenda shtetit ku është nxjerrë po ashtu edhe në shtetet tjera nënshkruese të Konventës së Nju Jorkut në të cilat kërkohet njohja dhe ekzekutimi i tij. Shpeshherë shtrohet pyetja se cili do të jetë fati i kontestit i cili ishte zgjidhur me atë vendim tani të anuluar. Disa autorë mendojnë se ai kontest prapë mund të zgjidhet me arbitrazh e disa të tjerë thonë se për zgjidhjen e tij tani është kompetente grykata shtetërore. Çështjen e vendimit të anuluar në mënyra të ndryshme e rregullojnë edhe ligjet nacionale ku disa prej tyre si Austria, Turqia, Australia etj., e lejojnë rigjykimin e atij vendimi pranë arbitrazhit e disa të tjera si Gjermania, Holanda, Italia etj., fare nuk e lejojnë rigjykimin e atij kontesti me arbitrazh por të njëjtin për gjykim ia dërgojnë grykatës kompetente të shtetit.

b) Shkaqet e anulimit të vendimit të arbitrazhit. Për të anuluar një vendim të

arbitrazhit duhet të ekzistojnë arsyet apo shkaqet e parapara për një akt të këtillë. Ligjet nacionale, si dhe burimet tjera juridike në mënyrë të detajuar i përshkruajnë shkaqet mbi të cilat pala e pakënaqur me vendimin mund të mbështesë kërkesën e saj për anulimin e tij.

Shkaqet mbi të cilat mund të mbështetet anulimi i vendimit të arbitrazhit mund të klasifikohen sipas karakteristikave të tyre të përbashkëta në këto grupe: 1) mangësitë formale 2) mangësitë juridiksionale 3) mangësitë procedurale si dhe 4) cenimi i rendit publik nacional dhe atij ndërkombëtar me atë vendim.

1. Mangësitë formale shkak për anulimin e vendimit të arbitrazhit. Kur bëhet fjalë rreth formës së vendimit të arbitrazhit më herët është thënë se vendimi i arbitrazhit duhet të posedojë formën e tij pa të cilën

111 Van der Berg, Nju Jork, Convention of 1958 (1981) fq. 27, dhe R. Aidfern, cit. i përgjithshëm, fq. 432, Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 543.

112 Neni 34.2 i ligjit model të UNCITRAL-it për arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare i vitit 1985. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 544.

nuk do të mund të prodhonte efekte juridike. Elementet e formës së vendimit janë se vendimi duhet të jetë në formën e shkruar, duhet të përmbajë emrat e palëve dhe arbitrave të tyre, duhet të jetë i nënshkruar nga të gjithë arbitrat e atij tribunali, duhet të përmbajë arsyetimin si dhe datën dhe vendin e nxjerrjes së tij. Mungesa e ndonjërës prej këtyre elementeve formale vendimin do ta çonte drejt anulimit të tij. Mangësitë formale të vendimit rregullohen si me ligje nacionale po ashtu edhe me rregulla ndërkombëtare.

2. Mangësitë juridikcionale shkak për anulimin e vendimit të arbitrazhit. Në grupin e shkaqeve juridikcionale për anulimin e vendimit të arbitrazhit bëjnë pjesë të gjitha ato mangësi, të cilat kanë të bëjnë me kontratën për arbitrazhin si dhe me kompetencën e dhënë arbitrave dhe shfrytëzimin e saj nga ata gjatë shqyrtimit të kontestit. Siç dihet kontrata për arbitrazhin duhet të jetë e plotvlefshme dhe se plotvlefshmëria e saj varet nga aftësia dhe vullneti i palëve për të kontraktuar atë si dhe objekti (lënda) dhe forma e kontratës. Nëse ndonjëri nga këto kushte i mungon kontratës për arbitrazhin, kontrata do të shpallet e pavlefshme dhe vendimi i nxjerrë në këto rrethana është i anulueshëm. E nëse kontrata për arbitrazhin është e plotëvlefshme ku përmes saj u është dhënë kompetenca arbitrave për ta zgjidhur kontestin e caktuar por nëse dhënia e kompetencës arbitrave nuk është e plotë apo arbitrat qoftë e kanë tejkaluar ose nuk e kanë shfrytëzuar atë gjatë shqyrtimit të çështjes dhe nxjerrjes së vendimit, atëherë vendimi i nxjerrë në këso rrethana shpallet i pavlershëm si dhe nuk do të prodhojë efekte juridike si brenda shtetit ku është nxjerrë, po ashtu edhe në shtetet tjera ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi i tij.

3. Mosrespektimi i procedurës shkaktar i anulimit të vendimit të arbitrazhit. Në këtë grup të shkaqeve për anulimin e vendimit të arbitrazhit bëjnë pjesë të gjitha ato lëshime, të cilat vijnë si pasojë e mosrespektimit të dispozitave procedurale si me rastin e konstituimit të tribunalit po ashtu edhe me rastin e rrjedhave të procedurës gjatë shqyrtimit të çështjes. Mosrespektimi i procedurës në këto raste do të dëmtonte fillimisht interesin e palëve si dhe do të ndikonte negativisht në objektivitetin e vendimit të nxjerrë. Është rregull se rregullat procedurale patjetër duhet të zhvillohen qoftë në përputhje me kontratën e palëve për arbitrazhin, qoftë në përputhje me të drejtën kompetente të përzgjedhur nga vetë palët apo arbitrat e tyre. Në të kundërtën vendimi i nxjerrë nga arbitrazhi do të anulohet nëse konstatohet mosrespektimi i rregullave procedurale.

Mosrespektimi i rregullave procedurale mund të ndodhë si në punën e arbitrazhit nacional po ashtu edhe në punën e arbitrazhit

ndërkombëtarë. Prandaj kohëve të fundit po kërkohet aplikimi i standardit “fer” për shqyrtimin e çështjes nga arbitrat.

Ligjet nacionale mosrespektimin e rregullave procedurale e sanksionojnë me anulim të vendimit si p.sh. SHBA-të mosrespektimin e formës orale (gojore) të prezantimit të qëndrimit të palëve për çështjen në shqyrtim e konsiderojnë si lëndim i procedurës dhe lëshim i arbitrave çka gjykatës kompetente i jep shkas për anulimin e atij vendimi, ndërsa vendimit të arbitrazhit të huaj i refuzohet njohja dhe ekzekutimi. E drejta franceze për mosrespektimin e procedurave thotë “në këtë situatë shkelet barazia ndërmjet palëve si dhe u pamundësohet atyre prezantimi i qëndrimeve të tyre rreth kontestit në fjalë.”¹¹³ E drejta angleze mosrespektimin e procedurës e konsideron si “misconduct” apo shkelje të atributit të arbitrit dhe si shkak të anulimit të vendimit të arbitrazhit e konsideron edhe keqdrejtimin e procedurës me çka krijohet hapësirë për keqinterpretimin e se drejtës.¹¹⁴

4. Cenimi i rendit publik shkak për anulimin e vendimit të arbitrazhit. Vendimi i arbitrazhit mund të anulohet nëse me të cenohen normat e rendit publik si të shtetit nacional po ashtu edhe normat e rendit publik ndërkombëtar. Dispozitat e rendit publik nacional secili shtet i rregullon me normat e tij imperative dhe nuk lejon që arbitrazhi me vendimin e tij t’i lëndojë ato. Të gjitha vendimet e arbitrazhit të cilat bien në kundërshtim me rendin publik të shtetit në territorin e të cilit nxirren vendimet, gjykata kompetente i anulon ato. Si cenim i rendit publik konsiderohet edhe mosarbitrabiliteti i lëndës për t’u zgjidhur me arbitrazh. Termi “rend publik” te anglezet shqiptohet si “public policy” ndërsa tek francezët “ordre public”.

Rreth cenimit të rendit publik si shkak për anulimin e vendimit të arbitrazhit, pos ligjeve nacionale bën fjalë edhe ligji model i UNCITRAL-it, ku thuhet se “anulimi i vendimit të arbitrazhit mund të ndodhë nëse ai është në kundërshtim me rendin publik të shtetit në territorin e të cilit është nxjerrë”¹¹⁵. Vlen të theksohet se ligji model i UNCITRAL-it edhe pse është me karakter ndërkombëtar fare nuk bën fjalë për cenimin e rendit publik ndërkombëtar sepse rendi publik

113 C. Kersedion, principe de la contadictione et arbitrage. Revue de l’arbitrage, 1995. p.381, dhe droit et pratique de l’arbitrage internacianale en France. Ph. Fouchard, cit. i përgjithshëm, fq 961. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 555.

114 Neni 21.1 dhe 23.1 i arbitration act-it anglez i vitit 1950. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 555.

115 Neni 34.6 i ligjit-model të UNCITRAL-it. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 555.

ndërkombëtar ende konsiderohet si abstrakcion dhe postulat i një të ardhmeje të së drejtës ndërkombëtare.

1.3. SHKAQET E ANULIMIT TË VENDIMIT TË ARBITRAZHIT SIPAS LIGJEVE TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS PËR ARBITRAZHIN

1.3.1. Shkaqet për anulimin e vendimit të arbitrazhit sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë

Ligji i fundit i Shqipërisë për arbitrazhin pos tjerash parasheh edhe shkaqet për anulimin e vendimit të arbitrazhit. Sipas këtij ligji vendimi i arbitrazhit mund të anulohet nëse:

- tribunali shpall veten pa të drejtë se është kompetent apo jo për zgjidhjen e kontestit.

- tribunali është konstituar në mënyrë jo të rregullt.

- tribunali tejkalon kompetencat apo nuk i shfrytëzon ato gjatë gjykimit të çështjes.

- tribunali nuk i trajton palët në mënyrë të barabartë.

- vendimi përfundimtar i tribunalit cenon rendin publik të Shqipërisë etj.¹¹⁶

Nëse konstatohet prania e shkaqeve të lartpërmendura, atëherë gjykatës së apelit i hapet rruga për anulimin e atij vendimi. Kërkesa për anulimin e vendimit duhet të parashtrohet në afat prej tridhjetë ditësh nga pala e pakënaqur me vendimin.

1.3.2. Shkaqet për anulimin e vendimit të arbitrazhit sipas ligjit të Republikës së Kosovës

Edhe ligji i Kosovës për arbitrazhin në nenin 36 kreu VIII thotë se gjykata kompetente anulon vendimin e arbitrazhit nëse konstatohet se:

- në momentin e lidhjes së kontratës ndonjëra prej palëve nuk posedonte aftësinë për të vepruar.

- marrëveshja për arbitrazhin nuk ishte e plotvlefshme sipas të drejtës kompetente apo ligjit të zbatueshëm të Kosovës.

- janë shkelur rregullat procedurale gjatë shqyrtimit të kontestit, si mosinformimi i palëve për ecurinë e procedurës apo trajtimi jo i barabartë i tyre.

116 Neni 437 i Kodit të Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010.

- me vendimin e nxjerrë nuk është zgjidhur çështja e shtruar apo tribunali i ka tejkaluar kompetencat e tij.

- tribunali nuk është konstituar sipas marrëveshjes së palëve apo në përputhje me ligjin në fuqi.

- veprimtaria e arbitrazhit ishte e ndaluar me ligjin në fuqi apo vendimi i nxjerr cenon rendin publik të Kosovës etj.

Kërkesa për anulimin e vendimit duhet të parashtrohet në afatin brenda nëntëmbëdhjetë ditësh pranë gjykatës kompetente pas shpalljes së vendimit. Gjykata kompetente pos anulimit vendimin mund ta kthejë në përpunim te arbitrazhi për t'i eliminuar shkaqet që e çojnë te anulimi atë (neni 36.2 dhe 3 i këtij ligji). Gjykata kompetente, sipas këtij ligji nuk merret me zgjidhjen e kontestit siç vepron gjykata e apelit në Shqipëri. Ky është njëri prej dallimeve ndërmjet ligjit për arbitrazhin e Shqipërisë dhe ligjit për arbitrazhin e Kosovës.

5.2. NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË ARBITRAZHIT TË HUAJ

5.2.1 NOCIONI I NJOHJES DHE EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT TË ARBITRAZHIT TË HUAJ

Në praktikën e arbitrazhit ekzistojnë plot raste kur vendimi i arbitrazhit i nxjerrë në një shtet duhet të realizohet në shtetin tjetër. Një praktikë e këtillë disi e komplikon punën dhe perspektivën e arbitrazhit si mekanizëm alternativ për zgjidhjen e kontesteve, duke pasur parasysh parimet e të drejtës ndërkombëtare ku secilit shtet sovran i garantohet ushtrimi i papenguar i pushtetit gjyqësor brenda territorit të tij. Me nocionin “sovranitet” shtetëror kuptohet se asnjë lloj vendimi i nxjerrë në territorin e shtetit tjetër nuk mund të prodhojë efekte juridike në shtetin aktual. Ky parim duhet të vlejë edhe për vendimin e nxjerr nga arbitrazhi i huaj. Ndërsa në anën tjetër njerëzimi ka nevojë për një zhvillim të marrëdhënieve ekonomike me përmasa ndërkombëtare me qëllim të krijimit të kushteve për një jetë sa më të begatshme dhe prosperuese. Natyrisht se zhvillimi i këtyre marrëdhënieve ekonomike me karakter ndërkombëtar ndodh që të përcillet me probleme të caktuara, të cilat duhet evituar sa më shpejt. Pengesat apo kontestet e shfaqura të cilat rrjedhin nga këto marrëdhënie motivuan bashkësinë ndërkombëtare që të angazhohej për nxjerrjen e rregullave juridike me të cilat do të bëhej njëfarë lloj përjashtimi në raport me kompetencën ekskluzive të

gjykatave shtetërore dhe të formohet një lloj rregulli në favor të ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit në shtetin tjetër. Ky angazhim i bashkësisë ndërkombëtare rreth ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj gjeti mbështetje edhe në vetë natyrën e arbitrazhit sepse arbitrazhi si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve në punën e tij shfrytëzon dy lloj burimesh juridike, si burimet nacionale po ashtu edhe ato ndërkombëtare.

Kur bëhet fjalë rreth termave “njohje dhe ekzekutim” i vendimit të arbitrazhit të huaj ekziston bindja se këto dy terme janë të ngjashme dhe nuk kanë ndonjë dallim qenësor ndërmjet tyre. Megjithatë dallimi ndërmjet këtyre dy termave është mjaft i theksuar por megjithatë ekziston njëfarë varshmërie ndërmjet tyre.

Me termin “njohje” e vendimit të arbitrazhit të huaj kuptojmë fuqizimin juridik të atij vendimi nga organi kompetent i shtetit nga i cili kërkohet njohja e atij vendimi. Në praktikë mund të ndodhë që vendimit të arbitrazhit të huaj t’i jepet njohja por jo edhe ekzekutimi.

Termi “ekzekutim” i vendimit të arbitrazhit të huaj edhe pse prezantohet si shprehje në vete ajo është e lidhur ngushtë me termin njohje sepse nuk mund të ketë ekzekutim të vendimit të arbitrazhit të huaj pa njohjen paraprake të tij.

Kërkesa për njohje dhe ekzekutim u drejtohet organeve kompetente të shtetit në territorin e të cilit gjendet pasuria e palës e cila ka humbur kontestin. Nëse pasuria e palës humbëse të kontestit gjendet në disa shtete, atëherë pala fituese e kontestit zgjedh se cilit prej atyre shteteve do t’i drejtohet me kërkesën për njohje dhe ekzekutim të atij vendimi (forum shopping).¹¹⁷ Nëse malli i palës humbëse të kontestit gjatë transportimit të tij bllokohet në ndonjë shtet, atëherë kërkesa për njohje dhe ekzekutim i dërgohet atij shteti

ku malli gjendet i bllokuar. Sipas kësaj që u tha më lart mund të konkludohet se procedura rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj konsiderohet si një lloj kontrolli mbi vendimin e arbitrazhit të huaj. Vendimi i arbitrazhit të huaj për të fituar njohjen dhe ekzekutimin paraprakisht duhet t’i plotësojë disa kushte të parapara në ligjin e shtetit të cilit i kërkohet njohja dhe ekzekutimi.

117 M. Hulean, Janez N., Gould International Commercial Arbitration. A Hand Book London 1996. p 106-107. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 571.

5.2.2. KUSHTET PËR NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË ARBITRAZHIT TË HUAJ.

Vendimi i arbitrazhit për të fituar njohjen dhe ekzekutimin në shtetin tjetër duhet t'i plotësojë disa kushte të caktuara. Rreth kushteve të parashtruara për njohje dhe ekzekutim të vendimit të arbitrazhit të huaj bëhet fjalë si në ligjet nacionale po ashtu edhe në konventat ndërkombëtare për arbitrazhin.

a) Kushtet sipas ligjeve nacionale - kushtet për njohje dhe ekzekutim të vendimit të arbitrazhit të huaj i përcaktojnë secili shtet veç e veç duke u mbështetur në specifikat e tija. Përcaktimi i kushteve për njohje dhe ekzekutim të vendimit të arbitrazhit të huaj tek shtetet nacionale fillojnë që nga themelimi i arbitrazhit, zhvillimi i procedurës e deri tek sanksionimi i vendimit. Pra për njohje dhe ekzekutim të vendimit të arbitrazhit të huaj sipas ligjeve nacionale vlejné të gjitha ato kushte të cilat vlenin për fuqizimin apo anulimin e vendimit të arbitrazhit nacional. Rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj në kuadër të rregullave nacionale ekziston edhe një metodë tjetër e bazuar në kriteret e shkollës së vjetër dhe shkollës së re të së drejtës ndërkombëtare private. Sipas parimeve të shkollës së vjetër të së drejtës private ekzistojné tri sisteme për njohje dhe ekzekutim të vendimit të arbitrazhit të huaj. Sipas sistemit të parë vendimi i arbitrazhit të huaj trajtohet njësoj si vendimi i arbitrazhit të brendshëm. Sipas sistemit të dytë vendimi i arbitrazhit të huaj trajtohet njësoj si aktgjykimi i gjykatës së huaj. Ndërsa sipas sistemit të tretë të kësaj shkolle njohja dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit të huaj mund të bëhet vetëm me plotësimin e kushteve të veçanta të cilat nuk kërkohen as për njohjen e aktgjykimit të gjykatës së huaj.¹¹⁸ Kohëve të fundit metoda e shkollës së vjetër të së drejtës ndërkombëtare private disi është braktisur sepse në një farë mënyre më shumë favorizonte të drejtën e shtetit të njohjes sesa të drejtën e shtetit sipas të cilës ishte nxjerrë vendimi i arbitrazhit. Edhe metoda e shkollës së re të së drejtës ndërkombëtare private rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj nuk solli ndonjë ndryshim thelbësor për këtë çështje. Njësoj sikurse shkolla e vjetër edhe shkolla e re parasheh tri sisteme rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj. Sipas sistemit të parë, vendimi i arbitrazhit të huaj vështrohet në kuptimin

118 Milan Pak, *Mejnarodno arbitražno pravo*, Beograd, 1986, fq. 224-231.

e kontratës materialo-juridike, çka nënkupton se më parë duhej të verifikohej nga gjykata nacionale e pastaj të fitojë njohjen dhe ekzekutimin në shtetin tjetër. Këtë sistem të njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj e aplikonin shumica e shteteve anglosaksone, por me kushtin që palët në kontratën e tyre për arbitrazhin shprehimisht të kishin paraparë edhe obligimin për ekzekutim të atij vendimi. Duke u mbështetur në këtë rregull gjykatat angleze një kohë të caktuar kishin refuzuar të njihnin dhe ekzekutonin vendimet e arbitrazheve të huaja, të cilat vinin nga shtetet evropiane të sistemit juridik kontinental nëse paditësit nuk ishin në gjendje të dëshmonin se në kontratën e tyre për arbitrazhin figuronte marrëveshja e veçantë për ekzekutimin e atij vendimi.¹¹⁹ Ndërsa sipas sistemit të dytë të shkollës së re të së drejtës private ndërkombëtare, vendimi i arbitrazhit të huaj trajtohet njësoj si edhe aktgjykimi i gjykatës së huaj. Sistemit të dytë të kësaj shkolle i përmbahen e drejta zvicerane, spanjolle, argjentinase, turke, egjiptiane, iraniane etj. Sipas këtij sistemi gjykatave kompetente u mundësohet që gjatë procedurës së njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj të verifikojnë si anën formale po ashtu edhe atë materiale të atij vendimi si dhe të bëjnë revizionin e tij. Në disa shtete të tjera njohja dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit të huaj kryhet përmes parimit të reciprocitetit, por fillimisht duhej vërtetuar se ai vendim konsiderohet i plotëfuqishëm në shtetin ku është nxjerr apo jo, por pa u lëshuar në mënyrën se si është arritur plotëfuqishmëria e tij në atë shtet.¹²⁰ Sipas sistemit të tretë të shkollës së re njohja dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit të huaj kryhet duke e asimiluar atë në vendim të arbitrazhit vendor por me specifika apo regjim të veçantë. Me fjalë tjera, sipas sistemit të tretë vendimi i arbitrazhit të huaj tani më nuk shikohet as si kontratë e as si aktgjykim i gjykatës së huaj, por si një vendim specifik (sui generis) i arbitrazhit i cili sipas natyrës së tij është i afërt me vendimin e arbitrazhit vendor. Sistemi i tretë i shkollës së re rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj vjen si inspirim nga konventat ndërkombëtare për arbitrazhin. Ky sistem përkrahet nga e drejta franceze, finlandeze, belge, norvegjeze për arbitrazhin etj.

b) Kushtet sipas konventave ndërkombëtare rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj. Siç kemi theksuar më parë

119 Një praktikë e tillë në gjykatat angleze është vërejtur për here të pare në kontestin Merifild Ziegler and co. vs. Liverpool Conton Assotiation. Ltd e Loe Times 1911-97. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 571-578

120 R. David vepra e përmendur fq. 537-538. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 579.

pos ligjeve nacionale edhe konventat ndërkombëtare parashohin kriteret rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj. Vetë natyra juridike e arbitrazhit si dhe procedura, e cila zhvillohet rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj në raste te caktuara rrezikonin të komprometonin vendimin e nxjerrë nga gjyqësia private ndërkombëtare. E nxitur nga një frikë e këtillë bashkësia ndërkombëtare u angazhua për krijimin e kushteve sa më të volitshme rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj. Dokumenti i parë ndërkombëtar i angazhuar në këtë drejtim ishte konventa e Gjenevës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj e vitit 1927. Pastaj vjen Konventa e Nju Jorkut e vitit 1958 për njohje dhe ekzekutim të vendimit të arbitrazhit të huaj si dhe Konventa Evropiane për arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare e vitit 1961 dhe ligji model i Uncitral-it i vitit 1985. Meqenëse Konventa e Nju Jorkut konsiderohet më e avancuara në raport me konventat tjera rreth përcaktimit të kushteve për njohje dhe ekzekutim të vendimit të arbitrazhit të huaj, atëherë në vazhdim do të cekim kushtet që i parasheh kjo konventë. Sipas Konventës së Nju Jorkut kushtet për njohje dhe ekzekutim të vendimit të arbitrazhit të huaj janë se:

1 - vendimi i arbitrazhit të huaj për të fituar njohjen dhe ekzekutimin duhet të jetë i nxjerrë në përputhje me kontratën e plotëvlershme për arbitrazhin apo në përputhje me ligjin e shtetit në territorin e të cilit është nxjerrë ai vendim.

2 - procedura pranë arbitrazhit të jetë zhvilluar në mënyrë të rregullt si dhe palët të jenë trajtuar në mënyrë të barabartë.

3 - vendimi i nxjerrë të ketë të bëjë me lëndën e kontestit të paraparë në kontratën për arbitrazhin si dhe të mos jenë tejkaluar kufijtë e përcaktuar me atë kontratë.

4 - konstituimi dhe funksionimi i tribunalit të jenë zhvilluar sipas rregullave të përcaktuara në kontratën e palëve për arbitrazhin apo sipas ligjit të shtetit në të cilin ka funksionuar arbitrazhi.

5 - vendimi i arbitrazhit të huaj të jetë obligues për palët, me fjalë tjera vendimi të jetë i plotëfuqishëm dhe të mos ushtrohet ankesë ndaj tij.

6 - vendimi i arbitrazhit të huaj për t'u njohur dhe ekzekutuar në shtetin tjetër duhet të mos jetë i anuluar, i ndaluar apo prolonguar nga organet e shtetit ku është nxjerr ai apo nga organet kompetente të shtetit e drejta e të cilit ishte përzgjedhur për t'u nxjerrë ai vendim.

7 - lënda e kontestit të ketë qenë e përshtatshme apo arbitrabile për t'u zgjidhur me arbitrazh në raport me ligjin e shtetit nga i cili kërkohet njohja dhe ekzekutimi i atij vendimi dhe

8 - vendimi të mos jetë në kundërshtim me rendin publik nacional apo edhe me rendin publik ndërkombëtar.

Sipas kësaj konvente nëse konstatohet se ndonjëri prej kushteve të përmendura nuk është respektuar gjatë nxjerrjes së vendimit, atëherë atij vendimi mund t'i refuzohet njohja dhe ekzekutimi në shtetin tjetër. Pos kushteve të përmendura, Konventa e Nju Jorkut parasheh edhe një mundësi tjetër rreth dhënies së njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj të ashtuquajturën “e drejta e përshtatshme”. Me shprehjen “e drejta e përshtatshme” kuptojmë se kërkesa për njohje dhe ekzekutim të atij vendimi mund të bazohet në marrëveshjen bilaterale apo edhe multilaterale, e cila është në fuqi ndërmjet shteteve të caktura, nëse ajo marrëveshje në fuqi është më e favorshme për palët sesa Konventa e Nju Jorkut.¹²¹

2.3. NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË ARBITRAZHIT TË HUAJ SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS

2.3.1. Njohja dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit të huaj sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj ligji për arbitrazhin i Republikës së Shqipërisë nr. 8812 i datës 17.05.2001, nuk parasheh ndonjë kapitull të veçantë, por këtë çështje e rregullon në kuadër të ligjit për njohje dhe ekzekutim të vendimit të gjykatës së huaj. Në kodin e procedurës civile të Shqipërisë thuhet se “vendimi i gjykatës së huaj zbatohet në Shqipëri vetëm në bazë të vendimit të Gjykatës së Apelit e cila i jep fuqinë ekzekutive në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij kodi”¹²². Por në vijim të tij thuhet se

121 Në të drejtën e arbitrazhit ndërkombëtar më së paku është diskutabile se kjo e drejtë i takon edhe palës humbëse në kontest apo vetëm palës fituese e cila zakonisht inicion procedurën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj. Nëse kjo e drejtë i takon edhe palës humbëse të kontestit mendojnë disa autor kjo nënkupton se asaj i mundësohet të mos e aplikojë Konventën e Nju Jorkut. S. Trivo, A. Gold{tajn, vepra e cituar fq. 330. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000, fq. 584.

122 Neni 398 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010, faqe 146.

“dispozitat e tij zbatohen edhe për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj”.¹²³

Në bazë të kësaj që u tha kuptohet se për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë vlejnë rregullat e procedurës civile të cilat janë në fugi për njohje dhe ekzekutim të vendimit të gjykatës së huaj.

2.3.2. Njohja dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit të huaj sipas ligjit të Republikës së Kosovës

Ligji për arbitrazhin i Republikës së Kosovës nr. 02/L-75 i vitit 2001 rreth njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të huaj bën fjalë në kreun VIII të tij ku thuhet se “gjykatat e Kosovës njohin vendimet e arbitrazheve të nxjerra jashtë Kosovës si të plotfuqishme si dhe i ekzekutojnë ato nëse janë shpallur të ekzekutueshme sipas paragrafeve 2,3,4 dhe 5 të nenit 39 të këtij ligja”. Pala e interesuar kërkesën për njohje dhe ekzekutim ia parashtron gjykatës kompetente bashkë me vendimin origjinal të arbitrazhit apo kopjen e vërtetuar të tij si dhe origjinalin e kontratës për arbitrazhin apo kopjen e vërtetuar të saj dhe të përkthyer në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të Kosovës.

123 Neni 399 I Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010, faqe 146.

Ligji Nr. 02/L-75

LIGJI PËR ARBITRAZHIN

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të Kreut 5.1 (ç) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 datë 15 maj 2001), dhe

Me qëllim të rregullimit të lëndës së arbitrazhit dhe të ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit të nxjerra brenda dhe jashtë Kosovës në pajtim me standardet bashkëkohore Evropiane dhe ndërkombëtare,

Miraton:

LIGJIN PËR ARBITRAZHIN

Kreu I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi

Me këtë ligj përcaktohen rregullat që zbatohen për marrëveshjet e arbitrazhit, procedurat e arbitrazhit si dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të nxjerra brenda dhe jashtë Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

“Marrëveshja e Arbitrazhit” nënkupton marrëveshjen e arritur ndërmjet dy ose më shumë personave, që disa ose të gjitha kontestet juridike, të cilat kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet tyre, do t'i nënshtrohen arbitrazhit.

“Vendim” përfshin të gjitha urdhrat e nxjerra nga tribunali i arbitrazhit, qofshin ato të përkohshme, të pjesshme, procedurale, merito-

re ose përfundimtare, lidhur me të gjitha çështjet, përfshirë këtu edhe shpenzimet.

“**Konsumator**” do të thotë çdo person fizik i cili lidhë kontratë për qëllime që nuk kanë të bëjnë me tregti, afarizmin ose profesionin e tij.

“**Person**” përfshin të gjithë personat fizikë dhe juridikë. Në kuader të personave juridike bëjnë pjesë personat juridike të së drejtës private si dhe personat juridikë të së drejtës publike.

“**Gjykatë**” në këtë ligj i referohet gjykatës së caktuar në marrëveshjen e arbitrazhit ose, në mungesë të një percaktimi të tillë, Gjykatës Ekonomike.

“**Tribunal**” nënkupton tribunalin e arbitrazhit.

Neni 3

Kompetencat e gjykatës

Asnjë gjykatë në Kosovë nuk ka të drejtë të ndërhyjë në procedurën e arbitrazhit, përveç nëse është percaktuar ndryshe me këtë ligj.

Neni 4

Njoftimi dhe llogaritja e afateve kohore

4.1. Të gjitha njoftimet, kumtesat ose parashtrirat konsiderohen se janë pranuar nëse ato i janë dorëzuar personalisht personit të adresuar, ose nëse i dërgohen personit të adresuar përmes postës së regjistruar në vendbanimin e tij, në vendin ku ai e ushtron afarizmin ose në adresën e tij postare. Nëse asnjëra nga lokacionet e lartpërmendura nuk mund të gjinden, njoftimi konsiderohet së është pranuar nëse ai i dërgohet personit të adresuar në vendbanimin ose vendin e ushtrimit të afarizmit të fundit të njohur. Njoftimi konsiderohet se është pranuar në ditën kur është bërë dorëzimi i tij. Dispozitat e këtij paragrafi nuk zbatohen lidhur me njoftimet dhe parashtrirat e dorëzuara gjatë procedurave gjyqësore.

4.2. Të gjitha afatet kohore të parapara në këtë ligj fillojnë të ecin një ditë pas pranimit të njoftimit. Nëse dita e fundit e këtij afati kohor është festë zyrtare ose nuk është ditë pune në vendbanimin ose vendin e afarizmit të personit të adresuar, atëherë afati kohor përfundon në ditën e parë vijuese të punës. Festat zyrtare ose ditët që nuk janë ditë pune duhet të përfshihen në llogaritjen e afatet kohor.

Kreu II MARRËVESHJA E ARBITRAZHIT

Neni 5 Arbitrabiliteti

5.1. Një mosmarrëveshje mund të zgjidhet përmes arbitrazhit vetëm nëse ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë që mosmarrëveshja të zgjidhet përmes arbitrazhit.

5.2. Të gjitha mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me kërkesa civile-juridike dhe ekonomike-juridike mund t'i nënshtrohen arbitrazhit, përveç nëse është e ndaluar me ligj.

Neni 6 Marrëveshja e arbitrazhit

6.1. Marrëveshja e arbitrazhit lidhet në forme të shkruar.

6.2. Kushti i mësipërm konsiderohet se është përmbushur edhe nëse lidhja e marrëveshjes së arbitrazhit dokumentohet në forme të kembimit të letrave, telefaksit, telegramit ose mënyrave të tjera të telekomunikimit ose komunikimit elektronik, në formë të konosmanit, nëse konosmani përmban shprehimisht një klauzolë të arbitrazhit, ose në rast të paraqitjes së padisë dhe të përgjigjes në padi, në kuadër të së cilës njëra palë pretendon se ekziston një marrëveshje arbitrazhi dhe pala tjetër nuk e konteston këtë.

6.3. Nëse një konsumator është palë në marrëveshjen e arbitrazhit, marrëveshja e arbitrazhit konsiderohet të jetë lidhur në formën e shkruar vetëm nëse të gjitha palët në marrëveshjen e arbitrazhit e nënshkruajnë personalisht dokumentin që përmban klauzolën e arbitrazhit. Nënshkrimi i cekur në këtë paragraf mund të zëvendësohet me nënshkrimin elektronik në përputhje me legjislacionin përkatës për nënshkrimet elektronike.

6.4. Mospërmbushja e kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni nuk merret parasysh nga tribunali i arbitrazhit, nëse palët e kanë iniciuar procedurën e arbitrazhit.

Neni 7 Padi të para Gjykatave

Gjykata, para së cilës është ngritur një padi lidhur me një çështje, e cila i nënshtrohet arbitrazhit, e hedh poshtë padinë, nëse i padituri në përgjigjen e tij ndaj padisë thirret në marrëveshjen e arbitrazhit, përveç nëse gjykata konstaton se marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme ose që çështja kontestuese nuk mbulohet nga marrëveshja e arbitrazhit.

Neni 8 Masat e përkohshme të gjykatës

Pa marrë parasysh marrëveshjen e arbitrazhit ose fillimin e procedurës së arbitrazhit, gjykata kompetente mund të merr masa të përkohshme, nëse kjo kërkohet nga njëra palë e cila paraget prova të besueshme se asaj mund t'i shkaktohet dëm ose humbje e menjëhershme ose e pariparueshme nëse nuk merret masa e përkohshme.

Kreu III PËRBËRJA E TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT

Neni 9 Numri dhe emërimi i arbitërve

9.1. Tribunali i arbitrazhit përbëhet nga një arbitër i vetëm ose nga një trup arbitrash, me kusht që numri i arbitrave të këtij trupi të jetë një numër tek.

9.2. Palët mund të merren vesh për procedurën e emërimit të arbitrit ose të arbitrave.

9.3. Nëse palët nuk merren vesh për numrin e arbitrave ose për procedurën e emërimit të tyre brenda 15 ditëve pasi që i padituri të ketë pranuar njoftimin për arbitrazh, tribunali i arbitrazhit do të përbëhet nga një trup prej 3 arbitërve të cilët emërohen sipas paragrafit 4 të këtij neni.

9.4. Në rastin e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, secila palë emëron një arbitër. Dy arbitrat e emëruar, e emërojnë arbitrin e tretë i cili do të jetë drejtues i tribunalit të arbitrazhit. Nëse njëra pala nuk e emëron arbitrin brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës për ta bërë këtë, ose nëse dy arbitrat nuk merren vesh për emërimin e arbitrit të tretë brenda tridhjetë ditëve nga emërimi i tyre, atëherë me kërkesën e njëjës palë arbitri përkatës emërohet nga Gjykata.

9.5. Përveç nëse palët pajtohen ndryshe, pala, e cila e ka bere emërimin e arbitrit, është e lidhur për këtë emërim prej momentit, kur pala tjetër ta ketë pranuar njoftimin për emërimin e arbitrit.

9.6. Kur Gjykata e emëron arbitrin, ajo i merr parasysh kualifikimet të cilat arbitri duhet t'i plotësojë sipas marrëveshjes së arbitrazhit dhe duhet të sigurojë që arbitri të jetë i pavarur, i paanshëm dhe të mos ketë ndonjë konflikt interesi.

Neni 10 Përjashtimi i arbitrit

10.1. Personi, të cilit njëra palë ose Gjykata i drejtohet për emërim si arbitër, ka për detyrë t'i bëjë publike të gjitha rrethanat të cilat mund të shkaktojnë dyshime lidhur me pa-anësinë ose pavarësinë e tij. Arbitri, pas emërimit, duhet t'i bëjë publike rrethanat e tilla para palëve nëse palët nuk janë njoftuar paraprakisht për këto rrethana.

10.2. Secila palë mund të kërkojë përjashtimin e cilitdo arbitër, nëse ajo ka dyshime të arsyeshme lidhur me pa-anësinë ose pavarësinë e arbitrit, ose nëse arbitri nuk i posedon kualifikimet për të cilat palët janë pajtuar. Pala mund të kërkojë përjashtimin e arbitrit të cilin e ka emëruar ajo, vetëm nëse arsyet për përjashtimin e tij kanë lindur pas emërimit të arbitrit. Pala gjegjëse ka për detyrë të kërkojë përjashtimin e arbitrit menjëherë pasi të njoftohet për rrethanat të cilat e arsyetojnë përjashtimin.

Neni 11 Procedura për përjashtimin e arbitërve

11.1. Palët mund të merren vesh për procedurën e përjashtimit të një arbitri. Paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni zbatohen, nëse palët nuk janë pajtuar për një procedurë të tillë.

11.2. Brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga emërimi i arbitrit ose pasi të jetë njoftuar për rrethanat e përcaktuara me nenin 10, paragrafi 2, pala e cila kërkon përjashtimin e një arbitri ka për detyrë, t'i dërgojë palës tjetër dhe anëtarëve tjerë të tribunalit një njoftim për përjashtimin. Njoftimi duhet të bëhet me shkrim dhe në të duhet të theksohen arsyet për përjashtim.

11.3. Nëse arbitri nuk jep dorëheqje ose pala tjetër nuk pajtohet me përjashtimin, tribunali i arbitrazhit vendos mbi kërkesën për përjashtimin e arbitrit.

11.4. Nëse kërkesa për përjashtimin e arbitrit nuk është e suksesshme sipas procedurës për të cilën janë pajtuar palët ose sipas procedurës së paraparë në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, atëherë pala përkatëse mund të paraqesë kërkesën për përjashtimin e arbitrit para Gjykatës brenda 15 ditëve prej ditës së pranimit të njoftimit për refuzimin e kërkesës për përjashtim. Kundër vendimit të Gjykatës nuk lejohet ankesa. Përderisa Gjykata nuk ka vendosur për kërkesën, tribunali i arbitrazhit, duke përfshirë edhe arbitrin përjashtimi i të cilit kërkohet, mund të vazhdojë me procedurën e arbitrazhit dhe të nxjerr vendim.

Neni 12 Moskryerja e detyrës

12.1. Nëse arbitri për arsye juridike ose faktike nuk mund t'i ushtrojë detyrat e tij ose për shkaqe tjera nuk i ndërmerr veprimet pa vonesë të arsyeshme, mandati i tij përfundon nëse jep dorëheqje ose kur palët pajtohen për përfundimin e mandatit të tij. Nëse arbitri nuk jep dorëheqje ose nëse palët nuk pajtohen lidhur me përfundimin e mandatit, me kërkesën e njëjës palë ose të ndonjë anëtari të tribunalit, Gjykata vendos për përfundimin e mandatit të arbitrit. Kundër vendimit të Gjykatës nuk është e lejuar ankesa.

12.2. Nëse sipas paragrafit 1 të këtij neni ose nenit 11, paragrafi 2, arbitri jep dorëheqje ose palët pajtohen për përfundimin e mandatit të arbitrit, kjo nuk nënkupton se ekziston njëra prej arsyeve të parapara në këtë nen ose në nenin 11, paragrafi 2.

Neni 13 Zëvendësimi i arbitrit

Në rast se mandati i një arbitri përfundon sipas nenit 11 ose 12 ose për shkak të dorëheqjes së tij, atëherë emërohet një zëvendës arbitër sipas dispozitave për emërimin e arbitrave, përveç nëse palët dakordohen për një procedurë tjetër.

Kreu IV
KOMPETENCA E TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT

Neni 14
Kompetenca

14.1. Tribunali i arbitrazhit vendos mbi vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit dhe se a është kompetent për zgjidhjen e kontestit i cili i është parashtruar. Në këtë kontekst, klauzola e arbitrazhit, e cila është pjesë e një kontrate, trajtohet si marrëveshje e veçantë dhe e pavarur prej kontratës.

14.2. Kundërshtimin, se tribunali i arbitrazhit nuk është kompetent, pala duhet ta dorëzojë më së voni deri në momentin e dorëzimit të përgjigjes në padi. Pala nuk mund të privohet nga e drejta e paraqitjes së kundërshtimit në fjalë, për shkak se e ka emëruar ose ka marrë pjesë në emërimin e një arbitri.

14.3. Kundërshtimi, se tribunali i arbitrazhit e ka tejkaluar kompetencën e vet, duhet të paraqitet nga pala menjëherë pasi të vihet në dijeni për këtë.

14.4. Në rastet e parapara me paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, tribunali i arbitrazhit mund të pranojë një kundërshtim të paraqitur me vonesë, nëse konstaton se pala ka arsyetim të pranueshëm për këtë vonesë.

14.5. Secila palë mund të kërkojë nga gjykata që të shqyrtojë vendimin e tribunalit të arbitrazhit lidhur me kompetencën e tij mbi kontestin përkatës. Kjo kërkesë duhet të dorëzohet në gjykatë brenda tridhjetë ditëve prej ditës së pranimin të njoftimit me shkrim mbi vendimin. Paraqitja e kërkesës nuk e ndalon tribunalin e arbitrazhit që të vazhdojë me procedurën e arbitrazhit dhe të nxjerr vendim.

Neni 15
Masat e përkohshme

15.1. Përveç nëse palët pajtohen ndryshe, tribunali i arbitrazhit, me kërkesën e njëres pale, mund të urdhërojë marrjen e masës së përkohshme, nëse pala paraget prova të besueshme se asaj mund t'i shkaktohet dëm ose humbje e menjëhershme ose e pariparueshme në rast se nuk merret një masë e këtillë. Tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë nga secila palë që të deponojë mjete siguroese lidhur me masat e tilla të përkohshme.

15.2. Me kërkesën e palës, gjykata mund të urdhërojë ekzekutimin e masës së përkohshme të urdhëruar nga tribunali i arbitrazhit sipas paragrafit 1 të këtij neni, përveç kur sipas nenit 8, për çështjen e njëjtë, pala e ka kërkuar masën e përkohshme.

15.3. Nëse konstatohet se masa e përkohshme e urdhëruar nga tribunali i arbitrazhit sipas paragrafit 1 të këtij neni ka qenë e paarsyeshme, pala në dobi të së cilës është urdhëruar masa e përkohshme ka për detyrë ta kompensojë dëmin të cilin e ka pësuar pala tjetër si pasojë e ekzekutimit të masës së përkohshme. Tribunali i arbitrazhit është kompetent për të vendosur lidhur me arsyeshmërinë e masës së përkohshme dhe për çështjet që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të lartpërmendur.

Kreu V PROCEDURAT E ARBITRAZHIT

Neni 16 Rregullat e përgjithshme

16.1. Palët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe secila palë duhet të ketë mundësinë e plotë që të paraqesë rastin e saj në secilën fazë të procedurës së arbitrazhit.

16.2. Palët janë të lira në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, të cilët do t'i përfaqësojnë ato në procedurën e arbitrazhit. Asnjë përfaqësues i autorizuar nga pala, nuk mund të përjashtohet nga procedura e arbitrazhit.

16.3. Pa cenuar dispozitat e detyrueshme të këtij ligji, palët mund të pajtohen mbi procedurën e arbitrazhit.

16.4. Nëse palët nuk janë pajtuar për procedurën e arbitrazhit dhe në mungesë të dispozitave përkatëse në këtë ligj, tribunali i arbitrazhit i përcakton vet rregullat e arbitrazhit duke i zbatuar përshtatshmërisht rregullat e procedurës kontestimore ose duke i zbatuar rregullat e arbitrazhit të një institucioni të arbitrazhit të përhershëm.

Neni 17 Vendi i arbitrazhit

17.1. Nëse palët nuk janë pajtuar mbi vendin ku duhet të mbahet arbitrazhi, tribunali i arbitrazhit e cakton vendin e mbajtjes së arbitrazhit duke marrë parasysh rrethanat e rastit dhe përshtatshmërinë e vendit për palët dhe tribunalin.

17.2. Pa cenuar paragrafin 1 të këtij neni, dhe nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, tribunali i arbitrazhit mund të takohet në cilindo

vend që e konsideron të përshtatshëm për mbajtjen e dëgjimit të palëve, të dëshmitarëve, ose të ekspertëve, mbajtjen e konsultimeve ndërmjet anëtarëve të tribunalit të arbitrazhit dhe për shiqimin e sendeve ose dokumenteve.

Neni 18

Fillimi i procedurës së arbitrazhit

Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, procedura e arbitrazhit lidhur me një kontest të caktuar fillon në ditën kur kërkesa që kontesti t'i nënshtrohet arbitrazhit pranohet nga pala e paditur.

Neni 19

Gjuha

19.1. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, tribunali i arbitrazhit, menjëherë pas themelimit të tij, e përcakton gjuhën ose gjuhët të cilat do të përdoren gjatë procedurës së arbitrazhit. Marrëveshja ndërmjet palëve, respektivisht, vendimi i tribunalit vlejnë për të gjitha deklaratat dhe parashtrësit me shkrim që dorëzohen nga palët, seancat e dëgjimit, si dhe vendimet ose kumtesat tjera të tribunalit të arbitrazhit.

19.2. Tribunali i arbitrazhit mund të urdhërojë që të gjitha dokumenteve të dorëzuara gjatë procedurës së arbitrazhit t'u bashkëngjitet një përkthim në gjuhën ose gjuhët për të cilat janë pajtuar palët ose të cilat i ka caktuar tribunali i arbitrazhit. Tribunali i arbitrazhit i pranon vetëm përkthimet e bëra nga një përkthyes i certifikuar ose i aprovuar nga gjykata.

Neni 20

Padia, përgjigjja në padi dhe kundër-padia

20.1. Brenda afatit të dakorduar nga palët ose, në mungesë të një dakordimi të tillë, brenda afatit të caktuar nga tribunali i arbitrazhit, padi-tësi ka për detyrë të paraqesë padinë e tij dhe provat në të cilat mbështetet padia, dhe i padituri ka për detyrë të paraqesë përgjigjen në padi dhe provat në të cilat mbështetet ajo. Së bashku me padinë, përkatësisht, në përgjigjen në padi, palët mund t'i paraqesin të gjitha dokumentet tjera të cilat i konsiderojnë të nevojshme dhe përcaktojnë se cilat prova tjera do t'i paraqesin.

20.2. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, secila palë gjatë procedurës së arbitrazhit mund ta ndryshojë ose ta plotësojë padinë e vet, respektivisht përgjigjen e vet në padi, përveç nëse tribunali i arbitrazhit konsideron se ndryshimet ose plotësimet janë të palejueshme për shkak se janë paraqitur me vonesë.

20.3. Së bashku me përgjigjen në padi, ose në një fazë të mëvonshme të procedurës, kur tribunali i arbitrazhit, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, vendos se vonesa është e arsyeshme, i padituri mund të paraqesë kundër-padinë e cila mbështetet në të njëjtën kontratë ose në një kërkesë të bazuar në të njëjtën kontratë me qëllim të kompensimit të ndërsjellët të kërkesave. Paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni zbatohen përshtatshëmrisht për kundër-paditë.

Neni 21

Dëgjimi i palëve dhe procedura me shkrim

21.1. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve, tribunali i arbitrazhit vendosë se a do të mbahet seanca e dëgjimit ose procedura do të zhvillohet në bazë të dokumenteve dhe materialeve të tjera të shkruara, ose nëse do të kombinohen të dy këto procedura. Nëse palët nuk e kanë përjashtuar mbajtjen e seancave të dëgjimit, tribunali i arbitrazhit mbanë seancat e dëgjimit në një fazë të përshtatshme të procedurës, nëse një gjë e tillë kërkohet nga pala. Seancat e dëgjimit nuk janë publike, përveç nëse palët janë dakorduar ndryshe.

21.2. Palët duhet të informohen paraprakisht dhe në kohë të duhur në lidhje me çdo seancë të dëgjimit dhe çdo mbledhje të tribunalit të arbitrazhit e cila ka për qëllim nxjerrjen e provave.

21.3. Të gjitha deklaratat, dokumentet ose informatat e tjera të cilat njëra palë ia dorëzon tribunalit të arbitrazhit u dërgohen edhe të gjitha palëve tjera. Kjo vlen edhe për raportet e ekspertëve ose provave tjera në formë të shkruar në të cilat tribunali i arbitrazhit mund ta mbështesë vendimin e tij.

21.4. Tribunali i arbitrazhit bënë përgatitjen e përkthimeve të deklaratave gojore gjatë seancave të dëgjimit si dhe mbajtjen e procesverbalit gjatë seancës, nëse një gjë e tillë konsiderohet e nevojshme nga tribunali i arbitrazhit duke marrë parasysh rrethanat e rastit, ose nëse palët janë pajtuar për këtë dhe e kanë njoftuar tribunalin e arbitrazhit së paku 15 ditë para mbajtjes së seancës së dëgjimit. Palët i bartin shpenzimet e përkthimit.

Neni 22

Mbyllja e seancës së dëgjimit

22.1. Pas paraqitjes së provave sipas nenit 20, paragrafi 1, tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë nga palët se a kanë për të paraqitur prova shtesë ose dëshmitarë plotësues. Nëse nuk ka paraqitje të tilla, seanca e dëgjimit mbyllet.

22.2. Me iniciativë të vetën, ose në bazë të kërkesës së njëjës palë, tribunali i arbitrazhit mundet, në raste të jashtëzakonshme dhe kur këtë e konsideron të domosdoshme, ta caktojë rihapjen e seancës së dëgjimit në çdo kohë para marrjes së vendimit merititor.

Neni 23

Provat

23.1. Secila palë e ka barrën e të provuarit për faktet te cilat e mbështesin padinë, përkatësisht, përgjigjen në padi.

23.2. Tribunali i arbitrazhit përcakton pranueshmërinë, relevancën, vërtetësinë dhe peshën e provave të paraqitura.

23.3 Tribunali i arbitrazhit vendos mbi pranimin ose hedhjen poshtë të kërkesave për nxjerrjen e provave. Tribunali i arbitrazhit mund të nxjerrë prova, nëse këtë e konsideron të nevojshme, dhe bënë vlerësimin tyre në mënyrë të lirë dhe të paanshme..

23.4. Në çdo kohë gjatë procedurës, tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë nga palët që të paraqesin dokumente ose prova tjera brenda afatit të caktuar nga ai.

Neni 24

Dëshmitarët

24.1. Nëse duhet të dëgjohet një dëshmitar, së paku 15 dite para mbajtjes së seancës së dëgjimit, secila palë duhet t'ia dorëzojë tribunalit të arbitrazhit dhe palës tjetër emrin edhe adresën e dëshmitarit të cilin e fton të deklarohet, çështjen për të cilën do të dëshmojë dhe gjuhën në të cilën do ta paraqes dëshminë.

24.2. Deklaratat e dëshmitarëve mund të paraqiten edhe në formë të deklaratave të shkruara, të nënshkruara nga dëshmitari, me kusht që dëshmitari të jetë në dispozicion për palët, nëse njëra palë e kërkon ekzaminimin e dëshmitarit.

Neni 25 Ekspertët

25.1. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, tribunali i arbitrazhit mund të emërojë një ose më shumë ekspertë të cilët do t'i raportojnë atij me shkrim për çështje të caktuara nga tribunali i arbitrazhit.

25.2. Tribunali i arbitrazhit mund ta urdhërojë një palë që ekspertit t'i jep çdo informatë të nevojshme, të përgatisë ose t'i ofrojë qasje në dokumente ose sende për shikim. Pas pranimit të raportit të ekspertit, tribunali i arbitrazhit ua dërgon palëve nga një kopje të raportit me ç'rast palëve u jepet mundësia që me shkrim ta shprehin mendimin e tyre lidhur me raportin.

25.3. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, me kërkesë të palës ose nëse tribunali i arbitrazhit këtë e konsideron të nevojshme, eksperti, pasi të ketë dorëzuar raportin me shkrim, dëgjohet në seancë, gjatë së cilës palët kanë mundësi ta marrin ekspertin në pyetje. Gjatë kësaj seance të dëgjimit, palët mund të paraqesin ekspertët e tyre për të dhënë mendimin e tyre në lidhje me çështjet e ngritura.

Neni 26 Mosveprimi i palës

26.1. Nëse paditësi nuk e paraqet padinë e tij në pajtim me nenin 20, paragrafi 1 dhe nuk ka arsytim të mjaftueshëm për këtë, tribunali i arbitrazhit e mbyllë procedurën e arbitrazhit.

26.2. Nëse i padituri nuk e paraqet përgjigjen e tij në padi sipas nenit 20, paragrafi 1, tribunali i arbitrazhit vazhdon me procedurën. Mungesa e paraqitjes së përgjigjes në padi nga i padituri nuk do të konsiderohet si pranim i pretendimeve të paditësit.

26.3. Nëse njëra palë, edhe pse ka genë e njoftuar me rregull sipas këtij ligji, nuk merr pjesë në seancën e dëgjimit ose nuk i dorëzon provat brenda afatit të caktuar, tribunali i arbitrazhit mund ta vazhdojë procedurën e arbitrazhit dhe ta nxjerrë vendimin në bazë të provave me të cilat disponon.

Neni 27 Heqja dorë nga kundërshtimi

Pala e cila është në dijeni për një shkelje të ndonjë dispozite të këtij ligji ose të marrëveshjes me palën tjetër por e cila prapseprapë

vazhdon procedurën e arbitrazhit pa kundërshtuar menjëherë shkeljen në fjalë, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për të parashtruar kundërshtimin.

Neni 28

Ndihma e gjykatës

28.1. Tribunali i arbitrazhit, ose pala që ka marrë miratimin paraprak nga tribunali i arbitrazhit, mund të kërkojë ndihmë nga gjykata, me qëllim të nxjerrjes së provave ose për kryerjen e punëve tjera juridike të cilat tribunali i arbitrazhit nuk është kompetent për t'i kryer.

28.2. Nëse gjykata konstaton se kërkesa e tillë është e pranueshme, ajo e zbaton kërkesën në pajtim me rregullat e saja procedurale.

Kreu VI

VENDIMET

Neni 29

E drejta kompetente

29.1. Në rastet me element ndërkombëtar, tribunali i arbitrazhit zbaton të drejtën të cilën palët e kane caktuar si të drejtën kompetente për aspektet materiale të kontestit. Në mungesë të një caktimi të tillë nga palët, tribunali i arbitrazhit zbaton të drejtën e përcaktuar nga rregullat e se drejtës ndërkombëtare private. Në të gjitha rastet tjera, tribunali i arbitrazhit e zbaton legjislacionin e Kosovës.

29.2. Tribunali vendos ex aequo et bono ose si amiable compositeur vetëm nëse palët shprehimisht e kanë autorizuar për këtë.

29.3. Në të gjitha rastet, tribunali i arbitrazhit vendos në pajtim me dispozitat e kontratës duke marre parasysh uzancat tregtare që vlejné për rastin konkret.

Neni 30

Marrja e vendimeve

30.1. Në procedurën e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, çdo vendim i tribunalit të arbitrazhit merret me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të tribunalit të arbitrazhit, përveç nëse palët pajtohen ndryshe.

30.2. Për çështjet procedurale drejtuesi i tribunalit të arbitrazhit vendos vet, nëse për këtë është i autorizuar nga palët ose nga të gjithë anëtarët e tribunalit të arbitrazhit.

Neni 31

Forma dhe përmbajtja e vendimit

31.1. Vendimi i tribunalit të arbitrazhit nxirret në formë të shkruar dhe është përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët. Vendimi për palët e ka efektin e njëjtë juridik sikurse një aktgjykim i plotfuqishëm dhe detyrues i gjykatës.

31.2. Në vendim ceken arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi, përveç nëse palët janë pajtuar që arsyet të mos ceken.

31.3. Vendimi nënshkruhet nga arbitri ose arbitrat, dhe mbanë datën dhe vendin kur është nxjerrë. Në procedurën e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, nënshkrimet e shumicës së anëtarëve të tribunalit janë të mjaftueshme, me kusht që në vendim të shpjegohen arsyet për mungesën e nënshkrimeve të tjera.

31.4. Nga një kopje e vendimit të nënshkruar nga arbitrat u dorëzohet të dyja palëve, pasi që të jenë paguar të gjitha taksat.

31.5. Vendimi bëhet publik vetëm me pëlqimin e të gjitha palëve.

Neni 32

Pajtimi

32.1. Nëse para nxjerrjes së vendimit palët pajtohen për zgjidhjen e kontestit, tribunali e ndërprejnë procedurën e arbitrazhit.

32.2. Nëse kërkohet nga palët, tribunali i arbitrazhit mund të dokumentojë pajtimin e palëve në formë të një vendimi të arbitrazhit sipas kushteve për të cilat janë pajtuar palët, përveç nëse përmbajtja e pajtimit cenon ose është në kundërshtim me rendin publik (ordre public). Vendimi i tillë e ka efektin e njëjtë sikur një vendim meritor.

Neni 33

Përfundimi i procedurës së arbitrazhit

33.1. Procedura e arbitrazhit përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar ose të një urdhri të tribunalit të arbitrazhit sipas paragrafit 2 të këtij neni.

33.2. Tribunali i arbitrazhit nxjerr urdhër për ndërprerjen e procedurës së arbitrazhit nëse:

1. paditësi:

a) nuk e dorëzon padinë e tij sipas nenit 20, paragrafi 1;

b) e tërheq padinë, përveç nëse i padituri e kundërshton këtë dhe tribunali i arbitrazhit konstaton se i padituri ka interes legjitim që të nxirret vendimi përfundimtar mbi kontestin;

2. palët pajtohen për përfundimin e procedurës; ose

3. palët nuk vazhdojnë procedurën e arbitrazhit edhe pse vazhdimi i procedurës është kërkuar nga tribunali i arbitrazhit ose nëse vazhdimi i procedurës së arbitrazhit është bërë i pamundshëm ose i panevojshëm për arsye të tjera.

33.3. Mandati i tribunalit të arbitrazhit përfundon me ndërprerjen e procedurës, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

Neni 34

Shpenzimet e procedurës

34.1. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, tribunali i arbitrazhit cakton shpenzimet në vendimin e tij përfundimtar. Shpenzimet në fjalë përfshijnë:

a. taksën e tribunalit të arbitrazhit;

b. shpenzimet e arbitrave;

c. shpenzimet për ekspertë dhe ndihmën tjetër të cilën e ka kërkuar tribunali i arbitrazhit dhe për të cilën janë pajtuar palët;

d. shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të dëshmitarëve, deri në masën e miratuar nga tribunali i arbitrazhit;

e. shpenzimet për përfaqësimin dhe ndihmën për palën e suksesshme, nëse kompensimi i këtyre shpenzimeve është kërkuar gjatë procedurës së arbitrazhit, dhe vetëm deri në atë masë që tribunali i arbitrazhit e cakton të arsyeshëm; dhe

f. të gjitha taksat dhe shpenzimet e gjykatës kur kjo bënë emërimin e arbitërve.

34.2. Taksat e tribunalit të arbitrazhit duhet të jenë të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën e kontestit, kompleksitetin e lëndës, kohën e shpenzuar nga arbitrat dhe rrethanat e tjera të rastit. Në rast se shfagen mosmarrëveshje në lidhje me shumën e taksave që duhet paguar tribunalit të arbitrazhit, gjykata është kompetente që të vendosë mbi këtë çështje.

34.3. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, shpenzimet e arbitrazhit i ngarkohen palës humbëse. Tribunali i arbitrazhit mund të ndajë shpenzimet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni ndërmjet palëve, nëse konstaton se një ndarje e tillë është e arsyeshme duke marrë parasysh rrethanat e rastit.

Neni 35

Korrigjimi, interpretimi dhe plotësimi i vendimit

35.1. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, brenda tridhjetë ditëve nga marrja e vendimit, secila palë, duke e njoftuar edhe palën tjetër, mund të kërkojë nga tribunali i arbitrazhit:

a. ta interpretojë vendimin;

b. ta korrigjojë ndonjë gabim në llogaritje, gabim shtypi ose çfarëdo gabimi tjetër të kësaj natyre; ose

c. ta nxjerrë një vendim plotësues në lidhje me paditë e ngritura para tribunalit të arbitrazhit, por të cilat nuk janë përfshirë në vendimin përfundimtar.

35.2. Brenda tridhjetë ditëve nga dërgimi i vendimit, tribunali i arbitrazhit mund të bëjë korrigjime të tilla me iniciativë të vetën. Tribunali i arbitrazhit i bën korrigjimet ose jep interpretimin brenda tridhjetë ditëve nga pranimi i kërkesës për ta bërë këtë.

35.3. Nëse tribunali i arbitrazhit konsideron se kërkesa për nxjerrjen e vendimit plotësues është e arsyeshme dhe konsideron se vendimi plotësues mund të nxirret pa mbajtjen e seancës së dëgjimit ose nxjerrjes së provave, tribunali i arbitrazhit e plotëson vendimin brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i kërkesës. Neni 30 vlen përshtatshmërisht edhe për vendimet plotësuese.

Kreu VII

PROCEDURA GJYQËSORE

Neni 36

Mjetet juridike

36.1. Në rastet e parapara në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, secila palë mund të kërkojë nga gjykata që të anulojë një vendim të tribunalit të arbitrazhit.

36.2. Gjkata anulon vendimin e tribunalit nëse: a). Paditësi dëshmon se:

(i) njëra palë në marrëveshjen e arbitrazhit nuk ka patur zotësinë për të vepruar;

(ii) marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose nga tribunali i arbitrazhit ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë;

(iii) paditësi nuk është njoftuar me rregull në lidhje me emërimin e një arbitri ose mbi procedurën e arbitrazhit, ose për arsye tjera nuk ka qenë në gjendje të paraqes rastin e tij;

(iv) vendimi nuk ka të bëjë me çështjen e shqyrtuar nga tribunali i arbitrazhit ose ka të bëjë me një çështje për të cilën nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit, ose vendimi përfshinë çështje për të cilat nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit. Në këto raste, nëse vendimi mbi çështjet për të cilat është kompetent tribunali i arbitrazhit mund të ndahet nga çështjet tjera, atëherë kjo pjesë e vendimit mund të ekzekutohet;

(v) përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose me marrëveshjen e arbitrazhit, me kusht që mangësia e tillë të ketë patur ndikim në vendimin e tribunalit; ose

b). Gjykata konstaton se:

(i) arbitrazhi në fjalë është i ndaluar me ligj; ose

(ii) ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public).

36.3. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, padia për anulimin e vendimit të tribunalit të arbitrazhit i dorëzohet gjykatës jo më vonë se nëntëdhjetë ditë pas pranimit të vendimit të tribunalit të arbitrazhit nga pala përkatëse.

36.4. Kur kërkohet anulimi i vendimit të tribunalit të arbitrazhit, Gjykata mundet, nëse kjo është e arsyeshme, ta anulojë vendimin dhe t'ia kthejë lëndën tribunalit të arbitrazhit që ta iniciojë sërish procedurën e arbitrazhit ose që t'i merr ato veprime, të cilat sipas vlerësimit të tribunalit të arbitrazhit do të mënjanojnë arsyet për anulimin e vendimit.

Neni 37

Dispozitat e përgjithshme të procedurës

37.1. Gjykata vendos me aktvendim. Para nxjerrjes së aktvendimit Gjykata ka për detyrë ta dëgjojë palën kundërshtare.

37.2. Në rastin e ngritjes së padisë, sipas nenit 36, për anulimin e vendimit të tribunalit të arbitrazhit, Gjykata ka për detyrë t'i dëgjojë të gjitha palët.

37.3. Kundër aktvendimit të Gjykatës në rastet e parapara në nenin 36, paragrafi 2, lejohet ankesa. Për të gjitha aktvendimet tjera të nxjerra nga Gjykata në pajtim me këtë ligj nuk lejohet ankesa.

Kreu VIII
NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE
TË TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT

Neni 38

Vendimet e arbitrazhit të nxjerra brenda Kosovës

38.1. Vendimi i arbitrazhit i cili është nxjerre nga një tribunal i arbitrazhit brenda Kosovës ekzekutohet pasi që të shpallet i ekzekutueshëm nga Gjykata.

38.2. Kërkesa që vendimi i arbitrazhit të shpallet i ekzekutueshëm hidhet poshtë nëse Gjykata konstaton se ekzistojnë një ose me shumë arsye për anulimin e vendimit sipas nenit 36, paragrafi 2. Kërkesës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit sipas këtij neni i bashkëngjitet vendimi i tribunalit të arbitrazhit ose një kopje e vërtetuar e tij.

Neni 39

Vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës

39.1. Gjykatat e Kosovës i njohin vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës si të plotfuqishme dhe i ekzekutojnë ato nëse vendimet në fjalë janë njohur dhe janë shpallur të ekzekutueshëm sipas paragrafëve 2 deri 5 të këtij neni.

39.2. Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të arbitrazhit të nxjerrur jashtë Kosovës i paraqitet Gjykatës Ekonomike.

39.3. Kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit pala e interesuar ia bashkëngjet:

- a). origjinalin e vendimit ose një kopje të vërtetuar të vendimit;
- b). origjinalin e marrëveshjes së arbitrazhit ose një kopje të vërtetuar të saj; dhe
- c). një përkthim të certifikuar të marrëveshjes së arbitrazhit dhe të vendimit të arbitrazhit në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës, nëse marrëveshja ose vendimi nuk është përpiluar në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës.

39.4. Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit refuzohet në bazë të kërkesës së palës tjetër, nëse ajo dëshmon se:

- a). njëra palë në marrëveshjen e arbitrazhit, sipas së drejtës kompetente për atë marrëveshje, nuk ka pasur zotësi për të vepruar; ose nëse marrëveshja e arbitrazhit nuk ka qenë e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas së drejtës në territorin ku është marrë vendimi;

b). pala, ndaj së cilës kërkohet ekzekutimi i vendimit, nuk është njoftuar me rregull në lidhje me caktimin e një arbitri ose për procedurën e arbitrazhit, ose për arsye tjera nuk ka qenë në gjendje të paragesë rastin e saj;

c). vendimi nuk ka të bëjë me çështjen e shqyrtuar nga tribunali i arbitrazhit ose ka të bëjë me një çështje e për të cilën nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit, ose vendimi përfshin çështje për të cilat nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit. Në këto raste, nëse vendimi mbi çështjet për të cilat është kompetent tribunali i arbitrazhit mund të ndahet nga çështjet tjera, atëherë kjo pjesë e vendimit mund të njihet dhe të ekzekutohet;

d). përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e ligjit të zbatueshëm në atë rast; dhe

e). vendimi ende nuk është bërë i plotfuqishëm për palët, ose është shfuqizuar ose pezulluar nga një organ kompetent në territorin ku është nxjerrë vendimi, respektivisht sipas drejtës në bazë të se cilës është nxjerrë vendimi.

39.5. Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të tribunalit të arbitrazhit refuzohet, nëse Gjykata konstaton se:

a). sipas ligjit në fuqi në Kosovë, kontesti përkatës nuk mund të zgjidhet përmes arbitrazhit, ose

b). njohja ose ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do të ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public) të Kosovës.

Kreu IX

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Ligji në fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat e ligjit në fuqi të cilat nuk janë në pajtim me këtë ligj.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi një muaj pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe pas shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-75
26 janar 2007

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
Kolë Berisha

LITERATURA E KONSULTUAR

Prof. Dr. Brestofci F., E Drejta e Procedurës Civile Ndërkombëtare, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2000.

Fullani J., Hasani S., Arbitrazhi dhe Kontratat, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1987.

Prof. Dr. Hetemi M., E Drejta Ndërkombëtare Tregtare-Afariste, Prishtinë, 2007.

Prof. Dr. Gruda Z., E Drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, 2002.

Prof. Dr. Bilalli A., Prof. Dr. Kuqi H., E drejta Ndërkombëtare private, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2008.

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve zyrtare, Tiranë, Qershor 2010.

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2002.

Prof. Dr. Jezdić M., E drejta ndërkombëtare private, Libri i parë, përkthyer në gjuhën shqipe nga Hamdi Vraniqi, Prishtinë, 1976.

Prof. Dr. Jezdić M., E Drejta Ndërkombëtare Private, Libri i dytë, përkthyer në gjuhën shqipe nga Hamdi Vraniqi, Prishtinë, 1976.

Jezdić M., Pak M., E drejta ndërkombëtare private, Libri i tretë, përkthyer në shqip nga Avni Gjakova, Prishtinë, 1977.

Prof. Dr. Trajković M., Međunarodno arbitražno pravo, Beograd, 2000.

Aleksandar J., Međunarodna trgovinska arbitraža, Beograd, 2003.

Prof. Dr. Knezević G., Doc. Dr. Pavić V., Arbitraža i ADR, Beograd, 2009.

Prof. Dr. Trivo S., Prof. Dr. Poznić B., Prof. Dr. Vargić N., Doc. Dr. Varadi T., Arbitražno rešavanje sporova, Novi Sad, 1973.

Mr. Perović. J., Ugovor o Medjunarodnoj trgovinskoj arbitraži, Beograd, 2002.

Arbitražna Odluka, Hrvatska akademska i istraživačka mreža, Carnet, Zagreb, 2008.

ARBITRAZHI

Ligji për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Evropiane të Arbitrazhit nr. 8687 data 09.11.2000.

Ligji nr. 7424, data 14.11.1990 për Arbitrazhin Shtetëror, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 03/L-57 për Ndërmjetësim. Kuvendi i Republikës së Kosovës, 18.09.2008.

Arbitrazhi USAID, tetor 2008, Prishtinë, nga Vjosa Osmani.

Vendimi për pagesën e shpenzimeve administrative të arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen S. Saranda, 28.08.2009.

Vendimi për dhënien fuqi vendimit të arbitrazhin ndërkombëtar data 13.07.1993, gjykata e apelit, Tiranë.

Ligji nr. 9090, data 26.06.2003 për Ndërmjetësim në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Ligji për arbitrazhin i Republikës së Kosovës nr. 02/L-75 i datës 15.05.2001.